



# PROPAGANDË, NARRATIVE TË RREME, DEZINFORMATA - NDIKIMET E DËMSHME TË KREMLINIT NË MAQEDONINË E VERIUT

Përmbledhje artikujsh mediatik



METAMORPHOSIS   
Fondacion për internet dhe shoqëri





# PROPAGANDË, NARRATIVE TË RREME, DEZINFORMATA - NDIKIMET E DËMSHME TË KREMLINIT NË MAQEDONINË E VERIUT

Përmbledhje artikujsh mediatik

**Titulli i origjinalit:**  
ПРОПАГАНДА, ЛАЖНИ НАРАТИВИ, ДЕЗИНФОРМАЦИИ - ШТЕТНИТЕ  
ВЛИЈАНИЈА НА КРЕМЉ ВО С. МАКЕДОНИЈА

Зборник на медиумски написи

**Botues:** Fondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis” – Shkup  
Rr. Apostoll Gusllarot nr. 40, Shkupi 1000, Maqedonia e Veriut <http://metamorphosis.org.mk>

**Për botuesin:** Bardhyl Jashari (Бардил Јашари)  
Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni “Metamorfozis”

**Redaktorë të botimit:**

Vladimir Petreski (Владимир Петрески), Goran Rizaov (Горан Ризаов)  
Elida Zylbeari (Елида Зилбеари)

**Autorët e teksteve:**

Despina Kovačevska (Деспина Ковачевска), Gjorgji Mitrevski (Ѓорѓи Митревски)  
Mirjana Najčevska (Мирјана Најчевска), Zharko Trajanoski (Жарко Трајаноски)  
Bojan Blazeovski (Бојан Блажевски), Goran Rizaov (Горан Ризаов)  
Elida Zylbeari (Елида Зилбеари), Filip Stojanovski (Филип Стојановски)  
Teuta Vuçi (Теута Вучи), Shefkije Alasani (Шефкије Аласани)  
Vesna Kolovska (Весна Коловска), Ardit Ramadani (Ардит Рамадани)  
Goran Lefkov (Горан Лефков), Simona Atanasova (Симона Атанасова)  
Sonja Rilkovska (Соња Рилковска), Ana Anastasovska (Ана Анастасовска)

**Përktimi nga maqedonishtja në shqip:**

Valon Abdiu , Marta Ziba Rashidi

Viti i botimit: 2022  
Tirazhi: 100, Rojal art

# PËRMBAJTJA:

HYRJE .....	7
<b>TENDENCAT DEZINFORMATIVE LIDHUR ME NDIKIMET HUAJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT .....</b>	<b>9</b>
Tendencat dezinformative kryesore lidhur me ndikimet e huaja .....	10
Tendenca dezinformative lidhur me luftën në Ukrainë .....	13
Monitorimi i raportimit të mediave vendore për luftën në Ukrainë .....	17
<b>MONITORIMI I RAPORTIMIT TË MEDIAVE VENDORE PËR LUFTËN NË UKRAINË.....</b>	<b>17</b>
<b>ANALIZA TË EKSPERTËVE.....</b>	<b>18</b>
<b>SI KRIJOHET MAGJEPSJA NGA FUQIA E RUSISË NË MEDIUME DHE RRJETET SOCIALE.....</b>	<b>19</b>
<b>BESIMI NË MJEKËSI SI MJET I NDIKIMIT RUS .....</b>	<b>29</b>
<b>NDJENJA E PÛRKATËSISË SI MJET I NDIKIMIT RUS NË MAQEDONINË E VERIUT .....</b>	<b>41</b>
<b>PROPAGANDA RUSE GJATË KRIZËS POLITIKE NË MAQEDONI (2015) - DEZINFORMATA PËR „SKENAR UKRAINAS” .....</b>	<b>53</b>
<b>PROPAGANDA RUSE PËR „SKENARIN UKRAINAS” NË MAQEDONI (2016 - 2017).....</b>	<b>65</b>
<b>PROPAGANDA RUSE NË MAQEDONI NË VITIN 2018: “MAQEDONIA E BASHKUAR” SI “PION” I “RUSISË SË BASHKUAR” .....</b>	<b>79</b>
<b>ASGJË NUK E ARSYETON INVAZIONIN RUS MBI UKRAINË .....</b>	<b>91</b>
<b>PROPAGANDISTI DUGIN, SATANIZIMI I PERËNDIMIT DHE APOLOGJIA E IMPERIALIZMIT RUS.....</b>	<b>103</b>
<b>ANALIZA GAZETARESKE .....</b>	<b>113</b>





<b>UKRAINA KËRKON NGA MAQEDONIA E VERIUT T’I BASHKOHET SANKSIONEVE EKONOMIKE TË BE-SË NDAJ RUSISË.....</b>	<b>115</b>
<b>ANALIZË: LUFTA NË UKRAINË DO TË SHKAKTOJË JOSTABILITET EKONOMIK NË RMV .....</b>	<b>123</b>
<b>SKENA MEDIATIKE RUSE: PËRMBAJTJE TË KONTROLLUARA ME PAK HAPËSIRË PËR MEDIAT E HUAJA .....</b>	<b>129</b>
<b>ROLI I PARTIVE SHQIPTARE NË RMV NË KONTEKSTIN E LUFTIMIT TË NDIKIMIT RUS .....</b>	<b>139</b>
<b>VERIFIKIME TË FAKTEVE .....</b>	<b>153</b>
<b>NË UKRAINË NUK SHKATËRROHEN “FASHISTËT GLOBAL”, POR VRITET POPULLATA CIVILE DHE FËMIJË.....</b>	<b>155</b>
<b>NUK ËSHTË E VËRTETË QË RUSIA NUK BOMBARDON NDËRTESA CIVILE DHE SE PAMJET E MARIUPOLIT JANË TË RREME.....</b>	<b>161</b>
<b>RMV, ME FAKTE TË NJËANSHME QYTETARËVE JU SUGJEROHET TË JENË PRO AGRESIONIT RUS NË UKRAINË .....</b>	<b>167</b>
<b>ËSHTË PROPAGANDË RUSE SE SHTETET E BALKANIT PERËNDIMOR KANË DËRGUAR “MERCENARË” PËR TË LUFTUAR NË UKRAINË .....</b>	<b>177</b>
<b>NUK KA ASNJË PROGRAM TË FINANCUAR NGA SHBA PËR ZHVILLIMIN E ARMËVE BIOLOGJIKE NË UKRAINË .....</b>	<b>179</b>
<b>ARTIKUJ INFORMUES .....</b>	<b>183</b>
<b>AMBASADA RUSE NË SHKUP KËRCËNON SE I „EVIDENTOJNË” ATO QË MENDOJNË NDRYSHE, TË ETIKETUAR SI „RUSOFOBË” .....</b>	<b>185</b>
<b>KOMUNA QENDËR NUK E DI SE KUSH E HOQI TABELËN ME QYTETIN UKRAINAS TË SEVASTOPOLIT NGA KËNDI “RUS” I LOJËRAVE .....</b>	<b>189</b>

# HYRJE

**F**ondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis” e forcon vetëdijen dhe kapacitetin e qytetarëve dhe të shoqërisë civile për ta marrë rolin më të mirë të mundshëm si aktivistë për demokraci, duke i mbështetur institucionet shtetërore dhe aktorët e tjerë shoqërorë për t’i përmbushur rolat e tyre demokratike - të punojnë në shërbim të shoqërisë dhe interesit publik.

Që demokracia të jetë e qëndrueshme dhe funksionale, nevojiten jo vetëm qytetarë të përfshirë dhe aktivë, por edhe një publik i informuar i mirë, i cili mundëson vendimmarrje cilësore, të bazuar në njohuri. Kundrejt kësaj, liria e shprehjes dhe e medias kërcënohen nga një valë dezinformatash që janë pjesë e propagandës autoritare populiste nga burime vendase dhe të huaja.

Projekti “Qendra Kundër Dezinformatave: ekspozimi i ndikimeve malinje përmes gazetarisë” synon të ekspozojë pretendimet kryesore propagandistike që e mohojnë ekzistencën e ndikimeve të dëmshme të huaja në Republikën e Maqedonisë së Veriut që synojnë minimin e demokracisë. Ai është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të Fondacionit “Metamorfozis” dhe një rrjeti mediash, gazetarësh hulumtues dhe analistësh për të dokumentuar situatat dhe për të demaskuar dezinformatat duke ofruar dëshmi për gjendjen faktike. Përmbledhja “Propagandë, narrative të rreme, dezinformata - efektet e dëmshme të Kremlinit në Maqedoninë e Veriut” është një përzgjedhje e informacioneve publike të krijuara duke u bazuar në një qasje metodologjike transparente për verifikimin e fakteve që i hedhin poshtë parimet qendrore të propagandës antidemokratike dhe populiste.

Edukimi i qytetarëve në përcaktimin se cilat informata janë të rëndësishme dhe të sakta, mundëson që e gjithë shoqëria të bëhet më pak e cenushme ndaj efekteve të ndikimeve të dëmshme të huaja. Njohuritë e situara janë bazë për një iniciativë avokuese që i bashkon palët relevante të interesit (institucionet qeveritare, shoqatat mediatike, mediat individuale, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin shkencor-arsimor dhe sektorin privat) për t’iu kundërvënë efekteve toksike të dezinformatave përmes zhvillimit gjithëpërfshirës të politikave publike dhe aktiviteteve konkrete të përbashkëta.

**Bardhyl Jashari,**

Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Metamorfozis







# TENDENCAT DEZINFORMATIVE LIDHUR ME NDIKIMET HUAJA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Autorë: Despina Kovačevska dhe Gjorgji Mitrevski

**P**ër të identifikuar tendencat e raportimit mediatik, si dhe tendencat dezinformative kryesore lidhur me ndikimet e huaja, në kuadër të këtij studimi në periudhën nga muaji nëntor i vitit 2021 deri në muajin prill të vitit 2022 u realizua monitorim i mediave në vend.

Për përcaktimin e tendencave dezinformative kryesore u zbatua një analizë e më shumë se 300 shkrimeve antidezinformative, 160 nga të cilat në mënyrë të drejt-përdrejtë ishin të lidhura me ndikimet e huaja në vend, e që ishin publikuar si pjesë e verifikimit të fakteve dhe si shkrime analitike në Vërtetmatës. Në mostrën për zbatimin e kësaj analize u përfshinë të gjithë shkrimet në dispozicion që përmbajnë fakte të verifikueshme të cilat mund të verifikohen me ndihmën e metodave gazetareske profesionale, me ç'rast u bë kujdes që të përfshihen të gjitha shkrimet shumë virale, pra shkrime me një përfaqësim të lartë në rrjetet sociale.

Për të fituar të dhëna shtesë për përfaqësimin e përgjithshëm mediatik të informacioneve lidhur me luftën në Ukrainë, e cila paraqiste temën më aktuale gjatë periudhës së monitorimit, e me këtë edhe më e prirur ndaj dezinformimit, u zbatua një monitorim me përdorimin e fjalëve kyçe, të cilat u përcaktuan paraprakisht mbi bazë të një analize kuantitative të narrativeve të pranishme në hapësirën mediatike. Mostra për zbatimin e monitorimit me përdorimin e fjalëve kyçe i përfshiu të gjitha shkrimet mediatike të periudhës së monitoruar, të pranishme tek agregatorët e lajmeve në vend.

Qasja e këtillë metodologjike nuk siguron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të mbulimit mediatik në vend për periudhën e monitoruar, por siguron një pasqyrë të qartë për tendencën e raportimit në mediat vendore, si dhe për përfaqësimin e tendencave dezinformative në vend.





## Tendencat dezinformative kryesore lidhur me ndikimet e huaja

Nga numri i përgjithshëm i shkrimeve dezinformative të identifikuar gjatë periudhës së monitorimit, në mostrën e shkrimeve dezinformative lidhur me ndikimet e huaja u përfshinë të gjitha shkrimet që referohen në, ose që marrin informacione nga jashtë, shkrimet në të cilat përmenden shtete të tjera dhe/ose organizata dhe/ose institucione të huaja, si dhe shkrime të cilat në hapësirën mediatike në vend reflektojnë teori konspirative globale. Me ndihmën e kësaj mënyre të përzgjedhjes, në mostrën e analizuar u gjetën të gjitha shkrimet e njohura dezinformative, me përjashtim të atyre që nuk kishin kurrfarë lidhje me temat, teoritë apo entitetet jashtë vendit dhe i referoheshin vetëm jetës shoqërore në vend.


Analiza e shkrimeve dezinformative në periudhën nga muaji nëntor i vitit 2021 deri në muajin prill të vitit 2022 zbulon se në mediat dhe rrjetet sociale në vend ekzistojnë tre tendenca kryesore dezinformative. Nëse e kemi parasysh intensitetin e ngjarjeve dhe mbulimin mediatik në këtë temë, kuptohet që më të përfaqësuara ishin dezinformatat lidhur me luftën në Ukrainë, që në mostrën e analizuar u identifikuan në 57 shkrime të ndryshme.

Dezinformatat të cilat kanë për qëllim të nxisin frymën kundër vaksinimit, si një tendencë që vazhdon të jetë e pranishme në vendin tonë, ishin të përfaqësuara në 50 shkrime të ndryshme. Narrativet kryesore në të cilat mbështeteshin këto shkrime dezinformative janë pretendimet tashmë të njohura sipas të cilave vaksina kundër COVID-19 shkakton sëmundje (si kanceri, Ebola, HIV, sëmundje neurologjike, sëmundje të zemrës, infeksione dhe mpiksje të gjakut), pastaj se vaksinat përmbajnë helme, gjegjësisht oksid të grafenit, si dhe se vaksinat janë të dëmshme për shtatzënat.

Dezinformatat që mbështesin teori të ndryshme konspirative ishin pak më pak të përfaqësuara. Gjatë analizës ato u identifikuan në 37 shkrime të ndryshme të cilat përhapnin ndonjë teori konspirative, me ç'rast ishin pothuajse njësoj të përfaqësuara të gjitha teoritë konspirative tashmë të njohura, si: vendosja e çipave, klonimi i ADN-së dhe manipulime të tjera gjenetike, 5G, plandemia, Fauçi, mafia farmaceutike, si dhe eugenika.


Në mostër u identifikuan edhe 16 shkrime shitesë me dezinformata në lidhje me tema të tjera të ndryshme nga fusha e ndikimeve të huaja në vend.

Nëse e shikojmë praninë e tendencave dezinformative të identifikuara në periudhën kohore nga muaji nëntor i vitit 2021 deri në muajin prill të vitit 2022, do të shohim se dezinformatat dhe teoritë konspirative kundër vaksinimit, kanë një përfaqësim kohor konstant, me një variacion të vogël nga muaji në muaj, për dallim nga dezinformatat për luftën në Ukrainë që i ndjekin tendencat e raportimit mediatik për këtë temë.




Përhapja e dezinformatave lidhur me krizën në Ukrainë në fillim të vitit kur kriza ende po fitonte në intensitet ishte ende shumë e vogël. Por, pas mungesit të 24 shkurtit kur filluan veprimet ushtarake kundër Ukrainës, verifikuesit e fakteve ishin dëshmitarë të një ndryshimi qenësor të situatës dhe të një rritjeje jashtëzakonisht të madhe të dezinformatave për ngjarjet, kështu që gjatë muajit mars u arrit maksimumi i aktiviteteve dezinformative, e përfaqësimi i dezinformatave u trefishua. Edhe pse gjatë muajit prill është vënë re një rënie e vogël e numrit të shkrimeve dezinformative në lidhje me këtë temë, përsëri ato janë tre herë më të përfaqësuara se të tjerat.





Numri më i madh i shkrimeve dezinformative burojnë nga rrjetet sociale. Rreth 152 shkrime të analizuar kanë qenë postime personale të Facebook, ndërsa vetëm 8 kanë qenë shkrime mediatike.

Në të shumtën e rasteve dezinformatat janë bazuar në shkrime mediatike në mediat vendore apo ato të huaja (76 prej të gjitha shkrimeve dezinformative), e pastaj edhe në postime në rrjetet sociale (38 postime, nga të cilat 19 në Facebook dhe 14 në Twitter). Në masë më të vogël dezinformatat janë bazuar në Youtube (16), ueb-faqe (13), si dhe në burime të tjera.



## Tendenca dezinformative lidhur me luftën në Ukrainë

Bashkë me zhvillimin e skenarëve ushtarakë për Ukrainën, u zhvilluan edhe narrativet dezinformative që u përhapën në të gjithë botën. Megjithatë, niveli i lartë i përgatitjes së organizatave për verifikimin e fakteve mundësoi zbulim të shpejtë të narrativeve dhe zbatimin e nismave për përballje me mashtrimet. Rezultatet e deritanishme të monitorimit të raportimit mediatik tregojnë se ekzistojnë dezinformata që janë në favor të të dyja palëve të përfshira në konflikt; mirëpo raporti nuk është aspak i barabartë. Lufta informative të cilën e bën Kievi është sistematike, me ndikim të gjerë dhe me të vërtetë shkatërruese.

Në fazat shumë të hershme të invazionit ushtarak rus, dezinformatat fillimisht ishin të fokusuara tek aspektet ushtarake që do ta ngrenin nivelin e alarmimit dhe konfuzionit. Pastaj, duke u thirrur në „të vërteta historike“ dezinformatat shërbenin për legjitimim, madje edhe për arsyetim të antagonizmit, ndërsa historitë tronditëse për civilët ukrainas kishin për qëllim arritjen e reagimeve emocionale. Në fund, me teoritë konspirative në të cilat implikohet edhe Ukraina, siç janë mashtrimet lidhur me pandeminë ose me „deep state“, mbyllet rrethi i narrativeve të njohura dezinformative. Me zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve pritet që dezinformatat të vazhdojnë të përshtaten me skenarët aktual, siç është shembulli me rritjen e numrit të dezinformatave për rritjen e fluksit të migracionit.

Sipas raporteve javore për narrativet dezinformative për luftën në Ukrainë<sup>1</sup>të Opservatorit Evropian për Mediat Digjitale (EDMO)<sup>2</sup>, deri në fund të muajit prill të këtij viti në hapësirën mediatike evropiane qarkullon një numër më i madh i narrativeve nga të cilët krijohen këto tendenca dezinformative:

- I. Rishqyrimi i luftës, nga realiteti i saj deri te motivet e saj;
- II. Informacione të pabaza për operacionet ushtarake;
- III. Pasqyrimi i shtrembëruar i ukrainasve dhe Zelenskit;
- IV. Diskreditimi i raportimit mediatik për Ukrainën;

---

1 <https://edmo.eu/war-in-ukraine-the-fact-checked-disinformation-detected-in-the-eu/>


2 European Digital Media Observatory (EDMO); <https://edmo.eu/>





- V. Dezinformata për përgjegjësinë për viktimat civile ukrainase;
- VI. Dezinformata për refugjatët ukrainas;
- VII. Dezinformata për krizën humanitare;
- VIII. Informacione të rreme për mbështetjen e huaj për Ukrainën;
- IX. Skemat për mbështetje të pushtimit rus të Ukrainës;
- X. Informacione të rreme për mungesën e ushqimit dhe barnave; dhe
- XI. Prezantimi i pasaktë i rusëve.

Analiza e shkrimeve në vend tregon se dezinformatat që përhapen në vendin tonë në përgjithësi grupohen rreth disa tendencave dezinformative që janë më të përgjithshme dhe më të përfaqësuara edhe në hapësirën mediatike evropiane (si për shembull, informim i pabazuar për operacionet ushtarake, ose, pasqyrimi i shtrembëruar i palëve në konflikt), ndërsa dezinformatat lidhur me dimensionin humanitar të luftës (siç janë për shembull përgjegjësia për viktimat civile ukrainase, kriza me refugjatët dhe ajo humanitare), nuk janë të përfaqësuara aspak.



## ***Informacione të pabaza për operacionet ushtarake***

Informacionet e fabrikuara për zhvillimin e luftës ishin ndër të parat që u përhapën që nga fillimi i invazionit, e që ngjallën panik dhe konfuzion të mendimit publik. Nga fillimi i luftës e deri më tani në media hasim video dhe foto të dekontekstualizuara, me të cilat përhapen dezinformata për agresion të armatosur, shpërthime dhe ndodhi të tjera në fushën e betejës. Gjithashtu i madh është numri edhe i shkrimeve në të cilat përhapen dezinformata për baza të NATO-s dhe për laboratorë për armë biologjike në Ukrainë, pre e të cilave u bënë jo vetëm mediat digjitale, por edhe disa nga ato tradicionale. Narrativet e këtilla janë të pranishme në pothuajse gjysmën e shkrimeve të cilat përhapin dezinformata për luftën në Ukrainë në vendin tonë (44%), dhe po aq janë të përfaqësuara edhe në mediat evropiane kur përbëjnë rreth një të tretën e të gjitha dezinformatave në lidhje me luftën në Ukrainë.

## ***Rishqyrtimi i luftës, nga realiteti i saj deri te motivet e saj***

Nuk është i vogël as numri i narrativeve të cilat shkaktojnë konfuzion të publikut në të cilat shqyrtohen arsyet, madje edhe faktet themelore për ekzistimin e luftës në Ukrainë. Në mediat sociale përhapen dezinformata se lufta në Ukrainë është e inskenuar, se mediat në mënyrë të rreme raportojnë për konfliktin, madje edhe se ngjarjet në Buça dhe Mariopol nuk janë të vërteta, por që bëhet fjalë për skenar ukrainas që ka për qëllim të dëmtojë pozitën ruse. Narrative të këtilla hasen tek një e katërta (25%) e dezinformatave tek mediat në vend, dhe po aq hasen edhe në hapësirën mediatike në Evropë.

## ***Pasqyrimi i shtrembëruar i ukrainasve dhe Zelenskit***

Duke pasur parasysh se konflikti në Ukrainë zgjoi kujtime të rënda historike, në sferën publike filluan të shfaqen narrative të cilat ngjarjet i interpretojnë përmes aluzioneve të ndryshme të regjimit nazist. Edhe pse përdorimi i narrativeve të këtilla është vënë re tek të dyja palët që janë në konflikt, përsëri duhet të përmendet se






ofensiva dezinformative ruse në këtë rast është shumë më e suksesshme. Për dallim të dezinformatave anti-ruse (si për shembull faqja e parë e montuar e revistës Time, ku Putini është prezantuar me mustaqet e Hitlerit) që kanë qenë të pranishme në një numër më të vogël, dezinformatat pro-ruse të cilat e paraqesin presidentin Zelenski dhe ukrainasit në një dritë naziste (si për shembull fotografia e montuar e Zelenskit duke mbajtur një dres me svastika (kryqin e thyer)) ishin mjaft të pranishme edhe në hapësirën mediatike në vend, ku bashkë me disa narrative të tjera që kanë për qëllim diskreditimin e presidentit, u identifikuan tek rreth një e katërta (25%) e shkrimeve që përhapin dezinformata për luftën në Ukrainë.

### *Pasqyrimi i shtrembëruar i rusëve*

Analiza e shkrimeve në vend tregon se për dallim të narrativeve të shumta pro-ruse, dezinformatat anti-ruse janë të pranishme në një numër dukshëm më të vogël. Pra, në mediat digjitale në vend u zbuluan vetëm 5 dezinformata që kanë për qëllim diskreditimin e personalitetit të presidentit rus Putin.



Analiza përmbytësore e tendencave dezinformative tregon se në mostrën e analizuar dominojnë narrativet dezinformative pro-ruse. Me përjashtim të 5 shkrimeve,




që paraqet vetëm rreth 4% të mostrës së përgjithshme, të gjitha shkrimet e tjera janë në favor të propagandës ruse. Analiza shtesë tregon se Ukraina, gjegjësisht SHBA dhe NATO, në mënyrë eksplicite në kontekst negativ përmenden në më shumë se dy të tretat e shkrimeve mediatike.

## Monitorimi i raportimit të mediave vendore për luftën në Ukrainë

Monitorimi i raportimit mediatik për periudhën nga muaji nëntor i vitit 2021 deri në muajin prill të vitit 2022 jep një pasqyrë të qartë për prezencën tematike në mediat në vend. Mbulimi mediatik i temave lidhur me luftën në Ukrainë shënon një tendencë në rritje nga fillimi i vitit 2022 kur është vënë re një intensifikim shumë i madh i raportimit mediatik, me ç'rast numri më i madh i shkrimeve (main peak) është vënë re në muajin mars, kur edhe numri i shkrimeve mediatike në këtë temë është dyfishuar, krahasuar me muajin paraprak, ndërsa në krahasim me muajin janar të po atij viti ai është trefishuar. Në muajin prill vihet re një rënie e numrit të shkrimeve, madje ka më pak edhe se në muajin shkurt.



# ANALIZA TË EKSPERTËVE



# SI KRIJOHET MAGJEPSJA NGA FUQIA E RUSISË NË MEDIUME DHE RRJETET SOCIALE

Një nga mënyrat më të thjeshta për të ndikuar në një numër më të madh njerëzish është të lavdërosh një vend. Glorifikimi pozitiv mund të ngjallë admirim, ndjenjën e përkatësisë dhe komunitetit, ndjenjë mbrojtjeje, strehë gjithnjë të pranishme, si dhe alternativë që është në dispozicion të qytetarëve dhe shtetit... Kjo është veçanërisht e mundur në kohë stagnimi ose pritjesh të paplotësuara ose pakënaqësia nga shpejtësia me të cilën lëvizin gjërat, në rastin konkret negociatat e anëtarësimit me BE-në.

Shkruan: prof-dr Mirjana Najčevska,

eksperte për sundimin e ligjit dhe të drejtave njerëzore

(Vertetmates, 31.01.2022)

Demonstrimi i fuqisë së një shteti mund t'i referohet fuqisë kulturore, shkencore ose ndonjë lloji tjetër, por është më e habitshme kur korrespondon me theksimin e fuqisë ushtarake. Pikërisht ky segment i ndikimit të mundshëm është interesant dhe bie në sy kur analizohet ndikimi që ka Rusia në Republikën e Maqedonisë së Veriut.





## GLOBSEC

Në përgjithësi, Maqedonia e Veriut nuk është shumë e ekspozuar, as nuk është nën ndonjë ndikim të dukshëm dhe të fortë të Rusisë. Monitorimi i rregullt i cenimit të vendit nga ky lloj ndikimi që e bën “GLOBSEK” nga Bratislava, tregon se ajo është mesatarisht e cenueshme dhe se ka mekanizma me të cilët arrin të përballet.

Magjepsja me fuqinë e Rusisë ekziston dhe transmetohet si përmes mediave formale, ashtu edhe përmes rrjeteve sociale dhe faqeve të internetit, por është e vështirë të matet.

### **Në këtë ndikojnë disa faktorë.**

Së pari, gazetaria analitike dhe investigative nuk është e zhvilluar në vend, por praktikohet, mbi të gjitha, kopjimi dhe transmetimi i lajmeve/informacioneve/analizave nga media të tjera, kryesisht të huaja. Duke pasur parasysh se edhe në këtë transmetim nuk citohen mediat nga e cila është marrë teksti dhe aq më rrallë jepen linke me tekstet specifike, mund të supozohet se nga cili burim është marrë një lajm/informacion i caktuar sipas përmbajtjes së tij.

Së dyti, ekziston traditë e dëgjimit/shikimit/leximit të mediave që vijnë nga Republika e Serbisë fqinje. Është shumë e vështirë të përcaktohet shkalla e ekspozimit të qytetarëve ndaj këtyre mediave (shumë prej të cilave janë pozitive dhe shumë jo selektive kur bëhet fjalë për transmetimin e informacionit që lidhet me Rusinë dhe fuqinë e saj ushtarake). Situata përkeqësohet me blerjen e disa mediave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga pronarë serbë. Nëse kjo vihet në kontekstin e analizave që tregojnë për ndikimin e madh të

Rusisë në [mediat serbe](#), mund të nxirret një përfundim për të pasqyruar atë ndikim edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Së treti, [rrjetet sociale](#) janë një burim i rëndësishëm informacioni që është i vështirë për t'u llogaritur. Besimi në media që plasojnë lajme burimi i të cilëve nuk mund të verifikohet, është i [rëndësishëm dhe pa mëdysheje i rrezikshëm](#). Pikërisht për shkak të mënyrës kryesisht joformale të përcjelljes së informacionit, pikëpamjeve, opinioneve, nuk është e lehtë të vlerësohet niveli i ndikimit i tyre në një rreth më të gjerë njerëzish.

Ajo që mund të konstatohet nga analiza e mediave në Republikën e Maqedonisë së Veriut është se për fuqinë ushtarake të Rusisë flitet në mënyrë dhe në sasi që nuk mund të gjendet kur bëhet fjalë për ndonjë vend tjetër. Njëanshmëria e informacionit theksohet nga fakti se në media [nuk ka matje dhe të dhëna përkatëse](#) nga të cilat mund të shihet fuqia ushtarake e vendeve/aleancave të veçanta.

1	United States		PwrIndx Score: 0.0453	
2	Russia		PwrIndx Score: 0.0501	
3	China		PwrIndx Score: 0.0511	
4	India		PwrIndx Score: 0.0979	
5	Japan		PwrIndx Score: 0.1195	
6	South Korea		PwrIndx Score: 0.1261	
7	France		PwrIndx Score: 0.1283	
8	United Kingdom			

*Ilustrim: Lista e vendeve sipas fuqisë ushtarake sipas [GlobalFirepower \(GFP\)](#).*





Kjo magjepsje (në mënyrën se si portretizohet në media) mund, por jo gjithsesi të korrespondojë me [të dhënat e situatës faktike](#) (duke qenë se shumë pak artikuj tregojnë të dhëna ose burime përkatëse për pretendime të caktuara). Në çdo rast, në media [nuk kundërshtohen burimet e ndryshme të të dhënave](#).

Në disa artikuj mungesa e burimeve dhe e të dhënave përkatëse zëvendësohet duke dhënë detaje të llojeve specifike të armëve dhe/ose armatimeve që duhet të krijojnë [përshtypjen e rëndësisë dhe njohurive](#). Për shembull, një artikull i tillë titullohet [“Bartësi vrasës do ta bëjë Rusinë një forcë të fuqishme hipersonike”](#), në të cilin është dhënë përshkrim shumë i detajuar i armës “së re” që po zhvillohet nga Rusia. Ose [“Sistemet ruse kundërajrore S-350 që vijnë në Krime së shpejti”](#), [“Kalaja e Kaliningradit: Ushtria ruse po formon me shpejtësi një divizion të fuqishëm për të mbrojtur enklavat e rëndësishme”](#).

Disa nga artikujt janë të strukturuar në atë mënyrë që në pamje të parë duket se dërgojnë [mesazh shqetësimi](#) (nga fuqia ushtarake e Rosisë), megjithatë në një sërë rastesh të tilla i gjithë teksti rrezaton [admirim](#).

Zakonisht, fuqia ushtarake e Rosisë nuk është pjesë e ndonjë analize të gjerë ose të thelluar, përmendja shpesh bëhet jashtë kontekstit (lidhur me ndonjë ngjarje – festë, manovër, deklarata nga zyrtarë të lartë të qeverisë ruse) dhe nuk ka elemente krahasuese ose tregim të balancuara të fuqisë ushtarake të shteteve tjera.

Edhe kur media i referohet analizave eksperte apo specifike të ndërmarra nga media të tjera, është shumë e rrallë të jepet link që do të verifikonte formën e tyre origjinale. Në çdo rast, nuk ka asnjë këndvështrim apo referencë të balancuar për analiza të ndryshme (disa [që lavdërojnë fuqinë e Rosisë](#) dhe gatishmërinë e saj për të mposhtur Shtetet e Bashkuara, e të tjerë pretendojnë të kundërtën).

Numri i vogël i [analizave serioze](#) të shpërndarjes së fuqisë ushtarake në mediat e Maqedonisë së Veriut japin të dhëna [krejtësisht të kundërta](#) (për fuqinë ushtarake dhe pafuqinë, por edhe më shumë për situatën ekonomike në Rusi) me ato të përhapura nga portalet dhe mediat që e ushqejnë magjepsjen me fuqinë ushtarake të Rosisë.

Është interesante se kur flitet për renditjen e fuqisë ushtarake në mbarë botën (madje edhe për ndonjë konflikt të mundshëm), zakonisht flitet për Shtetet e Bashkuara dhe Rusinë, dhe jo për balancën e fuqisë ose për ndonjë një konflikt të mundshëm midis Rusisë (ose një strukture të udhëhequr nga Rusia) dhe NATO-s.

Informacionet që kanë të bëjnë me fuqinë ushtarake të Rusisë, shpesh janë pjesë e lajmeve të transmetuara përmes rrjeteve sociale, por nuk është e pazakontë që ato të gjejnë vend në mediat e njohura të shkruara dhe elektronike. Pjesë e këtij trendi janë edhe gazetatat më të vjetra në Maqedoninë e Veriut si “Nova Makedonija” me shkrime të llojit si [“Rusia është sërish e fuqishme dhe Perëndimi duhet ta përballojë”](#) dhe “Vecer” me [“VIDEO | Rusia teston me sukses një tjetër raketë hipersonike”](#).

Ndonjëherë bëhet fjalë për mesazhe indirekt lidhur me shitjen e armëve [fajinëve](#) apo “miqve” ose thjesht tentohet të arrihet efekti i duhur me një [qëndrim përçmues ndaj NATO-s](#).

Në këtë kuptim, zgjedhja e termave të përdorur për të përshkruar fuqinë ushtarake të Rusisë është gjithashtu interesante. Për shembull, flitet për [“E gjithë fuqia dhe bukuria e ushtrisë ruse: E gjithë fuqia dhe bukuria e ushtrisë ruse në një video: Kanali televiziv ushtarak rus transmeton një video spektakolare”](#):


**Video incizimi është përgatitur nga ekipi i kanalit televiziv “Zvezda”. Në të tregohet mjeshtëria e pilotëve ushtarakë rusë, tenkave, parashutistëve, artilerisë dhe mitralozëve. Janë shfaqur skena nga lëshimi i raketave “Kalibri” nga anijet, si dhe skena të sulmit nga helikopterët sulmues dhe avionët që hedhin raketa ndaj objektivave. Skenat me ngritjen e bombarduesve strategjikë Tu-160 ‘Mjellma e Bardhë’ meritojnë vëmendje të veçantë.**

Pjesa më e madhe e lajmeve që lidhen me pajisjet ushtarake dhe fuqinë ushtarake të Rusisë, të cilat më tej transmetohen në portale të caktuara apo edhe në media me reputacion në Maqedoninë e Veriut, merren nga portali [Russia Beyond](#). Më shpesh në raste të tilla, ky portal nuk tregohet fare si





burim informacioni/të dhënash dhe as nuk përmendet se informacioni është pjesë e rrjetit mediatic të financuar nga qeveria ruse, ku përfshihet botimi mëmë [“Российская газета”](#) dhe [Russia Today \(RT\)](#).



*Pamje e ekranit nga artikulli i Infomax.mk*

Për të krijuar përshtypjen e madhësisë dhe për të nxitur magjepsje me fuqinë ushtarake të Rusisë, shpesh flitet për disa [armë sekrete dhe krejtësisht të reja](#).

Asnjë përfundim specifik nuk mund të nxirret nga artikujt që paraqesin fuqinë ushtarake të Rusisë (natyrisht ky nuk është qëllimi i artikujve), as nuk përmendet ndonjë konotacion negativ i një fuqie të tillë ushtarake. Zakonisht mbetet vetëm [përshtypja e madhësisë](#).

Ky lloj i artikujve është i shpeshtë në situata konflikti të mundshëm ku përfshihet Rusia si palë në konflikt, siç është shembulli i fundit me Ukrainën.

Në fillim të rritjes së tensioneve lidhur me Ukrainën, në mediat në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk kishte shumë [analiza](#) për këtë temë. Është interesant fakti [se në disa nga ato që u bënë](#), më shumë flitej për atë që i shqetëson rusët sesa për atë që shqetëson vendet e Evropës Perëndimore. Në disa nga informacionet në lidhje me konfliktin për Ukrainën, shumë hapur u mbajt anë duke përdorur formulimin dhe kontekstin e duhur në të cilin transmetohen deklaratat e zyrtarëve të lartë nga të dyja palët (“Të kujtojmë,



zëdhënësi i Pentagonit John Kirby” ([sipas Portali “Lokalno”](#)) deklaroi se Rusia dyshohet se po përgatit justifikim për pushtimin e Ukrainës, pa ofruar prova për këto pretendime”, ... ndërsa nuk jepen dëshmi, do të konsiderohet se bëhet fjalë për lajm të rrejshëm dhe akuza të rrejshme kundër Rosisë, [shkruan](#) portali Observer).

Numri i kolumnave që analizonin marrëdhëniet midis Rosisë dhe Ukrainës në dritën e vlerave evropiane ishte edhe më i vogël. [Një nga kolumnat e pakta](#) në të cilat tentohet një qasje e balancuar, e cila tenton të ndërlihet me zhvillimet në Maqedoni dhe qëndrimin e vendeve evropiane ndaj saj, është publikuar nga portali “Faktor” në vitin 2019.

Niveli tjetër ishte zhvillimi i një perceptimi pozitiv për ushtrinë ruse dhe pranimi i veprimeve të tyre si të dëshiruara. Në artikuj të tillë si “[Paqeruajtësit tërhiqen nga Kazakistani](#)” botuar nga portali “Express” në janar 2022, ata bëhen paqeruajtës, me rol të qartë për paqe. Ndonjëherë perceptimi pozitiv është i paketuar mirë në [tekst kinse objektiv](#).

Kjo përshtypje theksohet nga admirimi i [qetë për taktikat e Putinit](#) ose “[përçarja e NATO-s](#)” dhe [vendet e Evropës Perëndimore](#), gjegjësisht [mosinteresimi](#) “perëndimor” për Ukrainën, si dhe nga portretizimi i njëanshëm i [Rosisë si viktimë](#).

E gjithë kjo mund të nxisë qëndrim përgjithësisht pozitiv ndaj Rosisë, duke zbutur perceptimin e Rosisë si dikush që përdor fuqinë e saj ushtarake për të zgjeruar ndikimin e saj dhe krijon perceptim të Rosisë si mbrojtës i mundshëm, jo agresor i mundshëm.

Në kontekstin e prezencës së madhe të artikujve nga mediat serbe që ushqejnë qasje negative ndaj NATO-s, kjo po merr vull.

Numri i informacioneve dhe artikujve mbi marrëdhëniet midis Rosisë dhe Ukrainës që tregojnë situatën e përgjithshme dhe nga një këndvështrim tjetër rritet me rritjen e mundësisë së konfliktit, pra hyrjen e forcave ushtarake ruse në territorin e Ukrainës, që në javët të merr përmasa të mëdha. Në janar 2022, u shfaqën për herë të parë artikuj që flisnin për [fuqinë ushtarake](#) dhe ndihmën ushtarake që Shtetet e Bashkuara dhe [NATO](#) kanë filluar të manifestojnë / ofrojnë në lidhje me konfliktin.





## Mungesa e analizave origjinale

Ende nuk ka analiza nga autorë vendas, por burimi i informacioneve (të paktën në mediat më të njohura) është, mbi të gjitha, mediat perëndimore.

Informacionet që përpiqen të japin pasqyrë objektive të situatës po rriten gradualisht në numër (dhe në masë të madhe “mbulon” ata që vazhdojnë të transmetojnë përmbajtje anti-NATO në disa prej mediave dhe përmbajtje që nënvlerësojnë çdo formë sanksioni në rast të agresionit të mundshëm nga Rusia, pra agresioni i tillë paraqitet si moral dhe i justifikuar.

Megjithatë, mbetet problemi me transmetimin e përmbajtjeve që promovojnë shumë hapur mbështetjen për Rusinë në konfliktin me Ukrainën përmes rrjeteve sociale. Domethënë, informacionet zyrtare dhe transmetimi i përshkallëzimit të konfliktit, të përcjella në një sërë mediash nuk transmetohen më tej nga rrjetet sociale, për dallim nga përmbajtjet me të cilat mbështetet Rusia, të cilat transmetohen përmes grupeve në Facebook dhe grupeve joformale që organizojnë protesta dhe deklarohen si kundërshtar të hapur të NATO-s dhe përkrahës të heshtur të Rosisë. Për më tepër, në portalet dhe faqet e internetit joformale që nuk kanë informacion të printuar dhe transparent për pronësinë, përmbajtje të tilla prodhohen nga njerëz që disa qytetarë i perceptojnë si gazetarë seriozë.

## Informimi për qëndrimet e politikanëve maqedonas në lidhje me Rusinë

Në vitet e fundit, politikanët maqedonas në pushtet rrallë kanë folur për marrëdhëniet me Rusinë. Kur e bëjnë këtë, zakonisht përpiqen të ulen në dy karrige dhe në asnjë rast nuk bëjnë akuza të hapura kundër Rosisë. Kështu, për shembull, në vitin 2019, kryeministri Zoran Zaev për aferën me shakaxhinjtë rusë, e cila zyrtarisht u cilësua si “sulm hibrid” nga zyrtarë të qeverisë, deklaroi se “nuk është akt i Federatës Ruse, vend që është miku ynë”.

Lidhur me konfliktin e Rosisë me Ukrainën, ministrja e sapoemëruar e Mbrojtjes Slavjanka Petrovska, dha mbështetje të hapur Ukrainës për herë të parë. Kjo deklaratë u transmetua nga një sërë mediash në Maqedoninë e Ve-

riut, por gjithashtu [shkaktoi ortek fyerjesh dhe poshtërimi](#) (të cilat përdoren përsëri për të [theksuar fuqinë ushtarake të Rusisë](#)).

Përkundër kësaj, mbështetje e hapur për Rusinë (edhe në konfliktin me Ukrainën) jepet nga një [numër shumë i vogël](#) politikanësh dhe ata zakonisht janë jashtë pushtetit. Një numër edhe më i vogël i politikanëve të përfshirë aktualisht në strukturat qeveritare bëjnë deklarata që mbështesin hapur Rusinë dhe kundërshtojnë orientimin e Maqedonisë në NATO.

[Njëri prej tyre është deputeti Apasiev](#), i cili i përket partisë “E Majta” (parti që fitoi dy deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2020-ës dhe që në [programin e saj zgjedhor](#) thekson qartë se është e përkushtuar që Maqedonia të largohet nga NATO).

**Lideri i “Të Majtës”, Dimitar Apasiev, është takuar me ambasadorin e Rusisë në Shkup, Sergei Bazdnikin, në përfaqësuesen “Dhoma e Strugës” në Kuvend. Nga partia e deputetit thonë se profesori dhe diplomati, ndër të tjera, kanë diskutuar për postimin e famshëm në Twitter, me të cilin ministri i Punëve të Jashtme Bujar Osmani i ka dhënë mbështetje SHBA-së në përballjen me tensionet në kufirin ruso-ukrainas.**

*Deklaratat e Apasiev kanë për qëllim perceptimin pozitiv ndaj Rusisë.*

Mund të konstatohet se në disa nga mediat, portalet dhe faqet e internetit brenda rrjeteve sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është ndërtuar kanal për ndërtimin e vazhdueshëm të qëndrimit pozitiv ndaj fuqisë ushtarake të Rusisë dhe nxitjen e magjepsjes për përmasat e saj.

Është shumë e vështirë të përcaktohet ndikimi i vërtetë që kanë këto lloj informacione në publikun e gjerë, por fakt mbetet prania e vazhdueshme e këtij lloj perceptimi që mund të hidhet lehtësisht në sipërfaqe dhe të shumëfishohet në kohë krize dhe veçanërisht në kushte të pakënaqësisë në rritje në vend nga (mos)përkrahja që merr në proceset integruuese evropiane.





# BESIMI NË MJEKËSI SI MJET I NDIKIMIT RUS

Besimi i krijuar më parë në shkencën dhe mjekësinë sovjetike dhe ruse përdoret si mjet i ndikimit politik, veçanërisht në lidhje me pandeminë Covid-19 dhe vaksinat.

Shkruan: prof.dr Mirjana Najčevska,

eksperte për sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut

(Vertetmates, 23.02.2022)

## **Besimi është një mjet i fuqishëm në përhapjen e ndikimit rus në Maqedoninë e Veriut.**

Në rastin e Rusisë, bëhet fjalë për besim që është ndërtuar prej dekadash dhe që mund, por nuk duhet të bazohet në elemente reale. Zakonisht është besim i bazuar në perceptimin e zhvillimit të lartë dhe arritjeve të mëdha në zhvillimin e shkencës, veçanërisht në mjekësi në Rusi (ish-BRSS). Besimi i bazuar në perceptimin (përsëri pavarësisht nëse ka të dhëna përkatëse dhe elemente faktike) se Maqedonia ka [mbështetjen](#) dhe ndihmën e Rusisë (pavarësisht sjelljes gjithmonë [problematike](#) dhe [të dyshimtë](#) të “Evropës” dhe vendeve/demokracive perëndimore në përgjithësi dhe “[standardeve të dyfishita të tyre](#)“).

Ky besim promovohet në rrjetet sociale nga profesorë të njohur në Maqedoninë e Veriut (dhe anashkalohen [zhvillimet reale](#), të cilat nuk korrespondojnë me deklaratat e dhëna):

***[Tweet nga prof. dr. Tanja Karakamisheva, bartëse e posteve të larta shtetërore në periudhën e shtetit të robëruar, me tekst për një iniciativë të sajuar ndërkombëtare kundër emrit të ri kushtetues të Republikës](#)***





***së Maqedonisë së Veriut (RMV): “Pritet pas nismës së Rusisë, Kinës dhe Turqisë për emërimin e Maqedonisë si Republika e Maqedonisë, e jo si RMV të qëndrojnë shumë shtete anëtare të OKB-së, të cilat do ta informojnë Qeverinë dhe Presidentin se do ta përdorin emrin Republika e Maqedonisë. SHAH-MAT ose ...”***



Një shembull interesant i një mënyre specifike të ndikimit të Rusisë në Maqedoni bazuar në besim është mbulimi mediatik i pandemisë në lidhje me përhapjen e Covid-19.

Edhe në këtë rast janë më së shumti informacione që shpërndahen në rrjetet sociale dhe në një numër të kufizuar portalesh dhe mediash, por ato gjejnë vend edhe në mediat e njohura (duke marrë parasysh [nivelin e ulët të besimit](#) të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut në media në përgjithësi). Ndikimi që lajmet e tilla kanë në publikun e gjerë mund të dallohet në frazat, fjalët dhe shpjegimet që shpërndahen, të cilat në tërësi ose në shumë aspekte ngjajnë me ato të promovuara përmes portaleve që haptazi janë pro-ruse.

Kur bëhet fjalë për besimin ndaj Rusisë si një nga mënyrat për të përhapur ndikimin rus, ky besim duhet të lidhet me mosbesimin ndaj vendeve të Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara (si ana tjetër e medaljes) të ngulitur në vetë informacionet.

Në këtë rast, mund të identifikohen tre grupe informacionesh/tekstesh përmes të cilave mund të identifikohet ndikimi rus (të cilat duken madje kontradiktore me njëra-tjetrën, por në fund të fundit bazohen në besimin në Rusinë dhe çojnë në forcimin e këtij besimi).

### Teori konspirative për pandeminë Covid-19

**Grupi i parë i teksteve** i referohet mohimit të pandemisë, ekzistencës së virusit dhe veçanërisht problematizimit të mënyrës së trajtimit të tij (bazuar në informacionin e shpërndarë nga mediat ruse ose referuar mjekëve/shkencëtarëve rusë).

Mohimi i pandemisë është [shpesh i drejtpërdrejtë dhe shumë i hapur](#):

**Pas Britanisë edhe Mjekësia ruse me të njëjtin qëndrim: Covid-19 nuk është infeksion i rrezikshëm – paniku është fabrikuar!**

Por, shpesh nuk është i drejtpërdrejtë, por shumë delikate, megjithatë tregon shumë qartë qëllimin e “vendeve perëndimore” për të përdorur [“gënjeshtra pandemike”](#) me qëllim për të zvogëluar të drejtat dhe liritë e njerëzve:

**Paniku nga virusi i ndryshuar “shumë i transmetueshëm” që përhapet nëpër vendet evropiane – përfshirë Gjermaninë, Danimarkën dhe Irlandën, ndër të tjera – ka bërë që qeveritë atje t’i mbyllin edhe një herë këto kombe.**

Mohimi i ekzistencës së virusit është zbuluar me [kuazi-analiza](#), të cilat ofrojnë shpjegime politike për mënyrën se si pandemia përdoret në botë. Zakonisht kjo lloj “analize” përmendet nga një analist/shkencëtar nga Rusia (në shumë raste edhe me një emër ose mbiemër të shkruar gabimisht), për të cilin nuk ka asnjë provë, që është në [ndonjë mënyrë e rëndësishme](#) për fushën e caktuar:





**Një analist i shquar në Qendrën Ruse për Kërkime Ushtarake-Strategjike në Shtabin e Përgjithshëm të Federatës Ruse – koloneli Vladimir Kvatkov, analizoi psikozën botërore të shkaktuar nga koronavirusi.**

...

**Pandemia, e cila nuk ekziston, është një operacion special strategjik global. Është ushtrim për komandim dhe kontroll në prapaskenë, për të fituar kontroll të plotë mbi njerëzimin. Kjo është prapaskena e shfaqjes së koronavirusëve. Bota e prapaskenave, veçanërisht ajo financiare, synon të reduktojë popullsinë e vendit. Sipas tyre, ne jemi shumë në planet. Duhet të ketë rreth njëqind milionë ose më shumë shërbëtorë, maksimumi rreth një miliard në tokë.**

Retorika e publikimeve të tilla janë teori konspirative, të cilat portretizojnë pandeminë si mjet nga qendrat “perëndimore” të pushtetit për të vrarë një pjesë të popullsisë së botës, që të mbijetuarit t’i përdorin si “shërbëtorë” ose “skllëvër”, nga faqet e autorëve anonimë dhe pronësi të fshehura, më pas kalojnë në diskursin politik.

### Glorifikimi i rolit rus në luftën kundër pandemisë Covid-19

**Grupi i dytë i teksteve paraqet glorifikim të arritjeve të Rusisë në luftimin e pandemisë, [zbulimin dhe efikasitetin e vaksinës ruse](#) dhe përparimin në zbulimin e një [ilaçi kundër Covid-19](#).**

Kjo linjë më tej zhvillohet në [kritikat ndaj qeverisë, për shkak të vonesës për dorëzimin e një kërkese drejtuar Rusisë për vaksinat e tyre](#), madje edhe nga politikanët/deputetët aktualë:

**Ej, a është e vërtetë që idiotët rusofobikë nga qeveria e injoruan ofertën direkte për vaksinat ruse, ndaj aplikuan përmes mekanizmit KOVAKS të OBSH-së. Dhe, op, ata ranë përsëri – vaksina ruse !? Çfarë paaftësie kolosale keni moj nënë!”, [shkruan](#) deputeti nga radhët partisë “E Majta”, Dimitar Apasiev.**



Në mënyrë të ngjashme, [në rrjetet sociale](#), qeveria haptas quhet rusofobike, akuzohet se një marrëdhënie e tillë buron nga dëshira për të qenë pjesë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian (BE) dhe se bëhet fjalë për:

**... skllavëri servile ndaj NATO-s dhe BE-së.**

Mesazhi përforcohet duke [vënë në dukje vendet që e kanë bërë tashmë këtë \(blerjen e vaksinës ruse\)](#), duke shprehur shqetësimin për [heshtjen e shtetit](#), dhe në veçanti informacionin për veprimet e duhura të [autoriteteve serbe](#) dhe reagimin miqësor nga Rusia:

**Nuk jam plotësisht në dijeni nëse një kërkesë për ndihmë ka ardhur nga Serbia. Sido që të jetë, nuk ka dyshim se kjo kërkesë nuk do të mbetet pa përgjigje, veçanërisht sepse është një vend i rëndësishëm, aleat dhe vëlla, *tha Peskov.***

Tensionet po rriten dhe po nxehen vazhdimisht me nxjerrjen e të dhënave për ndihmën “e madhe” dhe “vetëmohuese” [që po e merr Serbia](#).

Në rrjetet sociale paraqiten [përfaqësues të partive](#), që hapur shpërndajnë dezinformata dhe në të njëjtën kohë e promovojnë vaksinën “Sputnik V” si e vetmja e sigurt në përballjen me pandeminë:

**Së pari, shumë vende në Evropë dhe në botë e kanë ndaluar përdorimin e vaksinës Astra Zeneka për shkak të pasojave katastrofike të marrjes së saj. Së dyti, të ashtuquajturat kovid-mekanizma është një sistem i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili merr vaksinën falas për ta shpërndarë në vendet e paafta, që nuk mund të menaxhojnë vetë.**

Është interesante se edhe [disa mjekë \(ndoshta pa dëshirë\)](#) vendosen në mbështetje të vaksinës ruse:





Mendoj se vaksina Sputnik V nuk do të arrijë më në vend, ky është qëndrimi im personal për shkak të problemeve politike me Rusinë, tha dr. Nikola Panovski për Fokus. Sipas tij, kjo vaksinë është dëshmuar si një nga më efektivet në luftën kundër koronavirusit dhe qytetarët që do të vaksinohen me “Sputnik V” mund të duhet të udhëtojnë sërish jashtë vendit për t’u vaksinuar me dozën e tretë.

Shumë media po sensacionalizojnë pretendimet për besim të lartë në këtë vaksinë (edhe në anglisht) dhe krijojnë përshtypjen se ajo është gjerësisht e pranishme në vendet fqinje, anëtare të BE-së:

### Kroatët pushtojnë ambasadën ruse, duan të vaksinohen me Sputnik V



*Faqja e agregatorit Time.mk me linke të artikujve (11.2.2021) bazuar në deklaratën e Ambasadës Ruse në Kroaci (08.2.2021), në të cilën përmendet se gjoja “kanë marrë një sërë pyetjesh” nga qytetarët në lidhje me blerjen e vaksinave. Shumë media maqedonase përdorin tituj sensacional si “Kroatët duan vaksinën ruse, djegin telefonat në ambasadën ruse në Zagreb”, “Ambasada ruse nën rrethimin e kroatëve për vaksinën”, “Kroatët pushtojnë ambasadën ruse në Zagreb...”. Në raportime të ndryshme alarmohet për “dhjetëra e dhjetëra”, deri në “qindra” e “mijëra” kroatë, mbështetur edhe me fotot e njerëzve. E vërteta është se nuk ka pasur asnjë tubim dhe*

*fotografitë në të cilat shihen mijëra njerëz, janë nga një protestë kundër masave epidemiologjike në sheshin kryesor në Zagreb, të cilat nuk kishin asnjë lidhje me ambasadën, të mbajtura një javë më parë (3 shkurt 2021).*

Në artikujt në mediat maqedonase ose në rrjetet sociale, vaksina “Sputnik V” (prodhuar në Rusi) në asnjë moment nuk shoqërohet me ndonjë formë të qëllimeve negative, efekteve anësore apo mënyrave të imagjinuara të kontrollit (çipim, vrasje), gjë që është bërë në mënyrë të përsëritur me vaksinat e prodhuara në vendet e Evropës Perëndimore. Ky informacion ndahet veçanërisht përmes rrjeteve sociale:

**Vaksina ruse Sputnik V ka vërtetuar tashmë sigurinë dhe efikasitetin e saj. Pas marrjes pothuajse nuk ka asnjë efekt të pākëndshëm, anësor, ndryshe nga vaksinat e tjera të përdorura në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara.**

Shumë pak media maqedonase raportojnë dhe shpjegojnë pse vaksina ruse nuk njihet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) dhe autoritetet shëndetësore dhe qeveritare në një numër vendesh – sepse prodhuesi nuk ka ofruar informacion të plotë për prodhimtarinë dhe provat klinike në OBSH.

Mungojnë edhe shumë/informacione të detajuara për reagimet e mundshme negative nga vaksina ose pasojat afatgjate, ndryshe nga informacionet e tilla për vaksinat e tjera (të zhvilluara nga vendet e Evropës Perëndimore). Kjo nuk i pengon mediat të formulojnë mesazhe që mund të perceptohen si rekomandim në lidhje me vaksinën ruse.

Informacionet më tej përmirësohen dhe zgjerohen edhe në mediat që kanë vlerësim relativisht të lartë dhe kanë ekzistuar prej kohësh:

**Vaksinat kryesore të prodhuara në Perëndim kanë pothuajse të gjitha probleme. Ose problemi është në procesin e prodhimit (dhe shpërndarjes), ose është përcaktuar se do të jenë të disponueshme më vonë (dhe Evropa nuk ka kohë për të vonuar),**





**ose studimet e reja sugjerojnë se këto vaksina mund të jenë më pak efektive në krijimin e imunitetit ndaj variacioneve të reja të koronavirusit, që u shfaqën si pjesë e kësaj pandemie. Papritur, vaksinat që “as nuk duhej të ishin përmendur” jo vetëm që janë të mira, por edhe të lavdëruara, veçanërisht Sinofarm e Kinës dhe Sputnik V e Rusisë (pas publikimit të sturimit në revistën mjekësore “Lanset”).**

Madje këto media madje edhe nxirret përfundim se ka [presion të drejt-përdrejtë ndaj Rusisë](#) nga ana e Perëndimit:

**Një gjë ka qenë konstante vitet e fundit, për gati dhjetë vjet – presioni i Perëndimit ndaj Rusisë.**

...


**Gjithashtu nuk është sekret se gjatë gjithë kësaj kohe Evropa ka qenë bartëse e politikës amerikane ndaj Rusisë, politikë që vjen deri te “izolimi dhe rrethimi” i Rusisë.**

...

**Por Evropa “dëshiron të ndërhyjë” në punët e brendshme të Rusisë.**

Pa asnjë të dhënë reale, përhapen informacione se edhe vendet e Evropës Perëndimore (shtetet anëtare të BE-së) kërkojnë vaksinat Sputnik V ([si më pak të dëmshme](#), por edhe me shumë të mira brenda vetes):

**Disa anëtarë të BE-së drejtohen kah Rusia dhe Kina, madje edhe presidenti francez Macron, pyet nëse tani vaksinat AstraZeneca (dhe prodhuesit e tjerë perëndimor të vaksinave) ia vlen të merren. Duket se vështirësitë në dhënie dhe ruajtjen e vaksinës AstraZeneca-Oxford, të kombinuara me pyetjet pa përgjigje në lidhje me efikasitetin dhe sigurinë e vaksinës, po bëjnë që kërkesa të bie, jo vetëm në Mbretërinë e Bashkuar, por në të gjithë Evropën.**



Si rezultat i gjithë kësaj, një pjesë e madhe e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut janë pro vaksinës ruse, siç [përshkruhet në artikullin me titull](#) “Sputnik V, ku je?” Maqedonasit ëndërrojnë vaksinat ruse!

**Pavarësisht se në vendin tonë një numër i madh i qytetarëve do të donin të vaksinoheshin me “Sputnik V”, siç tregon sondazhi i “Makfax”, sipas të cilit një e treta e qytetarëve të anketuar kanë zgjedhur vaksinën ruse, por edhe sipas informacioneve se maqedonasit që u vaksinuan në Serbi zgjodhën vaksinën e prodhuesit rus, për momentin autoritetet në Maqedoni nuk mund ta ofrojnë këtë, thuhet në artikull.**

Pretendimi se “Sputnik V” është vaksinë më e mirë [vazhdon](#) edhe sot e kësaj dite, [ndërsa plasohen edhe pretendime](#) (plotësisht të pakonfirmuara) se kjo vaksinë mbron nga llojet dhe nënlojet e reja të virusit.:





## Sputnik V ofron mbrojtje më të mirë kundër omicronit sesa vaksina Pfizer

E gjithë kjo përditësohet me artikuj që përshkruajnë barnat për Covid-19 të promovuara dhe të përdorura tashmë në Rusi, madje [edhe të regjistruara zyrtarisht](#):

### Rusia ka regjistruar një sprej kundër Covid-19, pacientët shërohen për vetëm tetë ditë

Mozaiku plotësohet nga një numër artikujsh që promovojnë gjetje specifike nga shkencëtarët rusë që ndihmojnë në luftimin e Covid-19, si p.sh. [“Shkencëtarët në Universitetin Shtetëror të Shën Petersburgut: Vaksinimi kundër tuberkulozes mund të zvogëlojë përhapjen e Covid-19 dhe të lehtësojë përparimin e tij”](#) dhe [“Rusia po zhvillon një vaksinë unike kundër koronavirusit”](#).

**Shkencëtarët rusë po punojnë për të zhvilluar një vaksinë unike që do të mbrojë njëkohësisht si nga gripi ashtu edhe nga koronavirusi, tha të mërkurën drejtori i përgjithshëm i Qendrës Kombëtare për Kërkime Mjekësore “Almazov”, Evgeny Shakhto.**

Kjo kompletohet me [informacione të pasakta ose të munguara](#) (veçanërisht në fillim të pandemisë) për [gjendjen reale](#) me Covid-19 në Rusi, numrin e rasteve dhe vdekjeve.

**Në përgjithësi, sipas vlerësimeve të presidentit rus Vladimir Putin, numri i rasteve me COVID-19 aktualisht është në [rënie](#) dhe “pandemia me të vërtetë gradualisht po hiqet”.**

**Grupi i tretë i teksteve ndërton/konfirmon besimin ndaj Ruisë në rastin e përbaljes me pandeminë me pretendimin se Rusia kujdeset për njerëzit, jo për të ardhurat.**

Prej atje njoftojnë se qytetarët e Maqedonisë mund të kenë qasje në vaksinën ruse nëse qeveria vendos të blejë vaksinën ruse dhe Fondi i Investimeve Direkte Ruse është i gatshëm të fillojë negociatat, duke përfshirë dërgimin e vaksinës, e cila “me siguri do të jetë në dispozicion me çmimin më konkurrues”.

Në media nuk ka asnjë informacion për shumën e fitimeve të kompanive farmaceutike në Rusi, shtetit apo individëve lidhur me vaksinën kundër Covid-19 (krijohet përshtypja se ky është një akt i vullnetit të mirë, ose tarifë minimale), për dallim nga numri i madh i informacioneve të tilla në lidhje me vaksinat e tjera.



***TNjë postim në Twitter që nuk ka link me revistat shkencore të përmendura dhe tekstin: “Vaksina ruse Sputnik V është produkt i një instituti ushtarako-shkencor, jo i një kompanie farmaceutike. Thonë se vepron ndaj të gjitha llojeve të koronës. E fundit nga Lancet është se është 91% efekase dhe nuk ka efekte anësore të mëdha. “AstraZeneka britanike punon me rusët”.***

Perceptimi se Rusia punon për të mirën e njerëzve, jo për përfitime, përforcon transmetimin e deklaratave të tilla si:





**Shkencëtari theksoi se Rusia mund të jetë donator efikas dhe ekonomikisht fitimprurës i dërgesave të vaksinave në vendet që nuk kanë vaksinat e tyre, me qëllimin e vetëm për të mbrojtur popullsinë botërore nga Covid-19.**

## Keqpërdorimi i besimit si mjet për ndikim politik

Ndikimi që përdor besimin si mjet, mund të jetë shumë i fuqishëm dhe i vështirë për t'u zbuluar.

Pandemia dhe përballja me të hapi dyert për dy linja të ndikimit të Rusisë përmes mediave dhe rrjeteve sociale në Maqedoninë e Veriut.

Linja e parë fokusohet në forcimin e besimit ekzistues në Rusi dhe zgjerimin dhe përmirësimin e tij, duke përdorur promovimin e drejtpërdrejtë të përfshirjes së Rusisë në trajtimin e pandemisë, futjen indirekte të informacioneve plotësisht të paverifikuara për Rusinë në përpjekjet për të menaxhuar me pandeminë globalisht dhe akuzat e drejtpërdrejta ndaj Qeverisë aktuale të Maqedonisë së Veriut për mungesën e bashkëpunimit më të madh me Rusinë.

Megjithatë, shumë më problematike dhe më e frikshme është linja e dytë e ndikimit e cila bazohet në krahasimin e Rusisë dhe BE-së dhe SHBA-së, me qëllim për të ndërtuar elementë mosbesimi ndaj BE-së dhe SHBA-së bazuar në të dhëna të njëanshme, të paplota dhe/ose jo-ekzistuese, dehumanizimin e tyre dhe krijimin e dyshimeve të vazhdueshme, manipulimit dhe qëllimet e liga dhe/ose dëshirë e thjeshtë për të fituar.



# NDJENJA E PËRKATËSISË SI MJET I NDIKIMIT RUS NË MAQEDONINË E VERIUT

Një nga mënyrat më të thjeshta të ndikimit tek një rreth më i gjerë i njerëzve, e që po përdoret në vazhdimësi nga ana e Rusisë gjatë veprimit të saj në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është ndërtimi dhe kultivimi i narrativit për përkatësi të përbashkët (në marrëdhëniet ndërkombëtare kjo teori njihet edhe si „aleancë natyrore“). Uniteti dhe përkatësia e përbashkët lidhen me sllavizmin, fenë, gjuhën, traditën, ndërsa kohëve të fundit gjithnjë e më shumë edhe me sistemin e vlerave i cili i bën që si shtete dhe popuj të dallojnë nga ai „Perëndimor“

Shkruan: prof.dr Mirjana Najčevska,

eksperte për sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut

(Vertetmates, 25.03.2022)

## Prejardhja dhe lidhshmëria tradicionale

Edhe pse sllavizmi si pikë lidhëse me Rusinë nuk përmendet edhe aq shpesh (siç ndodh në Serbinë fqinje apo në periudhën kur antikizimi në Maqedoni ende nuk kishte marrë aq shumë hov), ai nuk duhet të neglizhohet. Përkatësia e sllavizmit paraqitet edhe si një mallkim dhe si një dhuratë, por sido që të jetë ajo promovohet, në heshtje dhe tinëz, [kundrejt atyre të tjerëve të „Perëndimit“](#):

**Bota e sllavëve të asocion në një diegie emocionale, pasione të shfrenuara, irracionalitet vetëvrasës, dalldi ortodokse dhe përzjerje eksplozive lotësh dhe hareje. Nga ana tjetër,**





**Perëndimi konsiderohet si i matur dhe tolerant, protestant racional dhe i qytetëruar. Dhe ja, erdhi koha që luftërat e përditshmërisë sllave të duken si një sfidë banale fëminore në raport me ato perëndimoret.**

Sllavizmi është gjithmonë i pranishëm në tekste të [që kremtojnë Kirilin dhe Metodin](#)

**Dita e iluministëve mbarëmaqedonas dhe mbarësllavë, Dita e kulturës dhe shkrimit mbarëmaqedonas dhe mbarësllav, Dita e Vëllezërve nga Selaniku, dita e Apostujve të shenjtë maqedonas Kirili dhe Metodi!**

Shumë shpesh e përbashkëta implikohet me përdorimin e termave „popuj vëllazëror” dhe „marrëdhënie vëllazërore”. Me këto terma (të cilat gjenden në një pjesë të madhe të teksteve, sidomos atyre në rrjetet sociale) promovohet dhe [mbështetet ideja për një lidhshmëri tradicionale](#) mes Ruisë dhe Maqedonisë, pra popullit rus dhe atij maqedonas:

**MËMËDHE MAQEDONIA do të rinovojë marrëdhëniet e ngushta dhe vëllazërore me Rusinë, të ndërprera në mënyrë të panatyrshme nga interesat e tjera globale në shekullin e kaluar dhe, siç thuhet në strategjinë e programit gjeostrategjik, do ta përfshijë Maqedoninë në Bashkimin Euroaziatik të popujve liridashës vëllazërore nga Lisbona e deri në Vladivostok.**

**Kështu do të ripërtërijmë lidhjet e ngushta historike midis dy popujve vëllazërore që i kanë rrënjët tek Aleksandri i Madh me Bodriçët (Obodritët) dhe Ruriku, i cili mori pjesë në krijimin e shtetit rus, përmes iluminuesve maqedonas dhe gjithëslavë Shën Klimenti dhe Naumi, Shën Kirili dhe Metodi,**

**nëpërmjet pjesëmarrjes së regjimentit vullnetar maqedonas në luftën e Krimesë në shekullin XIX dhe veprimtarisë së intelektualëve dhe luftëtarëve maqedonas për liri kombëtare në Shën Petersburg, Dimitrija Çupovski dhe Krste Misirkov, Vëllezërit Miladinov.**

Këto shprehje gjoase dashamirëse për unitetin dhe referimi ndaj rrënjëve historike të lidhjes (të cilat [janë në kundërshtim me faktet historike](#)), kanë si rezultat një mbështetje të qeverisë aktuale në Rusi, madje edhe akte të [mbështetjes së drejtpërdrejtë të agresionit të Rusisë së Putinit ndaj Ukrainës](#):

**Maqedonas, të shtunën në orën 14:30 para ambasadës ruse në Shkup do të organizohet një tubim për të shprehur pakënaqësinë për faktin që hunta pushtuese na futi në listën e armiqve të Rusisë, me moton “Maqedonia e Veriut është armiku juaj, maqedonasi është vëllai juaj!”**

**Shpërndani lajmin dhe të gjithë të bashkuar të shkojmë para ambasadës ruse dhe t’i japim mbështetje Rusisë kundër propagandës dhe rusofobisë në Severxhanistan!!!**

Duke pasur parasysh se ndikimi rus përhapet më lehtë tek ata që shohin rrezik në pranimin e vlerave „perëndimore” dhe demokracisë „perëndimore”, problemi i sllavizmit si emërues i përbashkët bie ndesh me idenë e origjinës së lashtë të maqedonasve të sotëm dhe lidhjeve të drejtpërdrejta me Aleksandrin e Madh.

Për ta zgjidhur këtë kontradiktë, në disa nga portalet shfaqen [„analiza” më ekstreme](#) në të cilat lidhja mes Maqedonisë dhe Rusisë lidhet me origjinën maqedonase të rusëve:





**Për ta mbështetur këtë pretendim, do të përdorim një fragment nga libri Origjina e sllavëve (Historia e vjedhur, Dr. Petar Popovski, fq. 361-362) ku thuhet qartë: “Në dokumentin e lashtë të shkruar Analiza Moskoviane, në mënyrë decide pretendohet se rusët, pra moskovitët, që kanë pasur prejardhje nga territoret maqedonase, kanë folur gjuhë të njëjtë me atë të maqedonasve të lashtë”.**

**Sipas kësaj, rusët kanë prejardhje nga Maqedonia, ashtu siç edhe gjuha ruse i ka rrënjët nga gjuha maqedonase.**

Mirëpo, në tërësi, ata që përhapin idenë e të përbashkëtës dhe lidhshmërisë tradicionale mes maqedonasve dhe rusëve, nuk angazhohen për zgjidhjen e këtij lloj kontradiktash dhe pretendimeve të palogjikshme. Qëndrimi pozitiv ndaj Rusisë ndërtohet më tej edhe përmes [promovimit të mbështetjes së supozuar](#) të Rusisë / Putinit për identitetin maqedonas (me ç’rast përsëri shmanget shpjegimi për atë nëse bëhet fjalë për identitet sllav apo identitet që e ka origjinën nga maqedonasit e lashtë):

**Ambasada ruse në Shkup, duke cituar deklaratën e presidentit të Federatës Ruse, Vladimir Putin, “shkrimi dhe leximi erdhi nga toka maqedonase”, uron popullin maqedonas për festën kombëtare, Ditën e iluminatorëve mbarësllavë Shënjtoreve Kirili dhe Metodi.**

Kjo pastaj përhapet në mënyra të ndryshme (më piktoreske) në rrjetet sociale, duke theksuar rëndësinë dhe me një implikim të qartë për ata „të tjerët” që kontribuojnë në ndryshimin e emrit, gjuhës, identitetit të Maqedonisë dhe maqedonasve.

Lidhja me Rusinë përmes [fesë \(si pjesë e identitetit të përbashkët\) dhe disa deklarata të përgjithshme të Putinit](#) bëhet edhe kur këto deklarata nuk kanë lidhje direkte apo indirekte me Maqedoninë apo popullin maqedonas.



Në këtë mënyrë krijohet përshtypja se ekziston një [mbështetje e vazhdueshme e pushtetit në Rusi](#) (sidomos e vetë Putinit) për mbrojtjen e identitetit të maqedonasve dhe njohjen e rëndësisë dhe meritave të Maqedonisë për të gjithë botën sllave.


**Rusia gjithmonë e ka nohur pa kushtëzim pavarësinë dhe autenticitetin e gjuhës, historisë, kulturës dhe identitetit maqedonas, tha sot ambasadori rus Sergej Baznikin gjatë vizitës së tij në Kumanovë.**

Ky narrativ po përhapet vazhdimisht dhe po fiton në rëndësi, pavarësisht se nuk përkon me realitetin në të cilin Rusia e njeh Maqedoninë me emrin e ri kushtetues [Maqedonia e Veriut](#), as me faktin që Kisha Ruse në asnjë moment [nuk ka shprehur vullnet](#) për ta njohur Kishën Ortodokse Maqedonase, si dhe mungesën [e mbështetjes ekonomike](#) nga Rusia.



**Tregtia përbën rreth 2% të tregtisë të përgjithshme. Investimet e huaja direkte janë 0,5%, kurse remitancat në valutë, të cilat janë motivues i rëndësishëm i ekonomisë maqedonase, gjegjësisht remitancat ruse në Maqedoni marrin pjesë me vetëm 0,1%.**

Ajo që bie në sy është se këto lloj tekstesh po përhapen në rrjetet sociale posaçërisht këto kohëve të fundit (që nga fillimi i agresionit të Rusisë së Putinit kundër Ukrainës), pavarësisht se për herë të parë janë shkruar/shpërndarë shumë më herët.



## Tradita dhe vlerat e përbashkëta

Një mënyrë veçanërisht mbresëlënëse e ndikimit të Rusinë në Maqedoni është përmes pretendimit se të dy popujt/vendet kanë një traditë të përbashkët dhe veçanërisht një sistem të përbashkët vlerash (të kundërta me vlerat, të cilat nëpërmjet të mesazheve në media dhe rrjete të caktuara sociale, përpiqen t'i imponojë vendet „perëndimore”).

Në të shumtën e rasteve mesazhi është i dyanshëm. Ai tregon për një bashkësi të qartë të sistemit të përgjithshëm të vlerave me Rusinë dhe thekson dallimet në raport me vendet „perëndimore”.

Për shembull, në kollumnën me titull: [„Na falni Zonja Gallouej, por nuk mund të besojmë në vlera të njëjta“](#) kushtuar „standardeve të dyfishta” të demokracisë „perëndimore” kundrejt Federatës Ruse, ka një fjali në të cilën befaz përmenden Kozakët (ndoshta si një antipod i sllavëve?):

**Epo, ju kujtohet largimi i familjes tuaj në Angli në vitin 1911, pasi Kozakët u përpoqën të merrnin (supozoj që ta rrëmbejnë me forcë) stërzhaxhain tuaj katërvjeçar. Dhe duhet të mbani mend, sepse shkulla e rrënjëve për çdo familje është një tragedi më vete me të cilën edhe unë bashkëndej.**

Jo rrallë herë shfaqet pretendimi sipas të cilit „Perëndimi“ nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë mik i sllavëve. [Ata udhëhiqen sipas tij, por vetëm për një kohë të shkurtër.](#)

**Dostojevski paralajmëron se Rusia duhet të përgatitet seriozisht për sjelljen e ardhshme të sllavëve, të cilët me entuziazëm do t’i drejtohen Evropës deri në atë pikë sa të humbasin individualitetin e tyre kombëtar, kulturën dhe traditat e tyre. Ai thotë se ata do të infektohen me virusin e institucioneve evropiane, por do të kenë një rrugë të gjatë drejt evropianizimit, duke humbur dalëngadalë identitetin, e me këtë edhe rëndësinë e tyre si popuj sllavë. Ndonëse njerëzit do ta kenë për një kohë të gjatë ndjenjën se Evropa nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë një mike e vërtetë dhe as nuk mund të pritët të ndihmojë në ndonjë telash më të madh, ata do të përpiqen të vendosen nën ombrellën e saj.**

Këto lloj tekstesh nuk vendosen në kontekstin e situatës aktuale, lidhjes së vendeve me popullsi kryesisht sllave me „Perëndimin”, aspiratën e shprehur qartë për unitet brenda BE-së dhe sigurisht ndihmën dhe mbështetjen ekonomike që vjen nga „Perëndimi”.





Kjo pasohet nga një sërë analizash të vlerave evropiane [analizash të vlerave evropiane \(të cilat vendosen në kolizion me ato të tjerat, ato që nuk janë si të Evropës Perëndimore\)](#):

**Termi tjetër është termi vlerat evropiane. Ky term lidhet me termin integritet euroatlantike dhe përdoret gjithmonë në kontekstin e tij. Ata kanë për qëllim që të krijojnë një imazh që në BE dhe NATO njerëzit jetojnë sipas vlerave evropiane, ndërsa çdo gjë jashtë tyre është pa vlera, e paqytetëruar e që nëse dëshiron të qytetërohet, i duhen ato integritet e famshme euroatlantike. Problemi i parë është se vlerat evropiane nuk kufizohen vetëm brenda kufijve të vendeve të BE-së dhe NATO-s. Vlerë evropiane është edhe alfabeti glagolik, edhe ai qirilik, Koneski, Racini, Andriqi, Dostojevski, Çajkovski etj. Përveç kësaj, Evropa, kur mendohet për Perëndimin, nuk ka prodhuar vetëm vlera. Produkti i Evropës Perëndimore është edhe shovinizmi, imperializmi, racizmi, fashizmi dhe nazizmi.**

Kjo shpesh përfundon me glorifikimin e Rusisë dhe veçanërisht të Putinit [për luftën e tij për vlerat tradicionale](#).

**Vladimir Putin e lexoi mesazhin e tij vjetor si President i Federatës Ruse drejtuar Asamblesë Federale. Këtë vit mesazhi u lexua në ditën e 20 vjetorit të Kushtetutës së Federatës Ruse, e cila u miratua më 12 dhjetor 1993, me votim universal. Në fjalimin e tij, Vladimir Putin theksoi se Rusia do të vazhdojë të mbrojë vlerat tradicionale:**

Mbështetja më eksplicite e atyre vlerave ndryshe të cilat i ofron Rusia kundrejt atyre „Perëndimore” bëhet në faqen e internetit [Slloboden Svet](#), e cila vazhdon të përcillet në rrjetet sociale:



**Jemi të bindur se civilizimi perëndimor, me modelin e tij ekonomik të tregut liberal, politikën e migracionit dhe idetë e shoqërisë konsumatore, çon drejt vdekjes dhe shkatërrimit të të gjithë popullsisë autoktone evropiane dhe vetëm Rusia, si bastioni i fundit i vlerave tradicionale në Evropë, është në gjendje të sigurojë një jetë paqësore dhe të denjë për të gjithë popujt sllavë dhe popujt e tjerë evropian.**

Kështu, injorohet plotësisht fakti që shoqëria konsumatore, tregu liberal dhe politika e migracionit janë po aq të pranishme në Rusi sa edhe në vendet e tjera. Në një pjesë të mediave kjo bëhet duke [transmetuar deklarata të zyrtarëve të lartë rus](#), të cilët aludojnë për afërsinë e popujve dhe mospërputhjen mes asaj që nënkupton opinion publik dhe opinion/qëndrim i grupit aktual politik në Maqedoni, gjegjësisht promovohet se situata aktuale dhe orientimi drejt “Perëndimit” imputohet artificialisht nga strukturat qeverisëse dhe strukturat qeverisëse që janë nën ndikimin e „Perëndimit”,

**Fatkeqësisht Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi ranë nën ndikimin e Perëndimit, nuk arritën të formonin asnjë politikë të pavarur sa i përket Ukrainës dhe iu bashkuan regjimit të sanksioneve frontale. Kjo padyshim që do i godasë vetë edhe ata, duke e komplikuar kështu situatën tashmë të vështirë ekonomike. Natyrisht, marrëdhëniet dypalëshe me Rusinë do tendosen. Për të gjitha këto kemi paralajmëruar gjatë dhe shumë herë. Kujtojmë se linja armiqësore e drejtuesve të vendit ndaj vendit tonë nuk gëzon mbështetje tek publiku. Pavarësisht përpjekjeve të Perëndimit për të imponuar unanimitet shkatërrues, qytetarët e këtyre vendeve janë në gjendje të krijojnë një pasqyrë objektive, ta ndajnë gënjeshtren propagandistike nga faktet.**

„Rendi i ri botëror“, i cili do duhej të bazohet vlerat e përbashkëta sllave [promovohet me analiza të supozuara shkencore/profesionale](#) që





publikohen në rrjetet sociale (të cilat përsëri e injorojnë plotësisht sistemin aktual politik dhe ekonomik në Rusi):

**Rusia nuk ushtron presion ndaj politikës maqedonase, duam që kështu të veprojnë edhe vendet e tjera, deklaroi sot në Shkup Aleksandar Dugin, këshilltari i parë i presidentit rus Vladimir Putin krijues i strategjisë mbarësllave të Rusisë, nga paneli i diskutimit „Republika e Maqedonisë në lidhje strategjike me Rusinë dhe anëtarësim në Lidhjen Ekonomike Euroaziatike“**

Në një numër të caktuar të teksteve kjo ngrihet në nivelin e një konflikti të frikshëm, i cili shpjegohet me urrejtjen e „Perëndimit“ ndaj gjithçkaje që është sllave, madje edhe me synim për të shkatërruar [Skenën mediatike ruse: Përmbytje të kontrolluara me pak hapësirë për mediat e huaja](#). Sipas disa mediave, tashmë po zhvillohet një [luftë biologjike kundër të gjithë sllavëve](#) dhe po prodhohen armë biologjike gjenetikisht të modifikuara që po drejtohen kundër sllavëve.

**Koronavirusi më vdekjeprurës për sllavët – Analisti i famshëm gjeopolitik pretendon se rusët kanë prova për origjinën laboratorike të virusit**

Pretendimi absurd, i cili bazohet në ekzistencën e popujve të pastër gjenetikisht dhe që anashkalon faktin se ukrainasit dhe rusët janë sllavë, zhvillohet në një teori të bazuar në statistika, e krijuar për të bashkuar të gjithë njerëzit me prejardhje sllave [kundër një armiku të përbashkët nga “Perëndimi”](#).

**Ajo që është edhe më e tmerrshme është lista e vendeve sipas numrit të vdekjeve për një milion banorë në botë. Nga 10 vendet me vdekshmërinë më të lartë për një milion banorë, 9 janë anëtarë të grupit të popujve sllavë ose ndajnë një numër të madh gjenesh me popujt sllavë dhe janë vende të Evropës Lindore.**

*Nëse shkojmë pak më poshtë se 30 vende në botë me vdekshmërinë më të lartë prej një milion banorë nga koronavirusi, 19 vende janë nga Evropa Lindore dhe me një popullsi të madhe sllave!*

Tema vazhdon të elaborohet me „shembuj“ konkret por mënyrën në të cilën do duhej të shfaroseshin sllavët:

**Armët biologjike të zhvilluara në Ukrainë ndikojnë në sistemin riprodhues të grave dhe imunitetin e grupeve të caktuara etnike, tha të hënën kreu i agjencisë ruse shtetërore të hapësirës Roscosmos, Dmitrij Rogozin.**

Këto „qëllime“ të tmerrshme të „Perëndimit“ (me gjithë palogjikshmërinë, arbitraritetin e plotë dhe jorealitetin e tyre në aspektin shkencor dhe veçanërisht në aspektin e mungesës së grupeve të pastra etnike) gjejnë vend në rrjetet sociale dhe në media dhe nxisin grupime të reja të bazuara në frikën, sigurinë e përkatësisë në bazë të vlerave tradicionale dhe mbështetjen imagjinare.





# PROPAGANDA RUSE GJATË KRIZËS POLITIKE NË MAQEDONI (2015) – DEZINFORMATATA PËR „SKENAR UKRAINAS”

Analizë e dezinformatave dhe teorive konspirative për „skenarin ukrainas”, „revolucionin me ngjyra” dhe „Maidanin maqedonas” me të cilin propaganda ruse dhe aleatët e saj lokalë në vitin 2015 imponin narrativ për të justifikuar agresionin rus kundër Ukrainës dhe praktikat antidemokratike të regjimeve populiste të Putinit dhe Gruevskit.

Shkruan: Zharko Trajanoski, analist mediatik

(Vertetmates, 10.02.2022)

Tentativat propagandistike të Rusisë zyrtare, e cila u përpoq të [diskreditojë](#) protestat antiqeveritare në Kazakistan si një „revolucion me ngjyra” i drejtuar dhe i planifikuar në Perëndim, bëjnë pjesë në sferën e strategjive „tashmë të para” të komunikimit. Në të njëjtën ditë kur presidenti i Kazakistanit **Kasim-Zhomart Tokajev** [propagandoi](#) për një përpjekje për grusht shteti dhe agresion nga „militantë të huaj”, presidenti rus **Vladimir Putin** [foli](#) për masat për të parandaluar një skenar për „revolucione me ngjyra” dhe përdorimin e „[teknologjive Maidan](#)” në Kazakistan.

Termi „revolucione me ngjyra” është një pjesë integrale e komunikimeve zyrtare të Kremlinit, sidomos pas ngjarjeve në Ukrainë të njohura si „[Revolucioni portokalli](#)” në vitin 2004 dhe „[Euromaidani](#)” në vitin 2012.

„Revolucionet me ngjyra” Moska i konsideron si një kërcënim për sigurinë jo vetëm për Rusinë, por edhe për botën, sidomos pas përfundimit të „Revolucionit Ukrainas (Maidan)” në shkurt të vitit 2014. Putin foli për kërcënimet





nga „revolucionet me ngjyra” në [„Konferencën e tretë ndërkombëtare të Moskës për sigurinë ndërkombëtare”](#), e cila u zhvillua pak para zgjedhjes së **Petro Poroshenkos** si President i Ukrainës më 25 maj të vitit 2014. Në Konferencë „revolucionet me ngjyra” u përshkruan si faktorë për destabilizim në mbarë botën, ndërkohë që u theksuan edhe kriteret për „eksportin” e „revolucioneve me ngjyra” dhe aspektet e „luftës me informacione”.

„Revolucionet me ngjyra” nuk janë vetëm pjesë e propagandës politiko-ushtarake të Rusisë, por edhe pjesë e doktrinës politiko-ushtarake për shuajtjen e tyre. Një tregues për këtë janë [stërvitjet e përbashkëta „Vëllazëria sllave”](#) në vitin 2015, ku morën pjesë trupa ruse, bjelloruse dhe serbe, me qëllim luftimin e një „skenari të mundshëm Maidan”, përfshirë këtu edhe në Ballkan. Ka indikacione serioze për [aktivitete të tjera të Serbisë dhe Rusisë](#) për të luftuar „revolucionet me ngjyra”.

Propaganda politiko-ushtarake ruse dhe doktrina për „revolucionet me ngjyra” u zbatua edhe në kontekstin e krizës politike në Republikën e Maqedonisë në vitin 2015. Maqedonia ishte cak jo vetëm i komunikimeve propagandistike nga Rusia zyrtare, por edhe terren pjellor për dezinformata dhe teori konspirative për „skenar ukrainas”, „revolucion me ngjyra” dhe „Maidan maqedonas”.

Në këtë analizë do të fokusohemi vetëm në periudhën e parë të krizës politike – nga shpallja e rastit „Puçi” deri te „Marrëveshja e Përzhinës” – një kornizë politike për tejkalimin paqësor të krizës politike në Maqedoni në vitin 2015, e cila përkohësisht shpërnda teoritë e errëta konspirative për një „revolucion me ngjyra” të përgjakshëm. Edhe në periudhën e dytë të krizës politike – nga formimi i PSP-së, deri te mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme në dhjetor të vitit 2016, si dhe në periudhën e tretë – pas zgjedhjeve të parakohshme deri në formimin e qeverisë politike më 31 maj të vitit 2017, kishte teori konspirative ruse dhe dezinformata për një „revolucion me ngjyra” në Maqedoni, të cilat do të jenë lëndë e analizave të tjera shtesë.

## Në fillim ishte „Puçi” – „skenari ukrainas” dhe një „revolucion me ngjyra” i ndaluar

Edhe pse paralajmërimet për një „skenar ukrainas” kishte që [para zgjedhjeve](#) në vitin 2014, dhe [në fund të vitit 2014](#), shprehja „skenar ukrainas” u shfrytëzua veçanërisht pas fillimit „zyrtar” të krizës politike në Maqedoni në vitin 2015.

Fillimi i krizës politike zakonisht konsiderohet data kur kryeministri i atëhershëm, **Nikolla Gruevski** [e akuzoi publikisht](#) liderin e atëhershëm opozitar të LSDM-së, **Zoran Zaev**, për tentativë për grusht shteti në bashkëpunim me „shërbime të huaja” (i ashtuquajtur i rasti „Puçi”). Pastaj pasoi edhe një [kallëzim penal nga MPB-ja](#), e cila „informoi” se „për herë të parë në histori është realizuar një rast ku është shuar një tentativë për rrezikimin e rendit kushtetues dhe marrje të pushtetit në mënyrë jodemokratike”. [Moska zyrtare reagoi menjëherë](#) me një „komunikim strategjik” në të cilin [mbështeti narrativin zyrtar](#) për shuarjen e një „grusht shteti” të organizuar nga kryesia e LSDM-së, në bashkëpunim me „shërbimet e huaja”. Ky komunikim befasues nga Moska nxiti [tituj në media](#) për një „skenar ukrainas” dhe [analiza](#) se deklarata e Ministrisë së Jashtme ruse për rastin „Puçi” është në drejtim të mbështetjes së interesave ruse në Ukrainë.

Në të njëjtën kohë, propaganduesit pro-qeveritar nisën një fushatë të ashpër kundër Zoran Zaevit si një „puçist” i cili ka marrë regjistrime të bëra nga shërbime të huaja. Në fushatën negative kundër Zaevit mori pjesë edhe propagandisti politiko-ushtarak serb dhe pro-rus **Miroslav Llazanski**, i cili më vonë u bë [ambasador i Serbisë](#) në Rusi. Deklaratat e tij u popullarizuan në një emision politik me prezantuesin pro-rus **Milenko Nedellkovski** në Kanal 5, një nga televizionet më të ndjekur.

Para publikimit të regjistrimeve nga opozita (të ashtuquajturat „bomba”), në mediat maqedonase u përhapën [teori konspirative](#) në përpjekje për të krijuar një „skenar ukrainas”, të shoqëruara me akuza sipas të cilave Zaev „me ndonjë shërbim të huaj” i kanë lejuar vetes të përgjojnë udhëheqësinë e lartë shtetërore dhe një numër të madh të qytetarëve”.

Më 9 shkurt të vitit 2015 pasi Zaev [e akuzoi](#) kryeministrin e atëhershëm Gruevski dhe kushëririn e tij të parë (shefin e policisë sekrete), **Sasho Mi-**





**jallkov**, për përgjime masive të mijëra qytetarëve, në mediat maqedonase filluan të përhapen teori konspirative për një „skenar ukrainas” dhe „revolucion me ngjyrë”, të përforcuara nga propagandistët pro-rusë.

Për shembull, teoricienti konspirativ pro-rus **Umberto Paskali**, në një [intervistë](#) për programin „Zëri i Popullit” në TV Sonce, shpalosi akuza eksplicite për një tentativë të dëshpëruar për të provokuar një „revolucion me ngjyra” „sorosoid” për ta destabilizuar Maqedoninë. Mesazhet e Paskalit u shpërndanë me dhjetëra artikuj me tituj si – „[Paskali: Maqedonia shman-gi tragjedinë në stilin e Ukrainës, konspiracioni i Zaevit përfundoi në një farsë](#)”, në [televizionet më të shikuara](#) si Sitel dhe Kanal 5, si dhe në dhjetëra [media të tjera](#).]

Analistë të tjerë pro-rusë në [kanalet e propagandës ruse](#) i akuzuan personalisht zyrtarët amerikanë për „një *grusht shteti në Maqedoni në stilin e Kievit*”, duke pretenduar se „bombat Zaevit” ia ka dhënë CIA. Asokohe konspiracione të tilla shpërthyen edhe në [mediat maqedonase proqeveritare](#), me akuza se „Pas Bullgarisë dhe Ukrainës, naftëtarët po e shkatërrojnë edhe Maqedoninë?!”, ku Soros akuzohej jo vetëm si financues i „Maidanit të dështuar maqedonas”, por edhe për përgjimin e 20.000 maqedonasve.

## „Revolucioni me ngjyra” në Shkup si Kievi, „Rrjedha turke” dhe „Shqipëria e Madhe”

Përderisa opozita publikonte regjistrime që tregonin për korrupsion dhe shkelje të ligjit nga qeveria, teoria propagandistike ruse për një „revolucion me ngjyra” po depërtonte në mediat maqedonase. Për shembull, [propagandisti i Sputnik Andrej Koribko](#), i prezantuar si një „analist rus” në TV Sonce, theksoi se „Maqedonia është në mes të një „revolucionit me ngjyra” të qëllimshëm”, ndërsa Zaev pa sukses po përpiqet t’i nxjerrë maqedonasit në rrugë për ta bërë Shkupin si Kievi”.

Tezat propaganduese të Koribkos u shpërndanë në [mediat pro-qeveritare maqedonase](#) dhe në [kanalet propaganduese ruse](#). Edhe në [emisionin e tij në radio](#), Koribko intervistoi të ftuar të cilët mbështesnin tezën propagandistike se tentativa për „grusht shteti” në Maqedoni është, në fakt, një „revolucion me ngjyra” dhe se është i lidhur me teorinë konspirative për të ndaluar „Rrjedhën turke”. Një nga të ftuarit, udhëheqësi i një emisioni propagandistik maqedonas në të cilin paraprakisht si analist ishte i ftuar udhëheqësi serb,



theksoi se „Maqedonia nuk është Ukraina”, se nuk do të destabilizohet, se nuk do të ketë „revolucion me ngjyra” ose luftë civile, dhe se mbështetja për “Rrjedhën Ballkanike” është e madhe. Historia për lidhjen mes „Rrjedhës turke” dhe „Revolucionit me ngjyra” të shkaktuar nga Perëndimi ishte subjekti i kanaleve të tjera propagandistike ruse që ofronin [argumente gjeopolitike](#), që synonin jo vetëm Maqedoninë, por edhe [Serbinë dhe Bullgarinë](#).

Pasi Putin në [Konferencën Ndërkombëtare në Moskë](#) në prill të vitit 2015 ritheksoi rrezikun për sigurinë ndërkombëtare nga skenarë të ndryshëm për „revolucione me ngjyra” që shkaktojnë dhunë dhe kaos, kanalet propagandistike ruse vazhduan me konspiracionet për revolucion me ngjyra në Maqedoni.

Ata futën edhe elementë të rinj – si „terrorizmi shqiptar” dhe „Shqipëria e Madhe”. Pas sulmit të armatosur në afërsi të Goshincës, kur u sulmua kulla e policisë kufitare maqedonase nga një grup i armatosur nga Kosova, [Moska reagoi duke shprehur shqetësim](#). Në të njëjtën kohë, Sputnik i akuzoi Shtetet e Bashkuara se po përpiqen që „revolucionin e dështuar me ngjyra” në Maqedoni ta transformojnë në një luftë jokonvencionale, gjë që do ta neutralizonte [rrugën gjeostrategjike](#) për „Rrjedhën Turke”. Mesazhi se „Goshinca është pjesë e „revolucionit me ngjyra” në Maqedoni” u [përhap në mediat në Maqedoni](#) edhe nga [propagandistë](#) të tjerë [pro-rusë](#).



*Protesta në Shkup në 17.05.2015. Foto: Vanço Xhambaski, CC BY-NC-SA.*





## Zyrtarizimi i historisë propagandistike për „revolucionin me ngjyra” kundër „Rrjedhës turke”

Historia propagandistike „jozyrtare” e Rusisë – se në Maqedoni po ndodh një tentativë për një „revolucion me ngjyrë”, i cili lidhet drejtpërdrejt me projektin energjetik të Rusisë „Rrjedha Turke”, u bë „zyrtare” vetëm pas vizitës së ministrit të Jashtëm rus Sergej Llavrov në Beograd më 15 maj të vitit 2015.

Paraprakisht, në Maqedoni ndodhën tri ngjarje kyçe që e ndezën krizën politike: [Brutaliteti policor](#) gjatë protestave të 5 majit në vitin 2015, të cilat ishin pikërisht kundër brutalitetit policor, paralajmërimi për një protestë masive të opozitës më 17 maj, e cila u [sulmua](#) si „Skenar ukrainas”, dhe [konflikti i armatosur në Kumanovë](#) më 9-10 maj të vitit 2015, për shkak të së cilit presidentit të atëhershëm **Gjorge Ivanov** i duhej të ndërpriste vizitën e tij në Moskë për shënimin e fitores mbi fashizmin dhe të mblidhte Këshillin e sigurisë.

Pak ditë pas konfliktit dramatik, më 12 maj, pasuan dorëheqje nga ministrja e punëve të brendshme, shefi i policisë sekrete – kushëriri i parë i Nikolla Gruevskit dhe një tjetër ministër për të cilin në regjistrimet e publikuara u zbuluan keqpërdorime të mëdha. Ky konflikt nga propagandistët rusë u [interpretua](#) si „një plan djallëzor për destabilizim të Maqedonisë“, dhe liderët e opozitës u quajtën „Arsenij Jacenuk dhe Petro Poroshenko të Maqedonisë“.

Ivanovi vendosi të merrte pjesë në paradën madhështore në Moskë më 9 maj edhe përkundër [bojkotit](#) nga vendet perëndimore për shkak të aneksimit të Krimesë nga Rusia, ndërsa prania e tij, e [lajmëruar](#) fillimisht nga ministri i Jashtëm rus Sergej Llavrov, u mbrojt me [frazën](#) „një politikë e hapjes ndaj të gjithëve“. Në takimin me Putinin, sipas [kabinetit të Ivanovit](#), është shprehur „kënaqësia e ndërsjellë për trendin e vazhdueshëm pozitiv të marrëdhënieve“.

Në maj të vitit 2015, makineria propagandistike (pro)ruse ishte [posaçërisht e preokupuar](#) me Maqedoninë. Vazhdoi interpretimi i situatës politike në Maqedoni përmes prizmit të „revolucionit me ngjyra” dhe „skenarëve ukrainas”. Në të njëjtën kohë u përhapën edhe paralele demonizuese me Ukrainën dhe [teori konspirative gjeostrategjike](#) të zymta që thirrreshin në „[Shqipërinë e madhe](#)”. Prandaj, nuk është aspak për t’u habitur që ministrit rus Llavrov gjatë vizitës së tij në Beograd më 15 maj të vitit 2015 [iu parashtrua një pyetje eksplicite](#) për atë nëse kishte një paralele mes situatës në Ukrainë dhe asaj në Maqedoni. Llavrov përcolli mesazhin se ngjarjet në Maqedoni dhe politikat pro-ruse kanë një lidhshmëri,

gjegjesisht kanë të bëjnë me refuzimin e Maqedonisë për të vendosur sanksione ndaj Rusisë dhe planet për ndërtimin e gazsjellësit „Rrjedha Turke”. Një ditë pasi Llavrov e „verifikoi” teorinë konspirative për „Rrjedhën Turke”, e komunikuar paraprakisht në kanalet propagandistike ruse, [MPJ e federatës ruse](#) iu përgjigj pozitivisht një pyetjeje të drejtpërdrejtë të shmangur nga Llavrov, duke theksuar se vendi [ishte shtyrë drejt humnerës](#) së një „revolucionit me ngjyra”.

## Historitë për „Revolucionin me ngjyra” dhe „Kontra-revolucioni me ngjyra” në maj të vitit 2015

Duke pasur parasysh historinë e madhe propagandistike nga Moska për tentativën për një „revolucion me ngjyra” në Maqedoni, atëkohë mediat pro-qeveritare në Maqedoni u përpoqën ta [diskreditojnë protestën e madhe të paralajmëruar](#) nga opozita më 17 maj të vitit 2015 si „skenar ukrainas”. Në një [kolumnë](#) me titull „Skenari ukrainas” parashikohet madje edhe një kërkesë për ndihmë ushtarake nga „komandantët e Donbasit Motorola ose Prizrak” të cilët do të dislokoreshin në Pollog.

Një pjesë e mediave pro-qeveritare publikuan [paralajmërimet dramatike](#) sipas të cilave për më 17 maj ishte bërë një „plan i përgjakshëm dhe i tmerrshëm për dhunë” dhe [parashikime propagandistike](#) për një „skenar ukrainas”, gjegjesisht për [protesta të dhunshme](#) „sipas shembullit të Ukrainës”.

Edhe përkundër parashikimeve të zymta mediatike, më 17 maj të vitit 2015 u zhvillua një protestë masive paqësore e opozitës, me kërkesa legjitime demokratike nga ana e opozitës. Pasi nuk u realizuan paralajmërimet propagandistike për një „skenar ukrainas” djallëzor, kanalet propagandistike ruse përhapën [teorinë](#) se dhuna e 17 majit megjithatë u parandalua.

Gjatë kësaj periudhe, shihet se propaganda ruse përdor dezinformata flagrante në përpjekje për ta diskredituar liderin e opozitës Zoran Zaev, duke i ngarkuar atij deklarata që përmbajnë kërcënime për luftë. Propaganda ruse u përpoq të shpërndante [dezinformatat](#) se lideri i atëhershëm i LSDM-së, Zaev, në fjalimin e tij në protestën masive më 17 maj të vitit 2015, ka thënë se nëse Gruevski nuk largohet, „Maqedonia ka për të parë luftë, si në Ukrainë”. Një deklaratë të tillë Zaev nuk e ka bërë në tubimin protestues të „Qytetarëve të Maqedonisë”, e as mediat maqedonase nuk kanë raportuar se në fjalimin e Zaevit ka pasur kërcënime për luftë „si në Ukrainë”.





*Twit i ambasadorit rus në Mbretërinë e Bashkuar Aleksander Jakovenko me një foto të ngjarjeve të Kumanovës dhe me tekst „Situata në Maqedoni është alarmante. Përpjekje të qarta për të shtyrë vendin drejt humnerës së një „revolucionit me ngjyra“.*

Një ditë pas protestës masive të opozitës para qeverisë, pati edhe një [protestë masive qeveritare](#) para kuvendit ku opozita u akuzua se „po interpreton akte të dramës ukrainase“ dhe lideri i opozitës u krahasua me një „Kliçko ukrainas“. Fillimisht „Sputnik“ [publikoi](#) informacion se në protestën pro-qeveritare kishte 30 mijë persona, që vetëm një ditë më pas protesta pro-qeveritare [të shpallet](#) „më e madhja në historinë e vendit“, në të cilën kishin marrë pjesë 90 mijë njerëz.

Më 19 maj të vitit 2015, makineria propagandistike ruse dërgoi [mesazh](#) se „*Tentativa për grusht shteti nga Perëndimi nuk do të ketë sukses në Maqedoni*“. Në „Pravda“-n ruse, Perëndimi u akuzua se „*në Maqedoni kishte vepruar sipas skenarit të Maidanit në Kiev*“ dhe [u hodh](#) ideja se Rusia duhet të ndërtojë një koalicion të fortë sllav në Evropë për ta mposhtur Perëndimin.

Në fund të majit të vitit 2015, kur priti ambasadorin e ri maqedonas në Rusi, Putin [ofroi mbështetjen e tij](#) për autoritetet maqedonase për normalizimin e situatës, duke theksuar se Rusia dhe Maqedonia kanë „*rrënjë të thella historike, afërsi kulturore dhe shpirtërore*“.

Edhe pas protestave të mëdha opozitare dhe pro-qeveritare, propaganda ruse nuk heshti. Ministri i Jashtëm rus Llavrov bëri disa [paralele eksplicite](#) mes situatës në Maqedoni dhe Ukrainë, duke ripërsëritur tezën se ngjarjet në Maqedoni janë të [orkestruara](#) nga jashtë, si rezultat i refuzimit të vendosjes së sanksioneve

ndaj Rusisë dhe mbështetjes së „Rrjedhës Turke”. Llavrov [akuzoi](#) për përdorim të jashtëm të „faktorit shqiptar”, dhe përhap konspiracione për federalizimin e mëtejshëm të Maqedonisë dhe ndarjen e vendit ndërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë.

Me formimin e një kampi opozitar përballë godinës së Qeverisë, sërisht u intensifikuan [teoritë e zymta](#) për „skenar ukrainas” dhe luftë civile. Opozita u [diskredituan dhe u njolloshën](#) dhe nga mediat propagandistike ruse u cilësuan si „kolona e pestë” e cila dëshiron të krijojë një „Maidan të ri, si në Ukrainë”, pra një [„revolucion të ri me ngjyra”](#). Disa propagandistë rusë madje [tentuan](#) ta quajnë atë një „revolucion i dështuar i buzëkuqëve”.



*Kampi protestues para godinës së Qeverisë në Shkup, 18.05.2015.*

*Foto: Vanço Xhambaski CC BY-NC-SA.*

Përkundër denigrimit dhe nënvlerësimit të numrit të pjesëmarrësve në „revolucionin me ngjyrë”, Sputnik [favorizonte](#) „kontra-revolucionin me ngjyra” – si një rezistencë kundër ndërhyrjes së huaj dhe si mbështetje popullore të udhëheqësisë të zgjedhur në mënyrë demokratike që kundërshtoi sanksionet ndaj Rusisë dhe që dërgoi liderin e saj në krenimin e 9 majit të vitit 2015 në Moskë. Në kanalet propagandistike ruse, Maqedonia [u trajtua](#) si një shembull i ri i kundërshtimit të suksesshëm të „revolucioneve me ngjyra”, me të ashtuquajturat „Demonstrata





masive anti-Maidan”. „Rezistenca maqedonase” mori urime nga propagandistët rusë për përballjen me sukses të tentativës për „revolucion me ngjyra”.

Kuptohet që propaganda ruse në mënyrë aktive ndihmoi të ashtuquajturin „kontra-revolucion me ngjyra”, duke u munduar të diskreditojë kampin opozitar përballë qeverisë, i cili organizonte debate qytetare dhe kërkonte zgjidhje për një dalje paqësore nga kriza. Për shembull, prezantuesi dhe propagandisti i famshëm rus Dmitrij Kiselev më 24 maj të vitit 2015 paralajmëroi [një kronikë propagandistike](#) për kampin opozitar si „Maidan në Maqedoni”, i cili vazhdon të zhvillohet sipas „skenarit klasik ukrainas”. Edhe pse kronika propagandistike përmban edhe një deklaratë të liderit të opozitës Zaev, i cili përcjell mesazhe të qarta kundër përdorimit të dhunës, i gjithë artikulli është një përpjekje për të tërhequr një paralele diskredituese mes „Maidanit” të dhunshëm në Ukrainë dhe në Maqedoni. Kampistët e opozitës para qeverisë u denigruan si aktivistë neonazistë ose huliganë të trajnuar dhe të paguar nga Soros për të provokuar protesta të dhunshme.

Edhe pas [distancimit të qartë të Zaevit](#) nga „skenarët ukrainas”, zyrtarët rusë vazhduan me teoritë konspirative për një „revolucion me ngjyra”. Për shembull, zëvendësministri rus i Mbrojtjes Antonov në një konferencë ndërkombëtare theksoi se vala e revolucioneve me „ngjyra” e iniciuar nga jashtë ka arritur edhe deri në Maqedoni, [duke e krahasuar](#) „epideminë e „revolucioneve me ngjyra” në Lindjen e Mesme” me një uragan shkatërrues.

## „Revolucioni me ngjyra” dhe „skenari ukrainas” në kontekst të „Marrëveshjes së Përzhinës”

Kriza politike në Maqedoni në vitin 2015 u tejkalua përkohësisht me „Marrëveshjen e Përzhinës” (2 qershor dhe 15 korrik të vitit 2015) – një kornizë politike e bazuar në parimet demokratike evropiane, e cila [parashihte](#) zgjedhje të parakohshme parlamentare në vitin 2016, kthimin e opozitës në parlament, dy ministra qeveritarë nga radhët e opozitës dhe një prokuror të ri publik special.

Megjithatë, edhe kur ishte e qartë se do të arrihej një marrëveshje politike, propaganda ruse [vazhdoi](#) me teoritë konspirative për një „skenar ukrainas” të dhunshëm të nxitur nga jashtë. Sputnik Serbia akuzoi në [mënyrë eksplicite](#) amerikanët dhe britanikët për organizimin e sulmeve në Kumanovë.

Në të njëjtën kohë, në kanalet propagandistike pro-ruse [u aktuelizua ideja](#) për „Shqipërinë e Madhe”. Për propagandistët pro-rusë, kriza politike në Maqedoni e shfrytëzuar përmes prizmit të „skenarit ukrainas” ishte një rast i mrekullueshëm për [targetimin](#) e politikave amerikane dhe përfaqësuesve zyrtarëve të tyre në Ballkan.

Edhe kur në verën e vitit 2015 nuk u realizuan profecitë e mediave pro-ruse për një „skenar ukrainas” djallëzor në Maqedoni, propagandistët rusë vazhduan ta targetojnë liderin e opozitës Zaev si „Poroshenko ose Jacenuk”. Edhe pas nënshkrimit të „Marrëveshjes së Përzhinës”, kanalet propagandistike ruse vazhduan të propozojnë [zgjidhje pro-ruse të krizës politike](#) – bashkim të kundërshtarëve të politikave të BE-së në Maqedoni me një aleat si Rusia dhe vendet e tjera të BRICS.

## **Përfundim: Propaganda me ngjyra e Moskës për „revolucionin me ngjyra”**

Kriza politike në Maqedoni në vitin 2015 u përdor si terren pjellor për „[komunikime strategjike](#)” ruse. Shprehjet sensacionale „Skenari ukrainas”, „revolucionin me ngjyra” dhe „Maidani maqedonas” ishin pjesë e një fushate propagandistike të mirëorganizuar në vitin 2015.

Fushata propagandistike ishte e njëanshme dhe „e ngjyrosur”, me synimin e dukshëm për ta denigruar dhe delegitimizuar opozitën properëndimore, dhe legjitimizimin e pushtetit të akuzuar për korrupsion, mashtrim zgjedhor dhe abuzim të institucioneve për qëllime partiake dhe private.

Duke mbjellë frikë për një „skenar ukrainas”, një „revolucion me ngjyra” dhe një „Maidan maqedonas”, propaganda ruse ka shfrytëzuar me sukses krizën politike maqedonase që në fillim – jo vetëm për të targetuar Perëndimin, NATO-n dhe BE-në si faktorë destabilizues, por edhe për ta rritur ndikimin e saj politik në Maqedoni dhe në Ballkan. Fushata propagandistike ruse në Maqedoni vazhdoi edhe me thellimin e krizës politike në vitin 2016 dhe 2017, siç edhe do të shohim në pjesën e dytë të analizës.







# PROPAGANDA RUSE PËR „SKENARIN UKRAINAS” NË MAQEDONI (2016 – 2017)

Gjatë viteve 2016 dhe 2017 propagandistët maqedonas dhe rusë në mënyrë harmonike promovonin teori konspirative për „skenarin ukrainas” me qëllim që ta sabotojnë zgjidhjen e krizës politike, punën e PSP-së, Revolucionin e larmë paqësor dhe Marrëveshjen e Përzhinës, si dhe që t’i justifikojnë përpjekjet për mbajtjen e dhunshme të pushtetit pas zgjedhjeve të vitit 2016

Shkruan: Zharko Trajanovski, analist mediatik

(Vertetmates, 23.02.2022)

Në pjesën e parë të analizës mbi propagandën rusë gjatë krizës politike në Maqedoni (2015-2017) theksuam se termet „skenari ukrainas”, „revolucionin me ngjyra” dhe „Meidani maqedonas” ishin pjesë e mesazheve kryesore të propagandës së një strategjie komunikative, e cila realizohej në më shumë kanale propaganduese në vitin 2015.

Mbjellja e frikës për „skenarin ukrainas” vazhdoi edhe në vitin 2016, sidomos pas thellimit të krizës politike më 12 prill të vitit 2016, kur Kryetari Gjorge Ivanov solli vendim për falje të 56 personave, i cili shkaktoi protesta qytetare në gjithë Maqedoninë. Me fjalimin spinues të Ivanovit, në të cilin ishin të theksuara shprehjet „*kjo është një lojë e huaj*”, „*ky është ndonjë interes i huaj*”, maskohej interesi personal dhe partiak i vendimit për ndërprerjen e procedurave të Prokurorisë Speciale Publike, e cila theksonte se „regjistrimet ishin bërë në Maqedoni, me pajisjet e DSK-së pranë MPB-së, të cilat me qëllim që të mos zbulohen gjurmët më pas janë asgjësuar”.





## Moska: Aktivizimi i „skenarit ukrainas”

Menjëherë pas protestave që vijuan si reaksion i faljes kolektive të politikanëve të dyshuar për korrupsion, përgjim të paautorizuar dhe mashtrime zgjedhore, [u prononcua edhe Moska](#) duke paralajmëruar për „[skenar ukrainas](#)” për grusht shteti nga jashtë:

**Aktivizimi i „skenarit ukrainas”, inspirim i jashtëm i veprimeve të paligjshme të grushteve të shtetit mund të shkaktojë tronditje serioze në Maqedoni, si dhe destabilizim të të gjithë rajonit Ballkanik. (MPJ e Rusisë me koment për ndodhitë e fundit në Maqedoni, [RUSKA REÇ NË GJUHËN MAQEDONASE, 14 PRILL 2016](#)).**

Pushteti në Maqedoni ishte në mënyrë eksplicite në një linjë me Moskën, duke konspiruar se „shërbime të huaja të mëdha qëndrojnë pas ‘skenarit ukrainas’ në Maqedoni” ([Moska kundër Brukselit dhe Uashingtonit në krizën e Maqedonisë](#), 15.4.2016). Duke shkaktuar një ndjenjë cenimi në Maqedoni nga ndikime të huaja, Ivanov [e sulmoi](#) ashpër PSP-në, pa dhënë një përgjigje konkrete [se si i ka marrë informacionet](#) për personat e falur, të cilat janë sekrete.

Protestat pas faljes kolektive nga ana e Ivanovit, nëpër kanalet propaganduese ruse, u shfrytëzuan për t’i akuzuar SHBA-të se duan ta destabilizojnë Maqedoninë më një „[luftë të dytë hibride](#)” dhe ta shndërrojnë Shkupin në një „[Kiev Ballkanik](#)” ([THE US WANTS TO TURN SKOPIJE INTO THE BALKAN KIEV](#), 15.4.2016).

Në një intervistë për „Dnevnikun” proqeveritar, ambasadorit rus në Maqedoni **Oleg Shçerbak** iu parashtrua një [pyetje eksplicite](#) për mospranueshmërinë e „skenarit ukrainas” si një nga tezat kyçe të Moskës. Duke folur për Ukrainën, e duke aluduar për Maqedoninë, ambasadori rus përkujtoi se „demokracia e rrugës” për të rrëzuar nga pushteti në mënyrë të dhunshme një qeveri të zgjedhur në mënyrë ligjore ka shkakuar një kolaps të plotë financiar, një luftë qytetare me mijëra viktima, varfëri, korrupsion, ndarje dhe humbje të sovranitetit të Ukrainës, e cila udhëhiqet nga Perëndimi. Shçerbak paralajmëroi se çdo përpjekje për presion të

jashtëm me anë të manipulimit të hapur të shoqërisë qytetare mund të shkaktojë pasoja fatale, si në tragjedinë e përmendur në Ukrainë.

**Gruevski: Derisa jam gjallë nuk do të lejoj skenar ukrainas në Maqedoni**



*Mesazh propagandues në Profilin në Facebook të VMRO-DPMNE-së , 14.04.2016*

Së bashku me „[shqetësimin](#)” e [Moskës](#) dhe Ivanovit, edhe mediat më të ndjekura proqeveritare maqedonase filluan që ta eksploatojnë në mënyrë propaganduese temën „skenar ukrainas” që t’i delegitimojnë protestat opozitare ([Zaev sonte paralajmëroi skenar ukrainas në Maqedoni – Huliganët në rrugë filluan me realizim](#), Sitel, 14.4.2016).

TV „Sitel”, televizioni më i shikuar në mënyrë manipuluese deklaronte se lideri i opozitës **Zoran Zaev** „në përgjigje të pyetjes së gazetarit ‘A është i mundur skenari ukrainas në Maqedoni?’, u përgjigj që është ‘absolutisht e mundur’. Mirëpo, gazetari i „Telma” pyet: „A i vendosi mbrëmë Ivanov themelet për një skenar ukrainas në Maqedoni?”, ndërsa Zaev në një intervistë për „[Top Tema](#)“ në „[Telma](#)“ në 13 prill të vitit 2016 u përgjigj: „Po, mund të thuhet edhe ashtu. Ai ka vendosur themele serioze për skenar ukrainas në Maqedoni”.

Akuzat mediatike për „skenarin ukrainas” ishin një [spin propagandues](#), një shtrembërim i një fjalie të vetme të Zaevit si koment ndaj faljes së Ivanovit, i cili u shfrytëzua për përforsim të narrativit për „skenarin ukrainas”, i cili tashmë ishte eksploatuar gjerësisht nga partia VMRO-DPMNE dhe nga mediat proqeveritare.





Më 14.04.2016 edhe kryeministri **Nikolla Gruevski** në një pres konferencë e akuzoi liderin e opozitës Zaev se ka përmendur „se vendit i kanoset ‘skënar ukrainas’, që sipas Gruevskit, „do të thotë mijëra viktima dhe të lënduar, rënie e hatashme e ekonomisë dhe pasoja të tjera të rënda”. Shumica e mediave e përcollën mesazhin kyç propagandues të Gruevskit që thoshte – „Derisa jam gjallë nuk do të lejoj skënar ukrainas në Maqedoni”.



*Kopertina e të përjavshmes së asaj kohe gazetës proqeveritare „Republika“, „Zaev paralajmëroi skënar ukrainas”.*

Po atë ditë edhe një shoqatë e branitellëve (veteranë luftime nga konflikti i vitit 2001) lëshoi mesazh propagandues se „nuk do ta lejojnë skënarin ukrainas të LSDM-së”, ndërsa sulmi propagandues vazhdoi edhe në ditët në vazhdim duke ia mveshur „skënarin ukrainas” LSDM-së dhe Zaevit. Në një protestë para LSDM-së, të organizuar nga lëvizja proqeveritare LQMM, u dërgua mesazh se nuk do të lejojnë „skënar ukrainas” („Skenar për destabilizimin e Maqedonisë dhe për grushtshteti në shtet”), si dhe kërkesë deri te Gjykata Kushtetuese që përkohësisht ta ndalojë punën e të gjitha shoqatave dhe fondacioneve. Lëvizja proqeveritare LQMM vazhdoi me protesta duke kërkuar zgjedhje në 5 qershor të vitit 2016 që mos lejohet „skënarin ukrainas“ në Maqedoni.

## Protestat paskan qenë të provokuara nga Perëndimi, ndërsa Ivanov e paska penguar „skenarin ukrainas“

Mediat propaganduese ruse u përpoqën që t'i delegjitimojnë [protestat](#) e opozitës pas faljes kolektive të Ivanovit si „[të provokuara nga SHBA-të dhe BE-ja](#)“, dhe si rezultat i refuzimit të Maqedonisë që t'u bashkëngjitet [sanksioneve ndaj Ruisë](#). Faqja „[EU vs Disinfo](#)“ e nxori në pah këtë [dezinformatë](#), me arsyetimin se eruptimi i protestave është rezultat i faljes nga ana e Ivanovit, të 56 personave të lidhur me skandalin e [përgjimeve](#), e se BE-ja ka qenë e involvuar vetëm si mediator ndërmjet palëve.

Propagandistë proqeveritarë filluan ta mbrojnë vendimin e Ivanovit me pretekst se ai ka parandaluar një përpjekje të dytë për grusht shteti dhe skenar ukrainas në Maqedoni, duke u thirrur te propagandistët rusë, të cilët kishin paralajmëruar për „qëllimet e Uashingtonit dhe vartësit të tij Brukselit, që të shkaktojnë luftë të përgjakshme qytetare në Maqedoni sipas shembullit të skenarit ukrainas“ ([Vendimi i Ivanovit e pengoi përpjekjen e dytë për grusht shteti - Grekët bëjnë tifo për marionetën Zaev, 15.4.2016](#)).



*Kopertina e proqeveritares „Republika“ e datës 22 prill 2016.*



Dezinformatat e këtilla propaganduese me “skenarin ukrainas”, shkaktuan reagime jo vetëm të analistëve dhe gazetarëve të vendit, por edhe tek [humoristët](#). Një [kolumnist i njohur](#) e përqeshte hipokrizinë e presidentit dhe të liderit të partisë në pushtet, të cilët „në zgjedhje fitojnë me gojën plotë BE”, dhe „nuk mburren se do t’i arrijnë standardet e Rusisë”, ndërsa tani flasin për „skenar ukrainas”. „Nëse nuk duan ‚skenar ukrainas’, atëherë pse bëjnë kundërprotesta?“, në mënyrë lucide pyeti kolumnisti. Një analist tjetër akuzoi se „Ivanovi qëllimisht e shtyn Maqedoninë drejt skenarit ukrainas”, se faktori destabilizues janë kriminelët e falur nga VMRO-DPMNE-ja dhe Ivanovi, dhe se „janë ato të cilët provokojnë Meidan në mes të Shkupit” ([Përgjegjësia për një skenar të mundshëm ukrainas është e Ivanovit dhe Gruevskit](#), 16.4.2016).

## Harmonia e propaganduesve maqedonas dhe rusë për „skenarin ukrainas”

Përgjigja e pyetjes „[A është duke ecur Maqedonia në hapat e Ukrainës?](#)“, ishte afirmative për [propagandistët](#) maqedonas proqeveritarë, të cilët u përpoqën që ta shfaqin [Revolucionin e larmë jo të dhunshëm](#) si „[një kopje e zbehtë e skenarit ukrainas](#)“ dhe e akuzuan Zaevin se „[i ngriti themelet e Skenarit ukrainas në Maqedoni](#)” ([Alfa](#), 27.5.2016).

Pa treguar prova, propagandistët proqeveritarë deklarorin se „[dita e koktejeve molotov](#)“ dhe [i bagerëve që shkojnë drejt institucioneve nuk është aspak larg](#)” dhe se „[skenat e frikshme nga Ukraina, një nga një, pasqyrohen tek protestat e dhunshme në Shkup](#)” ([Skenari ukrainas në Maqedoni – shfaqje e Zaevit](#), [Kurir](#), 27.5.2016). Pa asnjë bazë, propagandistët proqeveritarë u përpoqën që të shfaqin se demonstrantët në Shkup kanë qenë të „[importuar](#)“ dhe se kanë përdorur armë të njëjta si në Kiev, duke krahasuar një fotografi me hedhje të një „[kokteji molotov](#)“, dhe me hedhje të ngjyrës me „[llastiqe](#)“. (Shikoni analizën “[Nuk ka skenar ukrainas, por ka skenar ballkanik të shkruar nga liderë të korrumpuar](#)”



*Printscreen nga TV „analiza“ e atëherë proqeveritares „Sitel” e 27 Majit të vitit 2016.*

Madje një propagandist insinuoan „skenar ukrainas” (në kontekstin e vrasjes me qëllim të demonstrantëve me plumba në shpinë), që të rriten tensionet, duke poentuar se „rruga nga hedhja e ngjyrës tek shatërvani nën Ushtarin mbi kalë deri te gjakderdhja e vërtetë nëpër rrugët e Shkupit apo të Manastirit është e vogël”. [LSDM i bashkoi mercenarët serb dhe radikalët islamikë](#), Republika, 22.4.2016, fq. 19).

Një propagandiste tjetër dhe një teoriciente e konspiracioneve, zbulonte se [Cilat janë rrjetat që e ngjyrosin Maqedoninë](#) dhe shpërndante [deklarime të pabaza](#) se „përgjimet në Maqedoni janë vepër e shërbimeve britanike”, si dhe „*internacionalizimi i skenarit të Meidanit*” i cili zbatohet me „sulme me armë kundrejt institucioneve”.

Kanalet propaganduese ruse i përforconin teoricientët [konspirativë të vendit](#), kundër „*revolucionit të larmë*” dhe „skenarit ukrainas” të implementuar nga Xhorxh Soros, i cili „*dëshiron ta shkatërrojë Maqedoninë, emrin e saj, gjuhën dhe identitetin*”. Fushata propaganduese Ruse kundrejt Maqedonisë në prill të vitit 2016 filloi kryesisht t’i [shënjestrojë](#) SHBA-të, si faktor për destabilizimin e Ballkanit, dhe si përgjues ilegal në Maqedoni, i cili ka dashur ta shndërrojë Shkupin në një Kiev ballkanik, që t’i sabotojë „projektet multipolare” të Rusisë dhe Kinës në rajon. Përkrah të gjithë këtyre akuzave, SHBA-të u akuzuan edhe se kanë plan për „*internacionalizimin e krizës së Maqedonisë*”.

Nga ana tjetër, propagandistët rusë hapur i lëvdonin strategjitë dhe taktikat e përdorura – [kundërprotestat](#) e LQMM-së, duke deklaruar se „[VMRO-DPMNE-ja](#)





*në mënyrë gjeniale po e menaxhon Revolucionin e larmë“.*

Korniza e këtillë „bardhë e zi“ u vërejt edhe tek artikujt propagandues të mediave proqeveritare, që përpiqeshin ta delegitimojnë revolucionin e larmë si një „*revolucion mercenarësh*“, e pjesëmarrësit e tij si „*mercenarë*“, qëllimi i vetëm i të cilëve është „*skenari ukrainas*“ për rrëmbim të dhunshëm të pushtetit në shtet.

### Harmonia e politikanëve zyrtarë rusë dhe maqedonas për „skenarin ukrainas“

Shfaqja propaganduese se protestat paqësore të Revolucionit të larmë janë pjesë e një skenari të dhunshëm u përforcua edhe personalisht nga ana e kryetarit të shtetit Ivanov, i cili pas protestave masovike së pari e tërhoqi vendimin për faljen e 22 politikanëve më të ekspozuar, e më 6 qershor edhe për të gjithë personat e tjerë të falur. Kryetari Ivanov në një intervistë për proqeveritaren „Dnevnik“ e akuzoi Zaevin se ka paralajmëruar „*skenar ukrainas*“ dhe është kërcënuar me dhunë:

**Nuk jam Unë ai që paralajmëronte skenar ukrainas në Maqedoni. Nuk jam Unë ai që e krahasonte gjendjen në Maqedoni me atë në Siri. Zaevi ishte ai që e bënte këtë, ai kërcënonte se do të vijë deri tek dhuna.**



*Kopertina e proqeveritares „Dnevnik“ nga data 25-26 qershor 2016*



Në periudhën kur mbaheshin negociate politike për tejkalim paqësor të krizës politike me ndërmjetësimin e BE-së, Moska për të disatën herë akuzoi se po përgatitet terren për shkaktimin e një „revolucionin të ngjyrosur” të ri në Maqedoni ([Zaharova: Në përgatitje e sipër është „revolucionin i ngjyrosur” për Maqedoninë](#)).



Me kthimin e sërishëm të narrativit propaganduese për “revolucionin e ngjyrosur”, [Moska në mënyrë të hapur u pozicionua në anën e Gruevskit](#), duke e nënvlerësuar edhe një herë qytetarët e Maqedonisë që me muaj të tërë kërkonin drejtësi nëpër rrugë pas faljes së Ivanovit.

Megjithatë, edhe përkundër lajmërimeve propaganduese për një „skenar ukrainas” të dhunshëm dhe përgatitjeve për një „revolucion me ngjyra” të ri, katër partitë më të mëdha politike [arritën marrëveshje](#) për mbajtjen e zgjedhjeve të qeta në 11 dhjetor të vitit 2016, e cila u [shpall](#) në faqen e Delegacionit të BE-së në Maqedoni.

## „Skenari ukrainas” pas zgjedhjeve të qeta në 11 dhjetor 2016

Përkundër parashikimeve të errëta se përgatitet terren për një „revolucion me ngjyra” të ri, Moska i [vlerësoi zgjedhjet parlamentare të 11 dhjetorit të vitit 2016 si të qeta, bëri me dije se asnjëra nga partitë nuk ka fituar shumicë absolute, dhe bëri apel](#) që të gjitha forcat politike në vend „ta respektojnë vullnetin e votuesve, të veprojnë në kuadër të Kushtetutës, të mos lejojnë që të ushtrohet ndikim kontraproduktiv i jashtëm mbi procesin e formimit të qeverisë së re“.

Mirëpo, pasi u [bë e qartë](#) se Gruevski nuk mund të formojë shumicë të re parlamentare, Moska e ndryshoi pllakën se asnjë nga partitë nuk ka fituar shumicë absolute. Filluan përsëri të flasin për „[ndikim të jashtëm](#)“ dhe „[ndërrhyrje](#)





nga jashtë“ nga ana e Perëndimit, për „përdorimin e metodave destruktive të ,revolucioneve me ngjyra“, dhe pa bazë të deklarojë se në zgjedhje ka fituar partia e Gruevskit – „partia qeverisëse fitoi shumicën e votave, ndërsa opozita edhe përkrah të gjitha manipulimeve dhe mbështetjes së hapur të BE-së dhe SHBA-ve, përjetoi disfatë“.



Drejtëpërdrejt me Moskën, edhe partia qeverisëse e ktheu në lojë „skenarin ukrainas“ pasi „PSP hoqi dorë nga rasti ,PUÇ‘ për shkak të mungesës së provave“. Një tellall i VMRO-DPMNE-së e cilësoi tërheqjen nga lënda „Puç“ si, „një hap i qartë i PSP-së në drejtim të mbrojtjes së kriminelëve që konspironin një luftë qytetare, skenarë ukrainas dhe gjak deri në gjunjë“, dhe lajmëroi se populli po ngrihet kundër ridefinimit të shtetit me „Platformën e Tiranës“. Derisa demonstrantët proqeveritarë protestonin kundër „platformës së Tiranës“, thuajse të gjitha fjalët se „konspirohej një skenar ukrainas, luftë qytetare dhe gjak deri në gjunjë“ – i përdori Gruevski në një intervistë për „Telegrafin“ e Serbisë (NUK DUAM SKENAR UKRAINAS, POR EDHE NUK DO TË FLEJMË KUR ATO E SHKATËRROJNË SHTE-TIN: Intervistë e Gruevskit për „Telegrafin“ Serb!, 10.3.2017). Tellallët e opozitës bënin me dije se „Nuk do të lejohet që Maqedonia të shndërrohet në Ukrainë“ dhe se retorika për Skenar Ukrainas është fjalë boshe.

Retorika e njëjtë e Gruevskit kundër t.a. *skenar ukrainas* (përprojekte e shërbimeve të huaja për të rrëzuar një qeveri të zgjedhur në mënyrë legale) u pranua edhe nga ana e lëvizjes protestuese „Për Maqedoni të përbashkët”, e cila e kundërshtonte „Platformën e Tiranës”, dygjuhësinë, federalizimin dhe përzierjen direkte të huaj në Maqedoni, veçanërisht nga ana e Soros-it.

## 2017: Në vend të „skenarit ukrainas” të opozitës, dhunë nga ana e demonstrantëve proqeveritarë

Që në mars analistët e kishin të qartë se Qëndrimet e MPI-së ruse koincidojnë me qëndrimet e VMRO-DPMNE-së, të cilët Revolucionin e larmë e paraqisnin si „*skenar ukrainas*” për rrëzimin e pushtetit në Maqedoni.



### **Protesta në Shkup – Prill 2016, Revolucionin i larmë Foto: Vanço Xhambaski CC BY-SA**

Mirëpo, në pranverën e vitit 2017 pushteti nuk u mor dhunshëm me asnjë „*skenar ukrainas*”. Dhuna si metodë u përdor nga ana e demonstrantëve proqeveritarë më 27 prill edhe atë për të penguar ndërrimin demokratik të pushtetit nga ana e shumicës së re parlamentare.

Në atë periudhë, propaganduesit rusë nuk reshtën së foluri për „*skenar ukrainas*”. Makina propaganduese ruse e akuzonte NATO-n se dëshiron të shohë „*gjak në rrugët e Maqedonisë*” për shkak të projektit „Shqipëria e Madhe”,





mbillte frikë për [dezintegrim](#) të vendit dhe dërgonte mesazh se ka ardhur koha që Maqedonia „*t'i besojë Rusisë dhe jo Trump-it*“. Duke shpërndarë fotografi nga protestat masovike proqeveritare, „Sputniku“ rus madje pohonte se jo vetëm që [Brukseli u mund në Maqedoni](#), por edhe se e gjithë Evropa Lindore [i kthen sytë nga BE-ja tek Rusia](#).

**Pas dhunës së 27 prillit nga ana e demonstrantëve të mbështetur nga Rusia, Moska e akuzoi opozitën për përpjekje për [marrije të pushtetit me dhunë](#) dhe se ajo ka qenë [e planifikuar paraprakisht](#). Duke bërë krahasime të pabaza me Ukrainën, propaganda ruse shpërndante dezinformata se demonstrantët në parlament kanë qenë ta paarmatosur dhe kanë dashur të pengojnë grusht shteti dhe e akuzonte Uashingtonin dhe Brukselin për [standarde të dyfishta](#). Propaganduesit rusë shpërndanin [dezinformata](#) edhe se shumica e re parlamentare nuk mund të hyjë në Kuvend, si dhe teori konspiracioni se „*shqiptarizimi*“ i Ballkanit ka qenë i mbështetur nga eprorët e BE-së. Duke luajtur në kartën e „[Shqipërisë së Madhe](#)“ dhe „Platformës së Tiranës“, propaganda ruse përsëri tentoi të bëjë [paralele midis Ukrainës dhe Maqedonisë](#). Megjithatë, edhe analistët pro-rusë që e shohin Maqedoninë të integruar në „botën serbe“ („një formë integrimi midis Serbisë, Malit të Zi, Republika Srpska dhe Maqedonisë“) kanë filluar të shohin [dallime fundamentale midis Maqedonisë dhe Ukrainës](#).**

Propagandistët maqedonas edhe pas dhunës së 27 prillit u përpoqën t'i interpretojnë ngjarjet me teori konspirative, duke përdorur sërish shprehjen propagandistike „*skenari ukrainas*“, i cili me gjasë u zbulua dhe u ndalua nga VMRO-DMPNE-ja.

## **Eksplotimi i frikës nga ukrainizimi i Maqedonisë**

Moska zyrtare dhe makina e saj propaganduese maksimalisht e përdorën krizën politike në Maqedoni (2015-2017) që t'i sulmojnë Uashingtonin dhe Brukselin, duke mbjellë frikë për „*skenarin e përgjakshëm ukrainas*“, duke u përpjekur që ta ulin ndikimin e Perëndimit në Maqedoni dhe në Ballkan. Pasi Ivanov ia dha mandatin Zaevit dhe ishte e qartë se shumica e re do të formojë qeveri, propaganduesit rusë vazhduan t'i akuzojnë SHBA-të se nuk e kanë zgjidhur [krizën e Maqedonisë, por e kanë përkeqësuar](#), dhe e kanë sjellë Ballkanin në rrezik. Rusia

maksimalisht e eksploatoi frikën nga [ukrainizimi i Maqedonisë](#) që ta dobësojë Perëndimin dhe t'i forcojë interesat e veta në Maqedoni dhe Ballkan.

Edhe pse Moska zyrtare u vendos në mbrojtje të demonstrantëve të dhunshëm dhe politikanëve të korruptuar që e shkelnin Kushtetutën dhe i pengonin procedurat demokratike për ndërrimin e pushtetit, më 24 maj të vitit 2017 [Putini i dëshiroi Ivanovit](#) zhvillim të situatës së brendshme politike konform Kushtetutës dhe procedurave demokratike.



*Putini ia uroi shpërblimin e marrë Ivanovit në takimim më 24 maj të vitit 2017 Foto: Zyra e Presidentit të Rusisë (kremlin.ru), Creative Commons Attribution 4.0 International*

Në ditën e shkrimit sllav, [Putini ia uroi Ivanovit](#) edhe shpërblimin për [forcimin e marrëdhënieve midis ortodoksëve](#), të dhënë nga ana e Fondacionit ndërkombëtar shoqëror për unitet të popujve ortodoksë, që iu dorëzua personalisht nga [patriarku rus](#).





# PROPAGANDA RUSE NË MAQEDONI NË VITIN 2018: “MAQEDONIA E BASHKUAR” SI “PION” I “RUSISË SË BASHKUAR”

Dëbimi i fundit i pesë diplomatëve rusë nuk është dëbimi i parë i diplomatëve rusë nga Maqedonia. Për herë të parë, Maqedonia dëboi një diplomat rus në vitin 2018, kur u vërejt jo vetëm intensifikimi i ndikimit të propagandës ruse, por edhe një përpjekje për ndikim politik rus, përmes mbështetjes së klonit maqedonas të “Rusisë së Bashkuar”.

Shkruan: Zharko Trajanoski, analist mediatik

(Vertetmates, 05.04.2022)

## **Ndikimi rus në Maqedoni nuk është vetëm përmes “sallatës ruse”**

Edhe para fillimit të vitit 2018, Ambasada e Rusisë në Maqedoni tentoi të bënte shaka me “rritjen e ndikimit rus” duke publikuar një foto të “sallatës ruse”, e cila konsumohet më së shumti gjatë festave të Vitit të Ri. Por, sa i përket “ndikimit rus” dhe “skenarit ukrainas”, djalli e kishte marrë prej kohësh shakanë (shih [analizën 1](#) dhe [2](#)). Si në vitet e kaluar, në dhjetor 2017, propagandistët rusë publikuan parashikime të zymta për zhdukjen e Maqedonisë nga harta botërore dhe për ndarjen e Maqedonisë në mes Shqipërisë dhe Bullgarisë ([Shikoni ANALIZËN E ANDREJ KORIBKO: A do të zhduket Maqedonia nga harta botërore në 2018?](#)). Zëdhënësit vendas rusë, kanë [përhapur](#) parashikime apokaliptike se “Maqedonia është zgjedhur si vendi ku do të fillojë lufta e ardhshme, pra konflikti botëror mes NATO-s dhe Rusisë”.





целата територија на #Македонија и пошироко.  
#РускаСалата



Një muaj pas parashikimit të një “force të tretë” avangarde në Maqedoni, e cila do të luftonte për mbrojtjen e saj nga shkatërrimi, një kandidat i tillë doli në skenën politike. Ishte partia “Maqedonia e Bashkuar”, e cila mbrojti hapur një aleancë me Rusinë dhe bëri fushatë të zezë kundër NATO-s dhe BE-së.

### “Maqedonia e Bashkuar” kundër “fashizmit” të NATO-s dhe BE-së

Menjëherë pas riemërtime, përfaqësuesit e “Maqedonia e Bashkuar” i [shpallën](#) institucionet e NATO-s dhe BE-së si fashiste. Lideri i partisë me identitet të ri pro-rus e cilësoi NATO-n jo vetëm si “fashiste”, por edhe si “[organizatë gjenocidale](#) për maqedonasit me përpjekje për të ndryshuar emrin dhe identitetin tonë shekullor.” Në janar 2018 “Maqedonia e Bashkuar” [propozoi](#) që autostrada për në Greqi të quhet gjenocid në vend të miqësisë dhe [kërkoj](#) nga qeveria që të tërheqë kërkesën për anëtarësim në BE, në përputhje me qëllimin e saj strategjik për anëtarësim në Bashkimin Ekonomik Euroaziatik dhe partneritet strategjik me Rusinë. Po ashtu, “Maqedonia e Bashkuar” [njoftoi](#) se ka filluar procedura në Kuvend kundër anëtarësimit të Maqedonisë në NATO, me të cilën sigurohet “mbijetesa e Maqedonisë dhe maqedonasve”.

Përderisa mediat [përhapën zëra](#) se [maqedonasit preferojnë presidentin rus si lider të tyre](#), [ambasadori rus](#) Shçerbak pohoi se [Rusia as nuk ka ndërhyrë dhe as nuk ndërhyr në punët e brendshme të Maqedonisë](#). Ndërsa Lavrov [paralajmëroi](#) se zgjerimi i NATO-s me Maqedoninë ishte gabim, lideri i “Maqedonisë së Bashkuar” po përpiqej të [mobilizojë](#) politikisht me mesazhe dezinformuese [antishqiptare](#) dhe me [mesazhe](#) kundër “*kërkesës fashiste për ndryshimin e emrit dhe identitetit për anëtarësim në Union*”.

Baçev publikoi edhe dy letra të hapura. Letra e parë i drejtohej [kryetarit](#)



të KE-së, në të cilën ai dërgoi mesazh se Maqedonia “nuk e sheh të ardhmen e saj në BE dhe NATO dhe nuk i ndan vlerat tuaja liberale në kundërshtim me ligjet natyrore...”. Letra e dytë i drejtohej Putinit, në të cilën Baçev e uroi për [fitoren](#), duke e falënderuar për mbështetjen e Rusisë dhe duke shprehur besimin se në mandatin e tij “Republika e Maqedonisë do të fitojë një aleancë strategjike historike me Rusinë dhe anëtarësimin në Bashkimin Ekonomik Euroaziatik”.

### Ofensiva propagandistike e Rusisë kundër NATO-s dhe BE-së

Në shkurt dhe mars të vitit 2018 tashmë ishte e dukshme që propaganda pro-ruse në Maqedoni ishte në “ofensivë” politike. Për shembull, në emisionin e atëhershëm më të ndjekur “Vetëm e vërteta” më [20 shkurt](#) 2018, dy propagandistë pro-rus “debatuan” me temën “*A ka Maqedonia alternativë përveç BE-së dhe NATO-s?*”. Të ftuarit ishin të vetmit që bënë fushatë negative kundër BE-së dhe NATO-s, për të denigruar qeverinë pro-perëndimore dhe për të tallur përkrahësit e anëtarësimit në NATO dhe BE. Në të njëjtin emision përfaqësuesi i “Maqedonia e Bashkuar” dërgoi mesazhe të qarta antishqiptare se shqiptarët “do të kenë dy mundësi – ose të fillojnë të mësojnë rusisht ose të mësojnë notin dhe këtë e them shumë seriozisht”. I ftuar në të njëjtin emision debatues në fillim të marsit 2018 ishte edhe lideri i “Maqedonia e Bashkuar” Baçev, i cili [deklaroi](#) se “*aleanca strategjike me Rusinë siguron mbijetesën dhe të ardhmen e Maqedonisë*”. E ftuar në “Vetëm e vërteta” në [mars](#) ishte kolumnistja, profesoresha **Biljana Vankovska**, si nënshkruesja e parë e proklamates [manipuluese](#) të intelektualëve që kërkuan ndërprerjen e negociatave për emrin. Vankovska, autore e kolumnës “[Çmim Nobel për Putinin: E, pse jo?](#)” (në “Ruska reç”), më parë ka promovuar sloganin “[JO NATO-s, qoftë edhe nën emnin kushtetues!](#)”.

Me gjithë tentativat për të frikësuar me “[shqiptarizim brutal](#)”, “Maqedonia e Bashkuar” vazhdimisht luante në kartën “antifashiste”, duke e paraqitur “Perëndimin” si fashist. Kështu, në [seancën](#) propagandistike në të cilën folës nderi ishte propagandisti dhe gjeopolitiku rus Aleksandër Dugin, zëdhënësi i “Maqedonia e Bashkuar”, **Vllahov Micov**, edhe përhapte dezinformata për numrin e shqiptarëve në Maqedoni (“13.6% pakicë”), edhe





njolloste Perëndimin si fashist, qëllimi i të cilit është ta shkatërrojë botën sllave: “Për momentin, SHBA, NATO dhe BE formojnë Rajhun e katërt fashist, paraardhësi i të cilit është hitleriani i tretë... qëllimi i këtyre hitlerianëve të rinj është shkatërrimi i plotë i botës sllave të udhëhequr nga Rusia ...”.

“Maqedonia e bashkuar” dhe Dugin i [ofruan](#) publikut maqedonas jo vetëm propagandë negative ndaj Perëndimit dhe liberalizmit, por edhe njëalternativë politike në Bashkimin Euroaziatik dhe “vëllazërinë sllave” (shih më shumë: [Propagandisti Dugin, satanizimi i Perëndimit dhe apologjia e imperializmit rus](#)).



***Selia e partisë “Maqedonia e Bashkuar” në sheshin kryesor në Prilep, 31.03.2022. Foto: Vërtetmatësi..***

Ofensiva propagandistike vazhdoi pas fitores së Putinit në zgjedhje, kur **Mirka Velinovska** në kolumnën e saj [“Rusia ndryshon botën”](#) denigroi “nomenklaturën politiko-elitare perëndimore euro-atlantike” si një “fis vulgar, vandal” dhe “një koleksion i të egërve me qendër në Bruksel”. Velinovska e përshkroi kryeministrin maqedonas si “shembullin më vulgar, por edhe një dëshmi të gjallë të paradigmës së vlerave të Perëndimit të paqytetëruar të vandalizuar” dhe [akuzoi](#) “broilerët euroatlantike” për aleancë “me komplotin militant fashist euro-amerikan kundër Rusisë”.

Zëdhënësit zyrtarë të Rusisë nuk i kanë kursyer shpifjet ndaj NATO-s. Pas mesazhit të Lavrov se [“zgjerimi i NATO-s me Maqedoninë është gabim”](#), pasi [deklarata](#) e Ministrisë së Jashtme ruse se “planet për ta futur Republikën

e Maqedonisë në NATO mund të kenë pasoja negative për sigurinë rajonale dhe marrëdhëniet dypalëshe”. Në përndjekjen kundër NATO-s u përfshi edhe ambasadori rus Shçerbak me [mesazhin](#) se “NATO nuk është shkollë për paqeruajtësit, por bllok ushtarak-politik agresiv fajtor për shumë ndërhyrje ushtarake”.

Pasi Maqedonia dëboi një diplomat rus më 26 mars 2018 për shkak të “rastit Skripal” dhe kalimin e vijave të kuqe, Moska reagoi ashpër, duke paralajmëruar se “përgjegjësia për pasojat e kësaj lëvizjeje do të bartet plotësisht nga pala maqedonase”.

Ambasadori rus fillimisht në një [kolumnë](#) konstatoi se “Maqedonia ishte pjesë e vendeve që i dorëzohen kësaj psikoze anglo-saksone dhe në dëm të interesave të vendit të tyre marrin vendime të nxituara që ndërlikojnë marrëdhëniet me Rusinë”. Më pas, në një konferencë për media, Shçerbak lëshoi një [paralajmërim kërcënues](#) se “Maqedonia do të jetë objektivi legjitim i Rusisë në rast konflikti me NATO-n”, për të cilën kryeministri Zaev [komentoi](#) se Maqedonia nuk dëshiron grindje me Moskën.

Partia “Maqedonia e Bashkuar” dënoi dëbimin e diplomatit rus dhe [thirri](#) një [tubim](#) para ambasadës ruse, në të cilin i [thanë](#) ambasadorit rus se populli maqedonas dëshiron të jetë pjesë e Bashkimit Euroaziatik dhe se [në BE duan](#) vetëm “*maqedonasit e korruptuar, që paguhen me para të huaja*”.



**Selia e partisë “Maqedonia e Bashkuar” në Shkup, 01.04.2022.**

**Foto: Vërtetmatësi..**





## Propaganda ruse para Marrëveshjes së Prespës: Përpjekje për të përdorur kontestin e emrit

Pak para lansimit të versionit maqedonas të “Rusisë së Bashkuar”, deklarata e ministrit të Punëve të Jashtme rus **Sergej Lavrov** më 15 janar 2018, lidhur me zgjidhjen e mundshme të “kontestit për emrin” shkaktoi valë të vërteta mediatike. Pasi disa media raportuan se Rusia do të pranojë çdo ndryshim emri ([Lavrov: Do të pranojmë emrin që do të bihet dakord mes Athinës dhe Shkupit](#) / [Lavrov: Do të pranojmë çdo emër të ri të Maqedonisë](#) / [“Rusia në anën e Greqisë, kërkon që Maqedonia të ndryshojë emri”](#)), ambasada ruse paralajmëroi në një postim në [Twitter](#) se mediat maqedonase [manipuluan](#), përkatësisht përhapën një interpretim të rremë të fjalëve të Lavrov (u publikua edhe një [transkriptim](#) i deklaratës së Lavrov). Megjithatë, disa nga mediat e interesuara [theksuan me të drejtë](#) se ajo që u raportua nga Lavrov në mediat maqedonase, ishte në fakt një citim nga faqja ruse [“RussiaToday”](#), ku gjatë konferencës për shtyp të Lavrov u publikua lajmi i shkurtër në vijim: *“On the naming row between Greece and Macedonia, Lavrov says Russia would abide by any decision made in the Macedonian constitution, should that happen”*(RT). Më vonë, edhevambasadori rus Shçerbak, në promovimin e ekspozitës “Moska sot” (28.02.2018), theksoi se [“Greqia dhe Maqedonia kanë të drejtën e një zgjidhjeje që i përshtatet të dyja palëve”](#).

Megjithatë, pas deklaratave kundërthënëse të Lavrov dhe [interpretimeve](#) politike për shfaqjen e një “force të tretë”, partia marginale “Lëvizja Popullore për Maqedoninë” vendosi të riemërohet “Maqedonia e Bashkuar” dhe të kundërshtojë anëtarësimin në NATO dhe BE, për Aleancën me Rusinë dhe anëtarësimin në Bashkimin Euroaziatik. “Maqedonia e Bashkuar” dhe zëdhënësit e tjerë pro-rusë theksuan nevojën e ruajtjes së emrit kushtetues me çdo kusht, gjë që mund të interpretohet si tregues se Rusia ende po përpiqet të përdorë kontestin e emrit për të arritur qëllimet e saj strategjike në Maqedoni dhe në Ballkan. Në atë drejtim u interpretua edhe mbështetja e [Savinut](#) dhe [Duginut për ruajtjen e emrit](#), vizitë që disa analistë e interpretuan si [“akt hibrid”](#).

Pas dëbimit të diplomatit rus në mars, ambasada ruse reagoi në [Twitter](#) në përgjigje të një deklarate të nënpresidentit të VMRO-DPMNE-së, Aleksandar

Nikolovski se “Maqedonia duhet të jetë anëtare e BE-së dhe NATO-s” dhe se “Partneri ynë nuk është Moska, partnerë tanë janë Brukseli, Londra dhe Uashingtoni”:

**Sipas Aleksandar Nikolovskit, Moska nuk ishte partnere e VMRO-DPMNE-së. Qëndrim i shquar.**

Ambasadori rus [Shçerbak](#) gjithashtu e interpretoi deklaratën si reflektim të “politikës jokonsistente të një pjese të udhëheqjes së VMRO-DPMNE”, e cila “çoi në humbjen e pushtetit të VMRO-DPMNE”. Në kundërshtim me deklaratën “partneri ynë nuk është Moska”, Shçerbak tregoi se ai njeh shumë nga anëtarët e partisë së Nikolovskit, të cilët ishin “të disponuar për të zhvilluar marrëdhënie konstruktive dhe partneriteti me Rusinë”.

Për shkak të deklaratës “partneri ynë nuk është Moska”, VMRO-DPMNE dhe lideri i saj u vunë në [shënjestër të shpifjeve](#) nga propagandistët rusë në Maqedoni, të cilët paralajmëruan “[shpërbërjen e VMRO-DPMNE-së](#)”. Kloni maqedonas i “Rusisë së Bashkuar” synoi gjithashtu “[banditë nga VMRO-DPMNE dhe LSDM](#)”, duke bërë [thirrje](#) për zgjedhje të parakohshme që njerëzit të vendosin “nëse janë për NATO-n dhe BE-në apo për Rusinë dhe BEE-në”.

Ndërsa ambasadori rus sugjeroi statusin e [neutralitetit ushtarak](#) dhe shfaqti shqetësim për maqedonasit me mesazhin “Nuk duam që NATO t’i përdorë maqedonasit si mish topash”, lideri i “Maqedonia e Bashkuar” dërgoi [mesazhe](#) antishqiptare. Baçev kërkoi [revokimin](#) e njohjes së Kosovës, duke i [kërkuar](#) ministrin të jashtëm që “të fillojë të mësojë rusisht me bashkatdhetarët e tij shqiptarë dhe që shqiptarët radikalë të mësojnë të notojnë”.

Ndryshe nga pretendimet e ambasadorit rus ([Shçerbak: Gënjeshtër propagandistike janë pretendimet se Rusia po ndërhyr në kontestin e emrit](#)), lideri i klonit maqedonas të “Rusia e Bashkuar” u përpoq të shfrytëzojë sa më shumë mosmarrëveshjen për emrin për promovimin e tij dhe mobilizimi partiak. Madje Baçev tentoi t’i dërgonte një [letër](#) Ambasadës greke për Tsipras me një mesazh se “populli maqedonas dhe shumica e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë nuk qëndrojnë prapa asnjë marrëveshjeje ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë për ndryshimin e emrit dhe identitetit





*maqedonas*". Gjithashtu në letër Baçev theksoi se “në të ardhmen tonë nuk e shohim në BE dhe NATO, por në një aleancë strategjike me Rusinë dhe anëtarësim në Bashkimin Ekonomik Euroaziatik”. “Maqedonia e Bashkuar” po përpriqej të promovohet si partia e vetme kundër ndryshimit të emrit, gjë që u duk qartë nga video e postuar në faqen e tyre në Facebook me titull: **“Mickovski dhe Zaev janë për ndryshimin e emrit”**.

Në të njëjtin muaj kur ambasadori rus në një **kolumnë** pohoi se Rusia po akuzohej pa prova për “përpjekje të pretenduara për të destabilizuar Maqedoninë” dhe se po bënte gjithçka “për të penguar integritetin e vendit në NATO”, kreu i “Maqedonia e Bashkuar” u mburr se jo vetëm që ishte në një vizitë partiake në Rusi, por edhe se si parti e **kaluan me sukses stërvitjen ruse**. Duke folur për **Star TV**, Baçev tha se ka pasur takime në Dumën Shtetërore të Rusisë, me drejtuesit e lëvizjes euroaziatike Dugin dhe Savin, por edhe me përfaqësues të “partisë sonë të ngushtë Rusia e Bashkuar”.

Falë “stërvitjes ruse” nga ndihmësi i Dugin, Baçev pohoi se do të mposhtin “*politikën katastrofike të partisë ‘Varrosje për Maqedoninë’*” e përbërë nga LSDM dhe VMRO-DPMNE” dhe se ata ishin të gatshëm të marrin pushtetin dhe të sqarohen me të gjithë “**tradhtarët e kombit**”. Edhe “trajtnesi” Leonid Savin nga Rusia konfirmoi në mënyrë profetike se “qeveria e re që do të jetë e Maqedonisë e Bashkuar duhet të ruajë unitetin e vendit”.



***Komiteti komunal i partisë “Maqedonia e Bashkuar” në Tetovë,  
31.05.2022. Foto: Vërtetmatësi.***

## Propaganda ruse pas Marrëveshjes së Prespës: Përpjekje për destabilizim

Në qershor 2018, Baçevi i “trajnuar” filloi të diskreditojë negociatat me Greqinë si “festë private e Zaevit dhe Tsipras për një marrëveshje për ndryshimin e emrit” dhe [parashikoi](#) se “[as ndryshimi i emrit nuk do të bëhet dhe as Maqedonia nuk do të bëhet anëtare e NATO-s](#)”.

Pasi u bë e qartë më 12 qershor 2018 se do të nënshkruhet marrëveshje me Greqinë, tifogrupi “Komitët” të klubit sportiv “Vardar” në pronësi të **Sergei Samonenkos** – Konsull Nderi i Federatës Ruse, [bëri thirrje](#) për protestë masive dhe dërgoi mesazh kërcënues për të gjithë të përfshirët në ndryshimin e “emrit tonë shekullor”: “Do të vijmë pas jush dhe familjes suaj!”, thuhet në postimin e “Komitëve”, të cilët publikuan foto me sloganin “*mallkuar qofshin tradhtarët, që tradhtuan popullin e tyre*”.

“Komitët” në “komunikimin” e tyre politik pretendonin se vendi ishte “*sulmuar ashpër nga agresorët e brendshëm dhe të huaj, të cilët duan ta ndryshojnë atë me dhunë dhe metoda gjenocidale; identitetin, kombin, gjuhën, historinë...*” dhe [bënë thirrje](#) për revolucion.

Në të njëjtën kohë, ministri rus Lavrov shprehu shpresë se “[marrëveshja do të ketë mbështetje të gjerë popullore](#)”, gjegjësisht, se do të mbështetet edhe nga Rusia “[nëse marrëveshja për emrin mbështetet nga qytetarët e të dy vendeve](#)”. Nënkryetari i VMRO-DPMNE-së dhe disa media interpretuan se “[Lavrov e mbështeti marrëveshjen](#)” dhe “[përsëriti riemërtimin në Maqedonia e Veriut](#)”, gjegjësisht se u ndalua mbështetja e Rusisë “vëllazërore” për emrin ([Kaq ishte “mbështetja” e Rusisë “vëllazërore” për emrin – Lavrov në shoqërinë e Kozijas përshëndeti marrëveshjen](#)).

Megjithatë, ambasada ruse në një postim në [Twitter](#) sqaroi se:

**Fatkeqësisht, disa media vazhdojnë të përhapin interpretime tendencioze dhe lajme të rreme për qëndrimet e Rusisë për çështjen e emrit të Republikës së Maqedonisë.**





Një propagandist i shquar rus të nesërmen madje e ka vënë në shënjestër personalisht nënpresidentin e VMRO-DPMNE-së si një “gënjeshhtar dhe spiner”.

Në një [dalje televizive](#), Baçev pohoi se “*Ishte një gënjeshtrë e madhe se Lavrov ra dakord për ndryshimin e emrit*” dhe se “*ai spin u bë nga ato media Soroside në vend*” (edhe pse interpretimi më i qartë se “[Lavrov mbështeti marrëveshjen](#)” ishte nga nënkryetari i VMRO-DPMNE-së). Dhe pastaj Baçev i vendosi LSDM-në dhe VMRO-DPMNE-në në të njëjtin kamp si parti pro NATO-s: “Në njërin anë janë VMRO-DPMNE dhe LSDM, të cilat thonë “NATO dhe BE nuk kanë alternativë, nga ana tjetër ne themi aleancë strategjike me Rusinë”. Në të njëjtin emision televiziv, të drejtuar nga një zëdhënës i njohur pro-rus, i ftuari tjetër, **Aleksandër Stankovski**, promovoi orientimin euroaziatik si ideologji dhe satanizoi Perëndimin dhe liberalizmin, duke [cituat](#) Dugin:

**... atë që Dugin e quan herën e katërt, teoria e katërt ideologjike ose politike. Pra liberalizmi, që zgjat tashmë 200 është gati, nuk jep rezultate, jep degjenerim, jep probleme, krijon luftëra të panevojshme në botë, krijon dominim që është SATANIK.**

Një ditë para nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës, “*Maqedonia e Bashkuar*” e [shpalli](#) atë “*tradhti kombëtare dhe krim të rëndë ndaj popullit maqedonas*”, dhe njoftoi se “qeveria e re ligjore e Maqedonisë së Bashkuar do ta anulojë menjëherë një marrëveshje të tillë”. “Maqedonia e Bashkuar” në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes i ka përkrahur “komitet”, të cilët thirrën protesta masive, duke [kërcënuar sërish](#): “*Ne jemi komitet dhe do t’ju gjejmë, e të tjerat i keni lexuar në librat shkollor të historisë*”. Grupi radikal “Tvrdokorni” [u vu në dispozicion të presidentit Ivanov](#) “në mbrojtje të atdheut tonë”, [i cili më herët e kishte quajtur “të dëmshme”](#) marrëveshjen me Greqinë dhe kishte paralajmëruar se nuk do ta nënshkruante atë.

Në protestën para Kuvendit më 17 qershor 2018, e cila ishte e mbushur me gjuhë urrejtjeje dhe kërcënime eksplicite për dhunë, “komitet” thyen kordonin policor dhe lideri i “Maqedonia e Bashkuar”, Baçev me [flamurin](#)



rus u ngjit mbi një makinë policie. Ministria e Brendshme tha se “disa nga protestuesit përdorën eksploziv dhe shtynë me forcë gardhin mbrojtës, duke u përpjekur të futeshin me forcë në Parlament“, dhe qeveria dërgoi mesazh se “nuk do të lejohet përsëritja e 27 prillit“. Më pas u bë publik informacioni nga kryeministri se rebelët ishin paguar nga biznesmenë grekë dhe se zyrtarët rusë kishin inkurajuar protestat dhe dhunën. Gazetarët investigativë raportuan për marrëdhënie inkriminuese midis biznesmenit rus, partisë “Rusia e Bashkuar”, grupit të tifozëve “Komitet” dhe pronarit të Klubit të Futbollit “Vardar” (konsull nderi i Rusisë).

Pasi lideri i “Maqedonia e Bashkuar” valëviti flamurin rus gjatë protestave të dhunshme para Kuvendit, në mënyrë propagandistike u vu në shënjestër si “kali i Trojës” dhe instalim i LSDM-së, nga media të afërta me VMRO-DPMNE-në. Partia e Baçevit reagoi ashpër kundër “gazetarë jeniçerë dhe mercenarëve, dikur të Gruevskit, tani të Mickoskit”.



*Foto: printscreen video e Radio Evropa e Lirë*

Në fjalimin para Kuvendit më 18 maj 2018, Baçev përçmoi Marrëveshjen e Prespës si një “festë private”, ngjashëm si propagandisti pro-rus **Milenko Nedelkovski**, i cili e quajti atë “festë private të kryeministrave grekë dhe maqedonas“. Baçev më pas siguroi grupet protestuese se “nuk ka marrëveshje ndërkombëtare” dhe se “Maqedonia as nuk do të bëhet anëtare e NATO-s dhe as nuk do të ndryshojë emrin e saj...”.





Mirëpo, realitetin e mohon profesori universitar i së drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Juridik në Universitetin Ndërkombëtar Sllav “Gavrilo Romanoviç Derzhavin”. Në vazhdim të analizës do të shohim se si pikërisht falë Marrëveshjes së Prespës, Maqedonia u bë anëtare e NATO-s pas ndryshimit të emrit kushtetues, përkundër rritjes së ndikimit rus gjatë referendumit dhe procesit të ndryshimeve kushtetuese.



# ASGJË NUK E ARSYETON INVAZIONIN RUS MBI UKRAINË

Një nga mënyrat më vështirë të dallueshme të ndikimit, e cila bëhet mjaft agresive prej momentit të fillimit të invazionit të Putinit mbi Ukrainën, është krahasimi, identifikimi dhe arsyetimi i asaj lufte.

Shkruan: Prof. D-r. Mirjana Najçevska,

eksperte për sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut

(Vertetmates, 03.03.2022)

Invazoni i Putinit në Ukrainë hapi një hapësirë të re dhe krijoi një nevojë të re për ndikim më të madh rus në Maqedoninë e Veriut.

Në kushte kur pushteti në Maqedoni jep mbështetje të padyshimtë dhe shumë të hapur për Ukrainën, e dënon invazionin dhe u ofron ndihmë materiale qytetarëve të Ukrainës, rritet vala e ndikimit rus nëpër rrjete sociale dhe portale/medie të veçanta.

Ky ndikim tashmë nuk është aq direkt, i drejtpërdrejtë dhe i hapur, mirëpo nuk është më pak i rrezikshëm.

Në rrjetet sociale ende mund të shihen tekste dhe qëndrime që paraqesin [mbështetje direkte për Putinin](#) dhe invazionin mbi Ukrainën, mirëpo mediat dhe portalet zyrtare nuk ia lejojnë vetes një qasje të këtillë të hapur, por fillojnë të përdorin mjete më suptile të informimit.

Mbështetja direkte për Putinin shpesh vihet në një kontakt që të ashtuquajturit [cenim të Maqedonisë së Veriut](#) nga shtetet e Evropës perëndimore, e shoqëruar edhe me video dhe fotografi me të cilat paraqiten [sukseset me gjasë të ushtrisë ruse në luftimet në Ukrainë](#), gjegjësisht me artikuj në të cilët aludohet tek [fuqia e ushtrisë ruse, humaniteti i saj](#).





Mirëpo, një nga mënyrat më vështirë të dallueshme të ndikimit, e cila bëhet mjaft agresive prej momentit të fillimit të invazionit të Putinit mbi Ukrainën, është krahasimi, identifikimi dhe arsyetimi i invazionit të Putinit mbi Ukrainën.

**NIVELI I PARË** është krahasimi i invazionit aktual mbi Ukrainën. Zakonisht bëhet me krahasim të invazionit të Putinit mbi Ukrainën me intervenime ushtarake, prani ushtarake dhe/ose mbështetjes ushtarake që e japin SHBA-të nëpër luftërat qytetare/konflikte në Siri, Libi, Jemen, gjegjësisht njohjen e Kosovës.

Bëhet fjalë për një kuazi krahasim, i cili zakonisht fillon me shprehjet: [standarde të dyfishta](#); Rusia nuk e shkatërroi rendin ndërkombëtar, por [NATO dhe Amerika](#); regjimi i SHBA-ve [shkakton kriza](#); përse asnjë nuk [ankohej](#) për luftën në Siri; të kishte sanksione të këtilla [për çdo agresion të SHBA-ve](#), bota nuk do të dinte se si tingëllon himni amerikan, dhe as nuk do të dinte ndonjë sportist të tyre; A ju kujtohet [kur SHBA-të u përballën me sanksione nga BE-ja](#) për shkak të sulmeve mbi Jugosllavinë, Libinë, Irakun, Sirinë etj? Jo. As neve nuk ka kujtohet...

Mënyra më e përhapur e kuazi krahasimit të invazionit të Putinit në Ukrainë, me aktivitetet ushtarake të SHBA-ve, është me vendosjen e tabelave, grafikëve, listave, deklaratave të shkurtra nëpër rrjete sociale... në të cilat numërohen bazat ushtarake të SHBA-ve dhe shteteve në të cilat kanë qenë ose janë në çfarëdo mënyre të pranishëm ushtarakisht SHBA-të ose ku kanë „marrë pjesë“ në rrëzimin e regjimeve ose kanë ndikuar në rrëzimin e tyre.

Pa u futur në diskutim për atë nëse shkelja eventuale e të drejtës në një kohë tjetër, në kushte tjera, vend tjetër, në krejtësisht konflikt tjetër, automatikisht është arsyetim i mjaftueshëm për një shkelje të njëjtë ose të ngjashme të të drejtës tani, në këto kushte, në shtet konkret – Ukrainë.



KOREA, 1950-53	GUATEMALA, 1967-69	SUDAN, 1998
CHINA, 1950-53	CAMBODIA, 1969-70	AFGHANISTAN, 1998
IRAN, 1953	CHILE, 1970-73	YUGOSLAVIA, 1999
GUATEMALA, 1954	ARGENTINA, 1976	AFGHANISTAN, 2001
TIBET, 1959-70s	ANGOLA, 1976-92	IRAQ, 2002-03
INDONESIA, 1958	TURKEY, 1980	YEMEN, 2002-20
CUBA, 1959	POLAND, 1980-81	HAITI, 2004
DEMOCRATIC	EL SALVADOR, 1981-92	SOMALIA, 2006-07
REPUBLIC OF	NICARAGUA, 1981-90	IRAN, 2005-PRESENT
CONGO, 1960-65	CAMBODIA, 1980-95	HONDURAS, 2009
DOMINICAN	LESANON, 1982-84	LIBYA, 2011
REPUBLIC, 1961	GRENADA, 1983-84	SYRIA, 2011-PRESENT
VIETNAM, 1961-73	LIBYA, 1985	BRAZIL, 2016
BRAZIL, 1964	IRAN, 1987-88	BOLIVIA, 2019
BRITISH GUIANA, 1964	LIBYA, 1989	VENEZUELA, 2019
REPUBLIC OF	PHILIPPINES, 1989	GUYANA, 2020
CONGO, 1964	PANAMA, 1989-90	IRAQ, 2020

Në fakt asnjë nuk fillon a as nuk hyn në diskutim të këtitllë.

Thjesht riprodhohen tabela, lista grafikë, tabela, deklarata të shkurtra...

Shpërndarja e [tabelave të këtitlla](#), grafikëve dhe teksteve nëpër rrjete sociale është e drejtuar kah promovimi i idesë për disbalans të madh kuantitativ në veprimet ushtarake të SHBA-ve nëpër botë, që domosdoshmërisht na shpie në përfundimin për arsyeshmërinë, para së gjithash,

karakterin „vetëmbrojtës” të invazionit ushtarak të Putinit në Ukrainë.

Me këtë BE-ja dhe kryesisht shtetet evropiane, përsëri hidhen (ose vendosen në margjina) në fotografjinë e konfliktit midis Putinit dhe botës demokratike, konflikti paraqitet si konflikt midis Rusisë dhe SHBA-ve dhe të gjitha krahasimet bëhen për Rusinë dhe për SHBA-të. Në këtë mënyrë bëhet defokusim i plotë nga situata reale dhe nuk shihet më pasqyra globale në të cilën Putini (jo Rusia) ndërmerr

invazion, të cilin e dënojnë shumica e shteteve të botës, por inputohet perceptimi për një veprim të njëjtë të dy shteteve të mëdha me çka implikohet [se publiku nuk e gjykon \(dënon\)](#) veprimin e njëjës palë, ndërsa e dënon veprimin e palës tjetër.

Postim në Twitter nga Tanja Karakamisheva, profesoreshë në Fakultetin Juridik pranë UKIM-it, i cili transmeton një fotografi të publikuar nga RedFish, [publikim propagandues i mbështetur nga](#)





Kremlini, të cilin e udhëheqin njerëz të lidhur me televizionin shtetëror Russia Today. Ky infografik, që paraqet veprime ushtarake në vende të ndryshme dhe nga periudha kohore të ndryshme shpesh tregohet me gisht si shembull për manipulim, gjegjësisht version i ri i taktikës sovjetike për defokusim (whataboutism).

Forma e thjeshtësuar e këtyre artikujve (në veçanti e tabelave dhe grafikëve) mundëson përhapje të lehtë të tyre dhe ndërtim të perceptimit të gabuar, i cili „kundërshtarin e identifikuar” – SHBA-të i paraqet në dritën më të keqe të mundshme dhe nxit ndjenja negative si ndaj një okupatori dhe agresori të „dëshmuar”, kundrejt Ruisë, për të cilën ofrohet perceptimi se mbrohet me këmbëngulje.

Kjo arrihet në atë mënyrë që asnjë nga këto tekste nuk është i shoqëruar ose nuk ofron analiza, hulumtime, të dhëna më të gjëra, që do të kishin përfshirë një krahasim të vërtetë (rolin e BRSS-së të mëparshme dhe Ruisë së sotme në këto konflikte dhe të ngjashme), edhe as ndonjë sqarim për përmbajtjen e aktiviteteve të përmendura, prapavijës së tyre, përfshirjes/rolit të vetë shtetit që përmendet.

## FUTJA NË NJË THES

Njëkohësisht, perceptimi forcohet ashtu që në një thes janë vënë situata dhe aktivitete plotësisht të ndryshme (të cilat në asnjë mënyrë nuk mund të vendosen nën një emërues). Vetëm nëse i marrim si shembull Poloninë (1980-81), Kuvajtin (1991), Vietnamin (1961-73), e të cilat së bashku paraqiten në një nga listat më të zgjeruara.

Gjegjësisht, në Poloni bëhet fjalë për një lëvizje origjinale të brendshme, e cila zhvillohet ndër vite dhe kulminon me aktivitetet e „Solidarititetit”, ndërsa është drejtuar kah lirimi nga prania e Ruisë dhe demokratizimi i shoqërisë së vetë (që nuk ka asnjë lidhje me SHBA-të) dhe paraqet një dezavum të betejës së shumë viteve të popullit polak për çlirim nga ndikimi i BRSS-së dhe demokratizim të shoqërisë së vetë.

Në Kuvajt bëhet fjalë për kundërshtim të invazionit të bërë nga ana e Irakut në të cilën kanë marrë pjesë 32 shtete (në atë moment koalicioni më i

madh i shteteve pas Luftës së dytë botërore) dhe ku ka [qëndrim të përbashkët të SHBA-ve dhe ish BRSS-së](#) ndaj invazionit të kryer dhe Rezolutë të OKB-së me të cilën mbështetet aksioni për largimin e Sadam Huseinit (Irakut) nga Kuvajti.

Lufta në Vietnam është pjesë e konflikteve që rrjedhin nga dhe janë pjesë e luftës së ftohtë. Vetë lufta ka një prapavijë shumë komplekse (në të cilën marrin pjesë SHBA-të dhe BRSS-ja), ndërsa roli i SHBA-ve në të është një nga më kontroversët, me mbështetjen më të vogël nga shtete të tjera dhe [denohet publikisht](#) si e pamoralshme nga ana e inteligjencës amerikane dhe një numri të madh qytetarësh të SHBA-ve.

Kjo na shpie deri te **NIVELI I DYTË** – barazimi i veçantë, fshirja e dallimeve, identifikimi (i sistemeve, veprimeve, aktiviteteve, mënyrës së veprimit), që e dobëson dënimin (gjykimin) dhe e shkatërron mospajtimin eventual me agresionin konkret të Putinit mbi Ukrainën.

Barazimi fillon me mohimin e ekzistimit të dallimeve në informimin mbi agresionin e Putinit mbi Ukrainën midis megafonëve të kontrolluar nga regjimi rus dhe mediat e shteteve „perëndimore” dhe krijimi i përshtypjes se bëhet fjalë për një betejë të thjeshtë midis gënjeshtreve të dy makinerive propaganduese. Mbyllja e hapësirës mediatike në Rusi dhe mungesa e informatave të jashtme njësohet me kufizimin momental të transmetimit nëpërmjet televizioneve kabllore të dy mediave shtetërore në Rusi (e bërë para së gjithash, si një akt simbolik, i cili më shumë shpreh një qëndrim sesa që kufizon me të vërtetë, nëse e kemi parasysh hapjen e hapësirës mediatike në demokracitë perëndimore).

Barazimi vazhdon në deklarinimin se të gjithë politikanët janë të njëjtë dhe bashkësia ndërkombëtare duhet në mënyrë të njëjtë të reagojë kur bëhet fjalë për [shkeljet e tyre shumë të dukshme](#) të të drejtës ndërkombëtare që të jetë e rrumbullakosur nëpër deklarata se bëhet fjalë për sisteme demokratike të njëjta, në të cilat ka shkelje të të drejtave të njeriut (e madje edhe më shumë [re-spektim të tyre nga ana e Putinit](#) se sa nga demokracitë perëndimore), mirëpo, të cilat nuk janë të ndryshme për nga cilësia, gjegjësisht:





**Nga aspekti politik dhe strategjik, siç e pamë intervenimi në Ukrainë është vetëm operacionalizim i ambicieve të treguara publikisht për rend të ri botëror. Në praktikë kjo artikulohet nëpërmjet frikës nga NATO-ja, cenimit nga NATO-ja dhe rrezikut immanent që, sipas Ruisë, i jep asaj legjitimitet të përdorë forcë. Kjo, vetvetiu tregon se në kuptim juridik mbase Putini thirret edhe në një precedent për përdorimin e forcës, e ajo është përdorimi i parakohshëm i forcës, i cili ishte mjaft aktual gjatë luftës globale kundër terrorizmit.**

Kjo është një mënyrë interesante me të cilën sigurohet continuiteti i raportit pozitiv ndaj regjimit të Putinit me atë që minimizohet e padrejta, vihet në kontekst më të gjerë pa u ofruar sqarime më të qëndrueshme, ose nga ana tjetër realizohet emërues i përbashkët.

Në këtë drejtim janë edhe artikuj që në shikim të parë paraqesin dënim(gjykim) gjeneral të luftës, mirëpo në këto pas përgjithësimi fshihet mungesa e gjykimit (dënimin) konkret, vendosja në një thes dhe njësimi. Konkluzioni përfundimtar është se Ukraina nuk është viktimë e Putinit, por e ndonjë lufte globale, e cila zhvillohet vazhdimisht në të gjitha anët, e në të cilën nuk mund të identifikohet një fajtor, sepse të gjithë një të njëjtën mënyrë janë fajtorë dhe/ose përgjegjës.





„Unë jam kundër të gjitha luftërave” është mënyrë më e mirë që të shmanget se/a jam kundër kësaj lufte konkrete. Me siguri shembulli më i mirë për këtë është teksti i profesoreshës **Biljana Vankovska** i shkruar për gazetën „Nova Makedonija”.

**Peticionin e firmosa**, edhe pse është një përpjekje patetike që „të bëhet diçka”, të qetësohet ndërgjegjja dhe të demonstrohet qëndrimi „në anën e duhur” (pas një heshtje dekadash për aksionet e tjera ushtarake, prej të cilave disa edhe sot janë aktive). Të ashtuquajturit „kontrollues të fakteve” kërkojnë prej dikujt si unë me stazh shumë dekadësh në lëvizjen antiluftë dhe më libër me ese kundër luftës, përsëri dhe përsëri të betohet se është kundër (edhe) kësaj lufte. Tre herë në ditë, edhe me flamurth të detyrueshëm në profilin e Facebookut. Imperativi implikues është mbajtja e anës, sikur të jemi në krizë me „Informbiron”: A je për Titon apo për Stalinin është zëvendësuar me a je për NATO-n/Ukrainën apo për Putinin. Kjo dilemë e rrejtshme në mendjen binare (ose-ose) është vendosur në themelet e kolapsit moral të njerëzimit. Ato nuk mund ta kuptojnë se njeriu duhet të jetë njëllor kundër të dy palëve në luftë. Posaçërisht kur jemi një hap larg holokaustit nuklear, ndërsa BE-ja sillet si piroman, e jo nobelist i paqes. Me furnizim të armëve, Ukraina bëhet një fushëbetejë faktike e NATO-s dhe Ruisë, të mos e gënjejmë veten. Siç thotë Jan Oberg, Perëndimi është në autopilot në një urrejtje të pakufi ndaj Ruisë dhe çdo gjëje ruse (nga Çajkovski deri tek teatri Bolshoj). Me sa duket Putini i ka shënuar në teftër të gjitha veprimet e këtyre 30 viteve të kaluara, e vepron thuajse në mënyrë identike, duke përdorur retorikë, veprime, operacione ushtarake të njëjta, si dhe të drejtën e VETO-s në Këshillin e sigurisë së OKB-së (njëlloj si SHBA-të kur bllokojnë çdo dënim (grykim) ndaj Izraelit me dekada të tëra dhe siç manipulonin me rezolutat e ndryshme që të gjejnë „zbrazëtirë ligjore” për operacionet në të cilat shkatërroan shtete të tëra dhe lanë miliona viktima civile).





Dënimi i një agresioni konkret mbi një shtet të caktuar quhet „*dilemë e rrejshme*”, ndërsa kundërshtimi i agresionit të Putinit quhet „*urrejtje e pakufizuar ndaj Rusisë dhe çdo gjë ruse*”, ndërsa barazimi propagandohet me mesazhin se duhet të jetë „*njëlloj kundër të dy palëve në luftë*”.

## **BARAZIM DHE HEDHJE SUPTILE E FAJIT**

Edhe një mënyrë suptile e ndikimit me njësim, paraqet problematizimi dhe/ose mohimi i karakterit demokratik të shteteve evropiane, që dalin hapur kundër agresionit të Putinit mbi Ukrainën. Kjo është edhe më e rrezikshme kur vjen nga një anëtar i Akademisë të Shkencave dhe Arteve – ASHAM.

Vetëm si shembull, në statusin e saj në Facebook (që pastaj është përcjellë edhe në disa media dhe transmetuar nëpër rrjete sociale), akademik Katica Qulafkova [na njofton se](#):

Por sot, në mars të vitit 2022, pas intervenimit disa ditore special rus në Ukrainë, e gjithë bota „progresive” evropiane dhe amerikane, e madje edhe maqedono-veriore, me të madhe e promovonte politikën brutale të bojkotit të artit dhe kulturës me parashenjë ruse. Thuajse në mënyrë hysterike ndalohen shfaqje, promovime, mësim, shpërndarje dhe komunikim i veprave të jashtëzakonshme të artit dhe kryevepra, bestseller-ë, shfaqje teatrale, filma, koncerte, autorë, kompozitorë, piktorë, këngëtarë operash, evenimente sportive, vetëm se kanë parashenjë ruse.

Me çfarë lehtësie morale dhe intelektuale ndalohet Dostojevski, Çehov, Çajkovski, baleti rus, romanca ruse...? Një dekadencë totale e shpirtit edukativ të Evropës.

Pse dhe si është një publikim i këtillë i rrezikshëm dhe paraqet shembull për përhapje të ndikimit rus në Maqedoni?

Thirrja që në shikim të parë duhet si thirrje legjitime për mbrojtjen e trashëgimisë njerëzore kulturore dhe artistike në vete përmban një përmbytje të fshehur, e cila në mënyrë të njëanshme dhe të paargumentuar e gjykon (dënon) veprimin e demokracive evropiano-perëndimore, e mohon demokratizmin e tyre dhe jep shenjë barazie midis veprimit të tyre dhe agresionit të Putinit në Ukrainë.

Si kryhet akti i barazimit subtil, hedhjes së fajit dhe dënimit të njëanshëm (në favor të Putinit dhe agresionit të tij)?

Së pari, para këtij teksti, akademik Qulafkova nuk ka postuar në profilin e saj në Facebook asnjë tekst tjetër me të cilin e dënon agresionin ushtarak të Putinit mbi Ukrainën. Kjo domethënë se publiku niset nga supozimi se akademik Qulafkova nuk sheh asgjë të keqe në këtë agresion.

Së dyti, luftën e Putinit kundër Ukrainës e quan „operacion special luftarak” konform kërkesave të administratës së Putinit, e cila e mohon se në Ukrainë bëhet luftë.

Së treti, e vendos në thojza fjalën „progresivitet”, me çka e problematizon dhe mohon progresivitetin e demokracive perëndimore.

Së katërti, flet për „politikë brutale” të bojkotit të artit dhe kulturës së ka parashenjë ruse, duke akuzuar për ndalesa hysterike të:

***Dostojevskit, Çehovit, Çajkovskit, baletit rus, romancës ruse...?  
një Dekadencë totale e shpirtit edukativ të Evropës.***

Me çka nuk jep asnjë link ose rast konkret të këtyre ndalesave (të vendosura në kontekst të secilit prej rasteve të dhëna).

Kështu, nuk përmendet se përpjekja për ndalesë të mësimin të Dostojevskit ka hasur në një [reagim shumë të ashpër dhe të shpejt të bashkësisë akademike dha ka qenë e penguar](#). Nuk përmend edhe se [Dirigjenti Valerij Georgiev](#), i cili është detyruar të japë dorëheqje nga pozita e presidentit të nderit të Festivalit ndërkombëtar në Edinburg, është solidarizuar me Putinin dhe nuk është distancuar nga agresioni i Putinit mbi Ukrainën. Nuk përmend se nuk do të ketë Pavilion rus [në Bienalen e Venedikut](#) sepse artistët rusë janë tërhequr me sqarim se:





**Nuk ka vend për art kur vdesin civilë nga raketat, kur qytetarët e Ukrainës fshihen nëpër strehimore, kur demonstrantët rusë janë të detyruar të heshtin.**

E çka është më me rëndësi, akademik **Qulafkova** nuk gjen vend në postimin e saj të shprehë shqetësim për artistët ukrainas, [për trashëgiminë artistike të cenuar të Ukrainës](#) dhe [veprat e shkatërruara të artit](#) si rezultat i agresionit të Putinit në Ukrainë.

Artikulli i saj akademik Qulafkova e përfundon me pyetjen:

**Quo vadis, Europa? A po përballesh me një mutacion nazizmi të një lloji transnacional?**

Kështu e vendosur, kjo qartë implikon karakteristika naziste për shtetet evropiane dhe dërgon deri te „konkluzioni logjik” për të gjithë këto aktivitete, e ai është [arsyetimi i agresionit ushtarak të Putinit mbi Ukrainën](#).

**Këtë që do ta lexoni tani Putini e ka thënë para dy muajsh, dhe e ka transmetuar Gardiani Britanik më 21 dhjetor të vitit 2021. Pas këtyre deklaratave do ta keni të qartë se Perëndimi në fakt me lëvizjet e tij e ka shtyrë Rusinë në kënd, dhe Putini thjesht nuk kishte zgjedhje tjetër, sepse Rusia ishte e cenuar në oborr të vet. Nëse kundërshtari thjesht nuk dëshiron të bisedojë dhe të bëjë kompromise, atëherë lufta është zgjidhja e vetme. Në fund të fundit, le ta kujtojmë krizën raketore kubane, as SHBA-të nuk mundnin të lejojnë raketa në oborin e tyre.**

**NIVELI I TRETË**, arsyetimi i agresionit të Putinit mbi Ukrainën është i mbështjellë në të ashtuquajturën [ruso-fobi](#).



Shpesh është paraqitur si një luftë me [fashizmin në Evropë](#) dhe shtetet evropiane.



**Од Македон** @OdArgeadite · 13h

Историски никој никогаш не ја победил Русија.

На актуелниве македонски политичари и големи партии како и на фашистите низ светов им се ближи крајот.

Смрт фашизму, слобода народу.

Да живее краснаја армија!

Më pas zhvillohet në deklarin se bëhet fjalë për [luftë vetëmbrojtëse](#).

**„Është planifikuar luftë e tretë botërore kundër Rusisë” – deklarin shokues i kryeministrit të mëparshëm të Ukrainës.**

Deri te [mbështetja shumë e qartë](#) e dhënë nga ana e kryetarit të partisë Maqedonia e Bashkuar, **Janko Baçev**. (E cila zë vend në të përjavshmen e njohur “Fokus”):

**Për mua intervenimi rus është i justifikuar sepse u sollën në gjendje që të mos kenë më se çfarë të humbin nëse NATO-ja u vjen në kufi. Pyes, si do të kishin reaguuar NATO-ja dhe SHBA-të në një situatë të supozuar, nëse Kanadaja ose Meksika hyjnë në aleancë ushtarake me Rusinë dhe si rrjedhojë e kësaj, nga ana ruse të grumbullohen armë ruse në kufi me SHBA-të. Si do të kishin vepruar amerikanët në rast të këtillë?**

Asnjë nga këto teza nuk është e mbështetur me të dhëna relevante, argumente, analiza, fakte.. Mirëpo, me numrin gjithnjë e më të madh të tyre, ato përpiqen të krijojnë përshtypje se ekziston ndonjë “e vërtetë e fshehur”, ndonjë konspiracion i madh, ndonjë situatë plotësisht e ndryshme nga ajo të cilën njerëzit mund ta shohin se si zhvillohet para syve të tyre.

Dhe për çdo rast, këtu kemi edhe një deklaratë të një intelektual [se ajo](#)





që po ndodh në Ukrainë është shumë tragjike dhe pikëlluese, megjithatë nuk ka lidhje me Maqedoninë dhe me jetën tonë:

**Më dhemb zemra kur shoh se populli maqedonas është i ndarë sa i përket çështjes se kush është për Rusinë apo Ukrainën. Preferoj që të gjithë të jenë për Maqedoninë. Fatkeqësisht, vetëm disa qindra, herë pas here disa mijëra, ishim ne idealistët që dolëm në rrugë, para Kuvendit dhe Qeverisë, duke luftuar për Maqedoninë. Shumica qëndruan në shtëpi dhe e mbyllën gojën!**

**Më vjen keq që nuk e shihni pamjen e madhe, dhe përderisa ju të gjithë grindeni, rriheni, shani, dikush po bën para. Mos hyni në axhendat e njerëzve të tjerë. Duajeni veten, kujdesuni për familjet dhe të dashurit tuaj dhe mos harroni Maqedonia mbi të gjitha!**

Sipas këtij mesazhi, për shkak se janë të gjithë njësoj dhe nuk ka dallim në sistemet e vlerave që ofrojnë, flasim vetëm për lojëra në të cilat nuk ka vend për ne dhe është mirë të mos mbajmë anë, sepse e vetmja anë që duhet të na interesojë është e jona.

Në këtë mënyrë jo vetëm që në Rusi barazohen demokracitë perëndimore dhe regjimi i Putinit, por propagandohet edhe propaganda e favorizimit dhe e prirjes ndaj fituesit, kushdo qoftë ai.

# PROPAGANDISTI DUGIN, SATANIZIMI I PERËNDIMIT DHE APOLOGJIA E IMPERIALIZMIT RUS

Në këtë analizë të shkurtër, të shkruar në një kohë kur trupat e Putinit vazhdojnë të bombardojnë objektet civile në Kiev, ne do e shqyrtojmë veprimtarinë ideologjike dhe propagandistike të Dugin pas „operacionit special” ushtarak të Rusisë, duke kujtuar aktivitetet propagandistike dhe mesazhet e tij nga misioni „Euro-aziatik” në Maqedoni në vitin 2018

Shkruan: Zharko Trajanoski, analist mediatic

(Vertetmates, 23.03.2022)

**Aleksandar Dugin**, ideologu i „lëvizjes euroaziatike” dhe një nga agitatorët dhe propaganduesit më të shkathët ushtarak të agresionit rus në Ukrainë, për publikun maqedonas është bërë i njohur nga paraqitja e tij në emisionin „[Milenko Nedelkovski Show](#)” në vitin 2015.

Atëkohë, nikoqiri i tij, i cili ka pasur mundësinë të lexonte një artikull të Dugin në të cilin ai promovon luftën e përbashkët të të krishterëve dhe myslimanëve kundër Antikrishtit, e ka pyetur: „Kush është Antikrishti?”. Dugin i përgjigjet në mënyrë eksplicite se „Antikrishti janë Shtetet e Bashkuara“, duke thënë se janë një civilizim materialist dhe se „mbjellin gjak, ligësi dhe poshtërsi“. Në po atë edicion të „[Milenko Nedelkovski Show](#)” në dhjetor të vitit 2015, Dugin paralajmëroi për kolaps të liberalizmit, që do të shkaktojë kolaps të BE-së dhe në stilin e një „profeti” tha se „lufta është e pashmangshme, një luftë e vërtetë dhe e madhe”. Dugin përshkroi edhe „maksimumin e perimetrit rus” të veprimit që synon „çlirimin e tre vendeve më të rëndësishme të shenjta të Rusisë – Kievit, Kostandinopojës, Jeruzalemit” – dhe thotë se Kievit është „kryeqyteti i botës ruse“, Kostandinopoja – kryeqyteti i Ortodoksisë dhe Jeruzalemi – kryeqyteti botëror.





*Aleksandar Dugin. Foto: Mehdi Bolourian, Wikipedia, 2020*

Në këtë analizë të shkurtër, të shkruar në një kohë kur trupat e Putinit vazhdojnë të bombardojnë objektet civile në Kiev, ne do e shqyrtojmë veprimtarinë ideologjike dhe propagandistike të Dugin pas „operacionit special” ushtarak të Rusisë, duke kujtuar aktivitetet propagandistike dhe mesazhet e tij nga misioni „Euro-aziatik” në Maqedoni në vitin 2018.

### **Satanizimi i Dugin i Ukrainës, Zelenskit dhe Perëndimit**

Aleksandar Dugin tenton ta justifikojë agresionin rus kundër Ukrainës duke përdorur një gamë të gjerë teknikash propagandistike, narrativa dhe mesazhe mediatike. Një nga teknikat që përdor është deifikimi (hynizimi) i kauzës (Rusia dhe „operacioni special” në Ukrainë) dhe satanizimi i kundërshtarit (shteti ukrainas dhe Perëndimi), pra pasqyrim të kundërshtarit si „djall”. Për shembull, më 13 mars të vitit 2022, [portali i famshëm djathtist pro Putin „Infomax”](#) publikoi një [kollumnë](#) (të marrë nga „[Sllobodën Svet](#)”) në të cilën Dugin përcolli një mesazh të frikshëm ku thoshte se lufta e Rusisë kundër Ukrainës ishte një luftë kundër vetë djallit, i cili dëshiron që ta shkatërrojë njerëzimin dhe t’i kthejë njerëzit në robotë dhe mutantë:



**Lufta e vërtetë nuk është kundër Ukrainës, por kundër Forumit Ekonomik Botëror dhe planeve të tij djallëzore për ta shkatërruar njerëzimin duke legalizuar të gjitha llojet e perversiteteve, mëkateve dhe krimeve dhe përfundimisht duke i kthyer njerëzit në robotë dhe mutantë dhe duke ia kaluar fuqinë inteligjencës artificiale. Po përballet me vetë djallin... – shkruan Dugin.**

Mesazhi se Rusia „po përballet me vetë djallin” nuk është befasues për ata që e njohin veprimtarinë propagandistike të Dugin. Në librat e tij, Dugin predikon se Rusia është në periferi të „Satanopolisit” duke propaganduar një „revolucion kundër botës postmoderne” (*Platonizmi politik, Filozofia e politikës*, 2019). Përveç kësaj, në „*Teorinë e katërt politike*“ globalizimin (me qendër në Shtetet e Bashkuara) Dugin e përshkruan si „mbretërinë e Antikrishtit” dhe unipolaritetin si një e keqe. Në interpretimet bipolare të Duginit, për dallim nga kjo e keqe dhe „*Antikrishti*” Moska përshkruhet si „Roma e Tretë”, si mbrojtje nga Antikrishti ose „kështjellë” ortodokse (Katechon). Është interesante të theksohet se Dugin jo vetëm satanizon Ukrainën dhe Perëndimin, por edhe vetë Rusinë, për të cilën ai pretendon se u krijua nga djalli në vitet 1990 si „anti-Rusi”.

Dugin e justifikon „*operacionin special*” të Putinit si një ndërprerje të lidhjeve me Perëndimin „*djallëzor*”, si fillimin e „*betejës së fundit mes dritës dhe errësirës, neve dhe atyre, Euroazisë dhe Atlantikut*”. Beteja me „*djallin*”, sipas Duginit, nuk është vetëm kundër Ukrainës dhe Perëndimit, por edhe kundër kolonës së pestë të satanizuar si një „*shtresë të djallit në shoqërinë ruse*”.

Kur përdor teknikën propagandistike të satanizimit, Dugin jo vetëm që denigron disa vende (si Ukraina apo Shtetet e Bashkuara), por edhe individë të caktuar në pushtet. Për shembull, menjëherë pas fitores së Zelenskit në zgjedhjet në Ukrainë në vitin 2019, Dugin në profilin e tij në Facebook shkruan se „*Në zgjedhjet në Ukrainë fitoi djalli*” dhe se „*Shkatërrimi i vërtetë i Ukrainës fillon pikërisht tani*”.





## Apologjia e Dugin për imperializmin rus: „Perandoria kundërpërgjigjet“?

Një ditë para agresionit ushtarak rus ndaj Ukrainës, Alexander Dugin [para-lajmëroi](#) fillimin e „mobilizimit euroaziatik të Rusisë“ me sloganin propagandistik „Rusia e Re është territori i së ardhmes“. Duke folur në vetën e parë shumë, në emër të popullit, Dugin deklaroi se „Ne jemi njerëzit e perandorisë“. Për dallim nga „Lavdi Ukrainës“, slogani i Duginit është „Lavdi Rusisë së Re“, një shprehje e [pranuar](#) nga lëvizja „Cargrad“. Për Dugin, njohja e „republikave“ në Ukrainë nga Putini shënoi „fillimin e dytë të ripushtimit të madh sllav“.

Në 12 mars të vitit 2022, Dugin [mori pjesë](#) edhe në emisionin televiziv të propagandistit më të famshëm rus Vladimir Solovjev, i cili [e prezantoi si](#) „udhëheqës të lëvizjes euroaziatike ndërkombëtare“. Në stilin e tij të njohur propagandistik, Solovjev [konstatoi](#) se Perëndimi i ka dhënë vetes një detyrë për të shkatërruar – jo aq Rusinë, por popullin rus, kulturën ruse dhe vetë shpirtin e civilizimit rus. Në monologun e tij „filozofik“ Dugin u ndërlihdh edhe në mitet propagandistike „zyrtare“ të Solovjev, ndërsa në prapavijë të bisedës reklamohej makineria ushtarake ruse në aksion. Sipas Dugin, „operacioni special“ rusisë do i mundësojë që të fitojë respekt si një lojtar serioze në [tabelën gjeopolitike të shahut](#), „si një pol një botëm multipolare“ dhe si një „civilizim sovran“.



*Dugin në emisionin televiziv tek propagandisti më  
i famshëm rus Vladimir Solovjev*

Megjithatë, Shtëpia e vërtetë propagandistike e Dugin është Kanali televiziv ortodoks, [Cargrad](#), pronë e oligarkut rus **Konstantin Malofeev**, i cili u gjet në [listën e sanksioneve të BE-së në vitin 2014](#), për shkak të mbështetjes së destabilizimit të Ukrainës Lindore. Vetë Dugin prezantohet si ish kryeredaktor i „Telekanal Carigrad“, ndërsa përshkruhet edhe si [mastermind](#) i tij. Është interesante se Malofeev si producent kryesor i „TV Hyjnore“ ka angazhuar një ekspert nga Perëndimi – ish producentin e Fox News – i cili nga viti 2022 [po ndiqet penalisht nga SHBA](#) për shkak të [bashkëpunimit me Malofeevin e sanksionuar](#) për të krijuar rrjete televizive në Rusi, Bullgari dhe Greqi.

Afërsia e Dugin me Konstantin Malofeevin pasqyrohet edhe në atë se Malofeev e përshkruan si një „filozof dhe bashkëmendimtar“ në hyrjen e librit të tij „Perandoria“, të promovuar pikërisht nga Dugin. Në [promovimin e librit](#) në dhjetor të vitit 2021, Dugin [theksoi se](#) „Ne jetojmë në një botë perandorish“ dhe se „Ne kurrë nuk kemi jetuar jashtë botës së perandorive“. Ai theksoi se „Krishterimi dhe perandoria janë të pandashme“ dhe se Rusia si „Roma e tretë“ është një vazhdimësi e politikës së krishterë.



**Dugin e promovon librin „Perandoria“ të oligarkut rus Konstantin Malofeev**





Në një [intervistë](#) me Dugin në [TV Cargrad](#) kah fillimi i vitit 2022, Malofeev promovon sloganin e tij politik perandorak: „Perandoria është e kaluara dhe e ardhmja jonë. Ne nuk mund të mos jemi një perandori.” Sipas [Malofeev](#), Rusia është një „civilizim i madh i vetë-mjaftueshëm” që duhet të zhvillohet më vete: „ose jemi një pjesë e civilizimit perëndimor të parasë, Kanaanit të ri global, ose jemi ne Perandoria, Katekoni, që e mbron botën nga e keqja”.



***Konstantin Malofeev***

Nga shumë postime të tjera në media mund të shohim se Dugin dhe Malofeev nuk janë thjesht agjitorë dhe propagandistë ordnerë militantë, por se ata sillen edhe si predikues të „Romës së tretë” dhe ideologë të imperializmit „euroaziatik” të Putinit.

Në „[analizën e tij gjeopolitike](#)” të botuar më 10 mars të vitit 2022, Dugin thekson se „sipas ligjeve të gjeopolitikës”, Rusia („Euroazia”) pa Ukrainën nuk është një perandori dhe civilizim, por se me Ukrainën është një perandori dhe civilizim. Dugin predikoi „bashkimin” e Ruisë dhe Ukrainës dhe rënien e „unipolaritetit” me [idenë gjeopolitike](#) për një „bashkësi të shteteve sllave”

si vazhdimësi e „*integritimit euroaziatik*“. Dugin [pretendon](#) se bëhet fjalë për një „*një faqe krejtësisht e re në historinë botërore, një botë multipolare dhe një ndryshim të plotë të rendit botëror*“, me sllavët lindorë të „*integruar*“ në territorin e „Euroazisë“.

„*Integritimi*“ i tillë euroaziatik, [sipas Dugin](#), nënkupton një „*heqje të plotë të modelit të shtetit nacional dhe kombit*“, që është zhvilluar për më shumë se 30 vite në Ukrainën moderne postsovjetike. „Profeti“ gjeopolitik parashikon një rikthim të gjendjes përpara fillimit të shtetësisë së Ukrainës – „*integritimin*“ në një komb të sllavëve lindorë, degët e të cilëve janë Velikorusët dhe Rusët e vegjël (si dhe Bjellorusët).

Po çfarë do të ndodhë me qytetarët e Ukrainës që identifikohen si ukrainas? Para fillimit të „*operacionit special*“, Dugin [e shpalli](#) Ukrainën një „*failed state*“, duke njoftuar se ukrainasit do të paguanin një çmim të madh sepse kanë zgjedhur të jenë „*shërbetorë të Perëndimit*“. Kërcënime të tilla të Dugin nuk janë të rralla nëse i kujtojmë [deklaratat e tij ekstremiste nga vitit 2014](#), të cilat [u hoqën](#) nga Youtube për shkak të gjuhës së urrejtjes. Pas „*operacionit special*“, imperialisti rus Dugin filloi të [predikojë](#) një histori tjetër, se „*ukrainasit kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë vëllezërit dhe motrat tona*“, dhe se „*ukrainasit nuk janë armiq, ata janë tanët*“ dhe se „*vëllezërit ukrainas*“ kanë qenë të mbërthyer [në një huti tragjike](#) si rezultat i propagandës perëndimore.

## Dugin për „*fundin e historisë*“, „*përplasjen e civilizimeve*“ dhe „*të keqen absolute*“

Më 24 shkurt të vitit 2022, kur Putini e filloi „*operacionin special*“ me agresion ushtarak kundër Ukrainës, Dugin „*deklaroi*“ se kishin filluar të shihen konturat e „*Rusisë së përjetshme*“ dhe se ky ishte një moment fetar: „*Ky është një moment fetar. Jo vetëm gjeopolitikë apo konflikt interesi. Kjo është një përplasje civilizimesh*“.

Në shkrimin nga data 14.3.2022, „[Fundi i historisë që nuk ndodhi kurrë dhe lufta e Rusisë kundër rendit liberal](#)“, Dugin është i bindur se Huntington





me „përplasjen e civilizimeve” e mundi teorikisht Fukuyaman me „*fundin e historisë*”, por se shprehja e Fukuyama „*Lufta e Putinit kundër rendit liberal*” është absolutisht korrekte.

Dugin përsërit sloganin propagandistik se „pa Ukrainën Rusia nuk është një perandori”, duke sugjeruar se do të ishte edhe më transparente të thuhej se pa Ukrainën – Rusia nuk do të ishte një civilizim apo „*pol në një botë multipolare*”. Sipas Dugin, „operacioni special ushtarak në Ukrainë është momenti kyç në etablimin e Rusisë si civilizim, si pol sovran i një bote multipolare” dhe ai operacion ishte i drejtuar kundër liberalizmit dhe globalizmit (kundër „*planit djallëzor të globalistëve*” dhe kundër liberalizmit modern si një e keqe e vërtetë dhe një „*e keqe absolute*”).

Më 24 shkurt të vitit 2022, kur tanket ruse filluan të shkelin Ukrainën, [profeti i „Novorusia”](#) në „Katekon” [postoi](#) komente demonizuese kundër liberalëve: „*Kur kemi të bëjmë me liberalë, kemi të bëjmë me njerëz të fiksuar. Ata janë të pushtuar nga demonët*”.

Por, si tenton Dugin t’i justifikojë sulmet „civilizuese” ruse ndaj objektivave civile dhe ndaj ukrainasve si një komb më vete? [Sipas Dugin](#), ukrainasit janë pjesë e „*treshes së popujve sllavolindor*”, por „*i kanë bindur se janë pjesë e botës perëndimore (globale)*” dhe se „*rusët nuk janë vëllezër, por armiq të ashpër*”.

Sipas „logjikës” së Dugin, Putini imperialist i granaton dhe bombardon ukrainasit „*të pushtuar nga demonët*” për t’i „*çliruar*” ata nga demonët perëndimorë dhe për t’i „*bindur*” se janë vëllezër dhe jo armiq. Ndërsa „*profeti*” Dugin përpiqet ta justifikojë Putinin imperialist si një luftëtar „*jo kundër Ukrainës, por për Ukrainën*” (por në Euroazi), „*Lufta e Putinit kundër rendit liberal*” ka shkaktuar një krizë humanitare me mijëra viktima dhe miliona refugjatë të tmerruar nga veprimet „civilizuese” të „*Rusisë vëllazërore*”.

## Misioni Euroaziatik i Dugin në Maqedoni dhe ithtarët e tij

Pasi nga fillimi i vitit 2018, partia marginale e **Janko Baçev**, LKM, u riemërua në „Maqedonia e Bashkuar” (sipas „Rusisë së Bashkuar” të Putinit), partia e saporiemëruar organizoi një panel diskutimi mbi qëllimet kryesore politike – „[Republika e Maqedonisë në aleancë strategjike me Rusinë dhe anëtarë e Unionit Ekonomik Aziatik](#)“. Në diskutim si folës kryesor u prezantua „*prof. Aleksandar Dugin, këshilltari i parë i presidentit rus Vladimir Putin*”. Dugin dhe „zëvendësi i tij prof. **Leonid Savin**” dhe në mediat maqedonase u përshkruan si „[Këshilltarë të presidentit rus Vladimir Putin](#)” ose si „[skautë politik të Putinit](#)“, dhe Dugin si „këshilltari i parë i presidentit rus Vladimir Putin” dhe „[truri i Putinit](#)“, gjë që u interpretua si një [ekzagjerim](#).

Para fillimit të debatit, në një deklaratë për gazetarët, Dugin theksoi përkushtimin e tij pansllav për bashkimin e pjesëve të popujve sllavë dhe nevojën „*për të mos sakrifikuar unitetin sllav*“. Tezat kryesore të propagandës së Dugin ishin se „[BE-ja ngadalë po shpërbëhet](#)” dhe „[Perëndimi po dështon](#)” ([Dugin: Nuk ju duhet BE-ja, ajo do të shpërbëhet](#)), dhe „Rusia është e hapur si një bashkim euroaziatik”. Mesazhi i Dugin – „*Nëse jeni në Federatën Ruse, ne do të jemi një botë e përbashkët sllave*“, u pasua nga një deklaratë se Rusia nuk është kundër Perëndimit: „*Ne nuk e kundërshtojmë Perëndimin, duam të kemi një mirëkuptim me të gjitha kombet, përfshirë këtu edhe popujt evropianë*”.

Nga këndvështrimi i sotëm, narrativat e [pabaza](#) të Dugin nga Shkupi, se Rusia nuk e kundërshton Perëndimin, u përgënjeshtroan nga vetë ai, njësoj si edhe përshkrimet e tij të pabaza të Rusisë si një vend i „*demonizuar*“:

**Rusia është një vend i demonizuar, për ne thonë gjëra të pavërteta e që nuk janë reale, se ne na pëlqen të pushtojmë, të nënshtrojmë, të ndërhyjmë në politikat e brendshme... Nuk ka asgjë të tillë – tha Dugin në Shkup në vitin 2018.**

Përkundër retorikës propagandistike të Dugin në vitin 2018, Dugini demonizues në vitin 2022 e justifikon Rusinë si një perandori që nuk është





në luftë me Ukrainën, por me Perëndimin dhe Antikrishtin – të cilët kanë plane djallëzore për ta shkatërruar njerëzimin dhe për t'i kthyer njerëzit në robotë e mutantë.

Me propagandistë politike dhe profetë si Aleksandar Dugin, Rusia e Putinit nuk është një „vend i demonizuar“, por një vend që demonizon dhe satanizon duke u munduar të justifikojë agresionin e pajustificueshëm ndaj Ukrainës.



# ANALIZA GAZETARESKE





# UKRAINA KËRKON NGA MAQEDONIA E VERIUT T'I BASHKOHET SANKSIONEVE EKONOMIKE TË BE-SË NDAJ RUSISË

Shkruan: Bojan Blazeovski

Infografia: Goran Rizaov

(Meta, 14.02.2022)

Ambasadorja e Ukrainës në Maqedoninë e Veriut, Natalia Zadorozhnyuk në [Panel diskutimin e CIVIL-it](#) në temë “Kriza ruso-ukrainase dhe Maqedonia e Veriut”, që u zhvillua më 9 shkurt, [deklaroi](#) se, në lidhje me konfliktin mes Rusisë dhe Ukrainës, Ukraina pret mbështetje të qartë dhe pa mëdyshje politike nga Maqedonia e Veriut por edhe që vendi ynë t'i bashkohet sanksioneve ekonomike kundër Rusisë që u vendosën nga Bashkimi Evropian (BE) në vitin 2014, pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia, shkruan [Meta.mk](#).



*Ambasadorja e Ukrainës  
në Shkup, Natalia  
Zadorozhnyuk; Foto:  
Ambasada e Ukrainës në  
Shkup*





“Presim t’i bashkoheni sanksioneve të Bashkimit Evropian. Nuk mund të ulesh në dy karrige. Ka momente në jetë kur duhet të vendosësh vetë, së pari, në cilën anë të barrikadës je. Ukrainasit kanë përvojë negative shumë bindëse me neutralitetin. Nëse shkojmë në Bashkimin Evropian dhe NATO, nëse jemi pjesë e vlerave evropiane, atëherë e demonstrojmë atë jo vetëm me fjalë, por edhe me veprime dhe vepra”, tha ambasadorja ukrainase Zadorozhnyuk.

## Mbështetje politike nga vendi për Ukrainën ka

Sa i përket përkrahjes politike, ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë, Bujar Osmani, më 31 janar të këtij viti në takim me ambasadorin rus në Shkup, Sergej Bazdnikin [e përsëriti pozicionin](#) se Maqedonia e Veriut e respekton sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht.

Mbështetja politike për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës mbërriti disa ditë më vonë edhe nga kryeministri Dimitar Kovaçevski, i cili më 3 shkurt u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg.



***Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg | Burimi i fotos: Qeveria e RMV-së***

“E mbështesim propozimin e NATO-s për takime tematike me Rusinë për gjendjen e marrëdhënieve, sigurinë evropiane me fokus Ukrainën, transparencën, uljen e rrezikut dhe kontrollin e armëve. E mbështesim plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht”, [deklaroi kryeministri](#) Kovaçevski.

## **Sanksione ekonomike nga vendi ndaj Ruisë nuk ka**

Megjithatë, prej vitesh vendi nuk iu ka bashkuar sanksioneve të vendosura nga Bashkimi Evropian pas aneksimit të paligjshëm, nga Rusia, të gadishullit të Krimesë, i cili ndodhet në territorin ukrainas. Maqedonia në vitin 2014 nuk iu bashkua sanksioneve të BE-së pas aneksimit të Krimesë dhe që atëherë nuk kemi marrë vendim të ri, ndërsa në fund të vitit 2020 për këtë temë ka shkruar [Radio Evropa e Lirë](#) në gjuhën maqedonase.

Ish-kryeministri Zoran Zaev [në një deklaratë](#) më 30 dhjetor 2020 shpjegoi se Maqedonia e Veriut nuk iu ka bashkuar sanksioneve të BE-së kundër Ruisë, sepse vendi ka interes serioz për bashkëpunim ekonomik me Rusinë.



***Ish-kryeministri maqedonas Zoran Zaev Foto: Qeveria e RSM***





“Ne jemi vend kandidat për anëtarësim në BE, por nuk jemi anëtar. Është në interes të qytetarëve dhe shtetit, që nëse nuk duhet të bëjmë diçka, të mos e bëjmë. Përkundër gjithë asaj që thashë, ne nuk iu kemi bashkuar masave ekonomike ndaj Rusisë, sepse kemi interes serioz për bashkëpunim ekonomik me Rusinë. Ne jemi vend anëtar i NATO-s dhe për ne nuk ka alternativë për BE-në, por vendi ynë ka interes të jetë mik me pjesën tjetër të botës”, tha atëherë kryeministri Zaev.

Ai shtoi se që nga viti 2016, vendi iu ka bashkuar të gjitha deklaratave, masave dhe sanksioneve të miratuara nga BE-ja, përfshirë ato kundër qytetarëve dhe personave juridikë rusë. Shkalla e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në qëndrimet, masat dhe deklaratat e BE-së, përkatësisht respektimi i tyre në fund të vitit 2020 ishte 94 për qind, ndërsa në vitin 2016 ishte 74 për qind.

### Vëllimi i këmbimit të mallrave të RMV-së

janar - dhjetor 2021




Chart: Agjencia e lajmeve Meta • Source: Entit Shtetëror i Statistikave • Created with Datawrapper

## Eksportet drejt Rusisë u ulën, importet u rritën

Nga ana tjetër, sipas [të dhënave të fundit](#) të Entit Shtetëror të Statistikave për Tregti të Jashtme në periudhën janar-dhjetor 2021, Federata Ruse është në vendin e 20-të në mesin e vendeve me të cilat Maqedonia e Veriut ka pasur vëllimin më të madh të tregtisë. Vëllimi i përgjithshëm i shkëmbimeve vitin e kaluar arriti në 233.507.000 dollarë amerikanë dhe është rritur për 12,4 për qind krahasuar me vitin 2020.

Kështu, eksporti i Maqedonisë së Veriut në Federatën Ruse vitin e kaluar ka qenë 57.140.000 dollarë amerikanë dhe është zvogëluar për 5,4 për qind në krahasim me vitin 2020, ndërsa nga Rusia në vitin 2021 kemi importuar mallra në vlerë prej 176.367.000 dollarë dhe kjo është një rritje prej 19,7 për qind në krahasim me Janar-Dhjetor 2020.

### Shkëmbimi i mallrave të Maqedonisë së Veriut me vendet e huaja

(Janar - dhjetor 2021)

■ Importi ■ Eksporti




Chart: Agjencia e Injeneri Merit - Source: Enti Shtetëror i Statistikave - Created with Datawrapper

## Sanksionet e BE-së janë në fuqi për gati 8 vjet

Bashkimi Evropian, në vitin 2014, së bashku me Shtetet e Bashkuara vendosën sanksione ndaj Ruisë menjëherë pas aneksimit të paligjshëm të gadishullit të Krimesë nga Rusia. Sipas [komunikatës së fundit të Këshillit Evropian](#) nga 13 janari 2022, BE i ka vazhduar sanksionet ekonomike kundër Ruisë deri më 31 korrik 2022. Deri më tani, BE-ja ka shtuar shpesh masa të reja ndaj Ruisë.





Sanksionet e BE-së ndaj Ruisisë përfshijnë kufizimin e qasjes në tregjet primare dhe sekondare të kapitalit të BE-së për disa banka dhe kompani ruse, si dhe ndalimin e formave të ndihmës financiare dhe ndërmjetësimit për institucionet financiare ruse. Sanksionet e ndalojnë edhe eksportin, importin ose transferimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të materialeve që ndërlidhen me mbrojtjen, por edhe kufizime të qasjes ruse në disa teknologji të ndjeshme që mund të përdoren në sektorin energjetik të Ruisisë, për shembull, në prodhimtarinë dhe kërkimin e naftës, si dhe një sërë të sanksioneve të tjera ekonomike të BE-së ndaj Ruisisë.

Në të njëjtën kohë, masat e ndërmarra nga BE ndaj Ruisisë në lidhje me integritetin territorial të Ukrainës aktualisht aplikohen ndaj 185 persona dhe 48 subjekte. Në rastin e personave, ata i nënshtrohen ngrirjes së pronës, duke përfshirë ndalimin e dispozicionit të fondeve, si dhe ndalimin e udhëtimit, gjë që i pengon këta persona të hyjnë ose kalojnë transit nëpër shtetet anëtare të BE-së, [thuhet në ueb-faqen e Këshillit Evropian](#).

Përveç aplikimit nga vendet anëtare të BE-së, sanksionet e BE-së të vendosura ndaj Ruisisë për shkak të aneksimit të Krimesë u mbështetën edhe nga Mali i Zi dhe Shqipëria si kandidatë për anëtarësim në BE, por jo edhe nga Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Sipas një deklarate të Këshillit Evropian të 27 korrikut 2021, sanksionet u zgjatën deri në verën e vitit 2022 [i mbështetën Mali i Zi dhe Shqipëria](#), së bashku me Gjeorgjinë dhe Norvegjinë. Ndryshe, vendet kandidatë për anëtarësim në BE nuk janë të obliguar që të zbatojnë plotësisht rregulloret evropiane para se të bëhen anëtarë zyrtarë të Unionit.

## **Maqedonia nuk ka interesa politike të ngjashme me Serbinë**

Megjithatë, në rastin e Serbisë, lidhshipi aktual në Beograd, nëpërmjet Kryetarit të Parlamentit serb Ivica Dačić, në qershor të vitit 2021 tha se Serbia nuk do të vendoste kurrë sanksione ndaj “mikut të saj Ruisisë”, kurse [EUOberserver e transmeton](#) qëndrimin e tij dhe qëndrimin e ministrit të Jashtëm serb Nikolla Selaković se Rusia ia jep mbështetjen më të madhe Serbisë në ruajtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të saj mbi Kosovën. Megjithatë,




ndryshe nga Serbia, e cila kërkon një aleat më të fuqishëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së gjatë me Kosovën, Maqedonia e Veriut aktualisht nuk ka interes të tillë politik nga Rusia.



***Ministri i Jashtëm i Serbisë, Nikolla Selaković***  
***Foto: Qeveria e Republikës së Serbisë, srbija.gov.rs***

Ndryshe nga Maqedonia e Veriut, ndikimi rus në sektorin energjetik në Serbi është shumë më i pranishëm. Industria e naftës Serbia (NIS), një nga eksportuesit më të mëdhenj të Serbisë, është në pronësi të kryesisht kompanisë ruse “Gazprom Njeft” pasi 51 për qind e aksioneve u shitën në vitin 2008. [Radio Evropa e Lirë në serbisht shkruan](#) se për të tetin vit radhazi NIS nuk mund të marrë kredi nga bankat perëndimore, por problem është edhe blerja e pajisjeve nga prodhuesit e BE-së dhe SHBA-së. Shkak për këtë nuk janë vetëm sanksionet ekonomike të vendosura të BE-së ndaj Rusisë, por edhe fakti që kompania shtetërore ruse “Gazprom Neft”, e cila zotëron NIS, është përfshirë në listën e zezë të subjekteve të BE-së dhe [SHBA](#) pas aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia.





INFORMATION

# ANALIZË: LUFTA NË UKRAINË DO TË SHKAKTOJË JOSTABILITET EKONOMIK NË RMV

**Konflikti ushtarak në Ukrainë pritet të shkaktojë pasoja në ekonominë e Maqedonisë së Veriut. Para së gjithash, pasojat kanë të bëjnë me pengesat në shkëmbimin tregtar me Ukrainën e cila është shënjestër direkte e sulmeve ushtarake, por edhe me Rusinë ndaj së cilës Maqedonia e Veriut vendosi sanksione dhe nga e cila priten sanksione reciproke në periudhën vijuese, shkruan Portalb.mk.**

**Shkruan: Teuta Buçi**

**(Portalb, 22.03.2022)**

Anëtarët e grupit punues të ekspertëve për politikë të jashtme dhe të sigurisë dhe drejtori ekzekutiv i **Institutit Prespa**, Ivana Jordanoska, Angelina Cvetkovska, Vesna Poposka, Vesna Shapkoski dhe Andreja Popovski, kanë **bërë një analizë** që e prezantuan sot, për çështjet e rëndësishme në lidhje me invazionin rus ndaj Ukrainës dhe efektin ndaj Evropës, por edhe ndaj Maqedonisë së Veriut.

Sipas kësaj analize, fakti që nga Rusia dhe Ukraina vijnë produktet kyçe siç është gazi natyror, nafta dhe gruri, tregon se vendin e presin çmime shokuese dhe jostabilitet ekonomik. Pavarësisht nëse ky shkëmbim tregtar zhvillohet mes Maqedonisë së Veriut dhe këto dy vende apo përmes kanaleve të Bashkimit Evropian, pasojat veç më ndjehen dhe ato veç do të përkeqësohen nëse së shpejti nuk ndërpriten veprimet ushtarake.

**“Gazi natyror mund të tregohet si produkti i cili mund të jetë më kritik në periudhën vijuese, ndërsa si pasojë e veprimeve ushtarake dhe sanksioneve ekonomike që vendosen. Kriza në furnizimib e energencave pritet ta godasë**





**ndjeshëm edhe Bashkimin Evropian. Kjo, përkrah asaj që do të reflektohet në çmime shokuese në mënyrë të ndjeshme për një paletë të gjerë të produkteve, jo vetëm në vendet anëtare por edhe më shtete tjera të varura nga importi i BE-së, siç është rasti me Maqedoninë e Veriut”, thuhet në analizë.**

**Marina Tuneva, drejtoreshë e KEMM, thotë se mediat profesionale dhe kredibile kanë rol më të madh dhe mund të ndihmojnë të prezantohet e vërteta për luftën në Ukrainë. Në një intervistë për “Vërtetëmatës”- in, Tuneva shprehet:**

**Nuk është gjithmonë e lehtë të arrihet deri te e vërteta, sidomos në kushte të këtilla, gazetarët dhe punonjësit e medias e kanë të vështirë ta bëjnë punën e tyre, kur nga të gjitha anët ka një vërsim të vazhdueshëm të dezinformatave, por secili që punon profesionalisht gjen forcën për të ardhur deri tek e vërteta dhe të gjejë burimet e duhura të informacionit. Një nga mënyrat për ta dalluar informacionin spekulativ dhe propagandistik është burimi i dyshimtë i informacionit. Mjafton të bëhet një kërkim i vogël për të parë se nga janë marrë informacionet, nëse ai burim është kredibil, relevant. A është i kualifikuar për të folur për një temë të caktuar dhe në këtë mënyrë dalëngadalë të arrihet deri tek e vërteta. Ekzistojnë dhe një sërë mjetesh që gazetarët tashmë i përdorin në punën e tyre për të zbuluar nëse një pjesë e përmbajtjes është montuar, fabrikuar, redaktuar apo keqpërdorur. Gazetarët profesionistë duhet të ndihmojnë në ekspozimin e dezinformatave dhe përmbajtjeve të fabrikuara.**

Sa i përket ndikimit rus në vend, hulumtimi i Institutit Prespa tregon se nuk ka sentiment të vërtetë prorus në shtet. Bëhet fjalë për përzierje të faktorëve që lën përshtypje për orientim autentik dhe të tërësishëm në mbështetjen e agresionit të Putinit ndaj Ukrainës.

“Mbështetja më e lartë për Rusinë kanë shprehur votuesit e të Majtës. Madje 6,9% prej tyre e njohin Rusinë si mike më të madhe të shtetit. Për votuesit e të Majtës, Ruaja është zgjedhja e dytë për mike më të madhe, menjëherë pas Serbisë e cila është zgjedhja e 68,1 prej tyre. Kjo parti politike ishte e vetmja e cila nuk votoi për rezolutën 22 në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut me të cilën dënohet agresioni rus ndaj Ukrainës”, theksohet në [hulumtim](#).

## **Pse është e rëndësishme Serbia t'i bashkohet sanksioneve kundër Rusisë?**

Në analizën e cila u prezantua sot nga anëtarët e grupit punues, është përfshirë edhe çështja e sanksioneve ndaj Rusisë. Ekspertët kanë ngritur shqetësimin sa i përket pozicionit të Serbisë, i cili është i vetmi shtet në Evropë që nuk i është bashkangjitur sanksioneve ndaj Rusisë. Sipas tyre, ky është fakt shqetësues jo vetëm për Maqedoninë e Veriut, por edhe për rajonin më gjerë dhe në përgjithësi për Evropën. Ekziston mundësia për import të produkteve ruse në Serbi të cilat më pas do të ripaketoreshin dhe do të shiteshin si produkte serbe.

“Bazë shtesë për shqetësim është vëllimi i vazhdueshëm dhe në rritje i fluturimeve mes Serbisë dhe Rusisë. Aleatët, si dhe Bashkimi Evropian duhet t'u kushtojnë vëmendje të rritur shkëlqeve potenciale të regjimit të sanksioneve, si në rajon ashtu edhe më gjerë. Ndikimi rus në Serbi është i ndjeshëm, duke pasur parasysh faktin se Serbia përkrah Kosovës dhe Bosne e Hercegovinës, është shteti i vetëm në rajon i cili nuk është anëtar i NATO-s dhe nuk aspirata të tilla duke pasur para ngjarjet historike. Në atë kontekst, duhet të përmendet “Qendra humanitare serbo-ruse” në Nish, funksionimi i së cilës tashmë kohë më të gjatë është i dyshimtë, si për gazetarët e pavarur, ashtu edhe për strukturat e sigurisë së shteteve të tjera”, theksohet në analizë.

Po ashtu u theksua se, momentalisht institucionet e Maqedonisë së Veriut kanë shprehur vullnet të pranojnë refugjatë nga Ukraina, por mungojnë hapa konkret se si do të realizohej ajo. Sipas informatave të fundit nga Ministria e Jashtme ende bëhen vlerësime për kapacitetet e vendosjes. Maqedonia e





Veriut është zonë tranzit për pjesën më të madhe të refugjatëve që hyjnë në territorin e saj. Momentalisht, supozimi është se refugjatët ukrainas nuk do të vinin drejt Maqedonisë së Veriut.

## A do të ketë luftë bërthamor

Sa i përket mundësisë për luftë bërthamore, ekspertët vlerësojnë se gjasat për këtë janë të vogla, pasi nëse detohet bombë bërthamore në territorin e Ukrainës, varësisht prej madhësisë, pasojat e së njëjtës do të ndiheshin në vendet fqinje – disa prej tyre shtete anëtare të BE-së dhe NATO-s.

**“Një situatë e tillë do të shkaktonte kundërsulm, në këtë rast, katastrofa bërthamore do të kishte pasoja edhe në Maqedoninë e Veriut. Rrezik tjetër bërthamor është dëmtimi, qoftë me qëllim apo jo, i centralit bërthamor, që do të shkaktonte havari bërthamore në territorin e Ukrainës”, theksohet në analizë.**

Më tej shtohet se, këto skenare janë ekstreme dhe bëhen përpjekje që të njëjtat të parandalohen për më shumë arsye. Fillimisht ajo do të shkatërronte edhe më shumë vendet baltike dhe të Evropës Lindore, më pas do të kishin pasoja katastrofale ndaj popullit rus dhe në fund, do ta fusnin Evropën në luftë të tretë botërore.

## Por, çfarë dëshiron Rusia, në krye me Putinin, të arrijë si qëllim përfundimtar?

**Denko Malevski, profesor dhe ministër i jashtëm i parë në Maqedoninë e pavarur, për “Vërtetëmatës”- in thotë:**

**Rusia kundërshton zgjerimin e NATO-s deri tek kufijtë e saj. Ajo është një fuqi e madhe e cila në fund të viteve tetëdhjeta, kur ra muri i Berlinit, u tërhoq nga e gjithë Evropa Lindore, gjegjësisht nga të gjithë shtetet që ishin anëtare të Paktit të Varshavës. Rusia atëkohë vendosi të lirohet nga ato koloni që i kishte marrë gjatë**

Luftës së Dytë Botërore, kur fuqitë ruse e shtynë Hitlerin dhe marshuan deri në Berlin. Shpresa ishte se Rusia do të fillojë të zhvillohet si pjesë e botës, e madje eventualisht edhe si demokraci. Atëkohë u hapën debate se çka do të bëhet me Evropën Lindore, ku do të shkojnë ato shtete, a do të mbesin jashtë bashkimeve apo do t'i bashkangjiten NATO-s. Atëherë kishte një debat të madh për të ardhmen e Evropës Lindore. Kishte persona, të ashtuquajtur realistë amerikanë, të cilët thonin se është më mirë që fuqia amerikane të tërhiqet pas në Amerikë, pasi nuk kishte arsye që të ekzistojë NATO-ja, sepse arsyeja për ekzistimin e NATO-s ishte Pakti i Varshavës. E tani na paraqiten ato me tezat e tyre se nëse do ishte bërë kjo në atë kohë, nuk do të ndodhte kjo që ndodh tani. Mirëpo, fakt është se vendet e Evropës Lindore kërkuan garancion, ishin insistues që të bëhen anëtare të NATO-s. Në fund logjika e fuqisë mbisundoi edhe në Amerikë, e kështu u afrua NATO-ja deri te kufijtë e Rosisë. Rusia, përderisa ishte e dobët ekonomikisht dhe politikisht, nuk kishte mënyrë se si t'i rezistonte kësaj. Mirëpo, që atëkohë Kisinxheri paralajmëroi se kur Rusia të ngrihet në këmbët e veta do të fillojë ta përhapë fuqinë e saj jashtë kufijve. Deri diku kjo edhe ndodhi, Rusia nën Putinin u ngrit, filloi të përparojë si shtet, e rinovoi ushtrinë e saj. Edhe kundërshtarët e tij ia pranojnë se në dhjetë vitet e para të sundimit të tij ka bërë gjëra të vlefshme për shtetin, e ka sjellë në rend, por në mënyrën ruse, si një ish anëtar i KGB-së dhe i rrethuar nga njerëz të tillë. Pas atyre dhjetë viteve Putini u bë diktator dhe tani vendimin për luftë ose paqe e sjell pikërisht ai.







# SKENA MEDIATIKE RUSE: PËRMBAJTJE TË KONTROLLUARA ME PAK HAPËSIRË PËR MEDIAT E HUAJA

Qytetarët në Rusi pranojnë përmbytje të dozuara, në fuqi janë ligje cenzuruese të përforcuara me Ligjin e sapomiruar të 4 marsit, me të cilin parashihet madje edhe dënim me burgim prej 10 deri në 15 vite „për shpërndarje të vetëdijshme të lajmeve të rrejshme për ushtrinë ruse”. Televizionet më të mëdha ruse – „Kanal 1” dhe „Rosia 1” janë të kontrolluara nga shteti, ndërsa televizioni i tretë më i madh NTV, është në pronësi të gjigantit energjetik shtetëror „Gazprom”. Në Federatën Ruse punojnë më shumë se 3.000 radio stacione, ndërsa shteti është themelues i tre rrjeteve më të mëdha „Radio Rosii”, „Majak” dhe „Vesti FM”. Në Rusi botohen mbi 16.000 gazeta të regjistruara, ndërsa vetëm 22 mund të blihen nëpër të gjithë shtetin. Njëjtë si tek televizionet, edhe te gazetatat ato më të njohurat kanë politikë redaktuese proqeveritare.

**Shkruan: Vesna Kollovska**

(Vertetmates, 23.03.2022)

[Videoanketa](#) me qytetarët e qyteteve ruse Perm dhe Vladivostok tregoi se përqindja më e madhe e të anketuarve nuk e dinë dhe nuk besojnë se ushtria ruse ka hyrë në Ukrainë.

„Askush nuk e bombardon Kievin. Unë nuk e besoj këtë“, u përgjigj një nga qytetarët në rrugë, kur u pyet nga një gazetarë, e cila si dëshmi i tregon edhe fotografi nga bombardimet në Ukrainë. Madje një person më i moshuar tha se nuk beson që ka luftë.

**Putini nuk e bën këtë gjë. Ta okupojë Ukrainën?! Përse? Atje jetojnë njerëz tanë – edhe në Ukrainë edhe në Bjellorusi.**





**„Por kjo ka ndodhur”** – i thotë gazetari në video.

**Nuk e di. Këtë nuk e thonë në lajme, u përgjigj personi.**

Kjo video është ilustrimi më i mirë i gjendjes së mediave në Rusi, të kontrolluara fuqishëm nga ana e qeverisë ruse. Qytetarët marrin përmbytje të dozuara, ndërsa në fuqi janë ligje cenzuruese, të përforcuara me [Ligjin](#) e sapomiraturar të 4 marsit, me të cilin parashihet madje edhe dënim me burgim prej 10 deri në 15 vite „për shpërndarje të vetëdijshme të lajmeve të rrejshme për ushtrinë ruse”. Sipas „Reporterëve pa kufij”, televizioni edhe më tej mbetet media të cilës rusët i besojnë më së shumti, ndërsa pikërisht kanalet televizive pjesa më e madhe janë shtetërore ose janë në pronësi të kompanive të afërta me Kremlinin.

### **Media nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Kremlinit**

Televizionet më të mëdha ruse – „Kanal 1” dhe „Rosia 1” janë të kontrolluara nga shteti, ndërsa televizioni i tretë më i madh NTV, është në pronësi të gjigantit energjetik shtetëror „Gazprom”.

Këto janë kanalet vendore dominuese, ndërsa në plan ndërkombëtar, TV kryesor rus Perjanica është televizion satelitor në gjuhën angleze „Russia Today” (RT), i cili është i financuar nga buxheti federal. Është i themeluar në vitin 2005. „Russia Today”, përveç gjuhës angleze, emiton edhe në arabisht, spanjisht dhe frengjisht.

Në Federatën Ruse operojnë më shumë se 3.000 radio stacione. Shteti është themelues i tre rrjeteve më të mëdha „Radio Rosii”, „Majak” dhe „Vesti FM”. Ka numër të madh të radio stacioneve komerciale, të cilat kryesisht janë stacione muzikore.

Në Rusi botohen mbi 16.000 gazeta të regjistruata, ndërsa vetëm 22 mund të blihen nëpër të gjithë shtetin. Njëjtë si tek televizionet, edhe te gazetatat ato më të njohurat kanë politikë redaktuese proqeveritare, ndërsa disa gazeta ditore më me ndikim janë në pronësi të kompanive të lidhura ngushtë me Kremlinin.

## Mediat në Rusi

### TELEVISIONET

- Rossiya 1** - rrjet kombëtar, i menaxhuar nga kompania ruse e radiodifuzionit (VGTRK)
- Kanal 1** - rrjet kombëtar, 51 përqind në pronësi të shtetit, 49 përqind në pronësi të aksionarëve privatë
- NTV** - rrjet kombëtar, në pronësi të gjigantit shtetëror „Gazprom”.
- Centar TV** - në pronësi të administratës komunale të Moskës
- Ren TV** - stacion komercial me seli në Moskë me rrjet të fuqishëm rajonal, në pronësi dominante të Holdingut mediatik NMG
- RT** - Kanal satelitor ndërkombëtar i financuar nga shteti në gjuhën angleze

### RADIO

- Radio Rosii** - rrjet kombëtar i menaxhuar nga kompania radiodifuzive shtetërore (VGTRK)
- Vesti FM** - pronësi shtetërore
- Jehona e Moskës** - pronësi dominante e „Gazpromit” shtetëror
- Majak** - rrjet shtetëror kombëtar
- Ruskoe radio** - rrjet i madh privat, radio muzikore
- Shtypi*
- Komsomolskaja Pravda** - tabloid proqeveritar
- Komersant** - revistë ditore, e orientuar kah biznesi, e kontrolluar nga tajkuni Alisher Usmanov, i afërt me Putinin
- Moskovski Komsomolec** - revistë ditore e njohur në pronësi private
- Izvestija** - revistë ditore e njohur Pro-Kremlinit, në pronësi të Holdingut mediatik NMG
- Rosiskaja Gazeta** - gazetë ditore në pronësi të shtetit
- Nezavisimaja Gazeta** - gazetë ditore me ndikim në pronësi private





**Argumenti i Fakti** - e përjavshme e njohur, në pronësi të Promsvjazbank

**Novaja Gazeta** - botohet tre herë në javë, e njohur për gazetarinë e saj  
investigative

**RBC** - gazetë ditore biznesi

**Vedomosti** - gazetë ditore financiare

### **AGJENSI LAJMESH/ INTERNET**

**TASS** - agjensi shtetërore e lajmeve, me përkthim në gjuhën angleze

**Interfaks** - agjensi private e lajmeve, me përkthim në gjuhën angleze

**Lenta.ru** - burim i njohur i lajmeve online

**Moskva Times** - ueb faqe lajmesh në gjuhën angleze, trashëgimtare e  
gezetës tashmë joegzistuese

**Rambler.ru** - internet portali kryesor

**Sputnik** - platforma multimediale shtetërore për bashkëpunim ndër-  
kombëtar me shërbim në më shumë gjuhë

**Yandex.ru** - kërkuesi më i madh

**Vkontakte** - rrjeti social më i madh

### **Raskomnadzor – dora kryesore cenzuruese e qeverisë**

Rusia në [listën](#) e lirisë së mediave të „Reporterëve pa kufij” në vitin 2021 u gjend në vendin e 150-të nga 180. Kontrolli mbi mediat dhe internetin nga ana e shtetit bëhet nëpërmjet të [Raskomnadzorit](#)-it, trup federal ekzekutiv me detyrë që të sigurojë që mediat t’i ndjekin ligjet ruse dhe të lëshojë paralajmërime në rast të shkeljes së këtyre ligjeve. Roskomnadzor, gjithashtu mund ta kufizojë trafikun e faqes nëpër mediat sociale, që është obligim i tij ligjor. Qeveria ruse në dhjetor të vitit 2020 miratoi një Ligj për rritjen e dënimeve për platformat online dhe providerët e internetit, ndërsa i dha autorizim që të kufizojë ose të bllokojë plotësisht ueb faqe të caktuara.

Ky cenzurues i fuqishëm shtetëror e [tërhoqi lejen](#) e servisit gjerman „Deutsche Welle”, ndërsa këtë media e vendosi në grupin e agjentëve të huaj. Kjo lëvizje ishte si përgjigje ndaj tërheqjes së lejes së „RT-së” për transmetim në Gjermani dhe nëpër platformat e internetit. Bashkimi Evropian i ndaloi „Sputnikun” dhe „RT”-në në tokën evropiane, ndërsa përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe të sigurisë, **Zhozep Borel**, vlerësoi se:

**Ato nuk janë media të pavarura, por armë në sistemin e manipulimit të Kremlinit.**

Si kundërpërgjigje, u zmadhua lista me „agjentë të huaj”, në të cilën ndodhen më shumë se 100 organizata dhe individë të huaj dhe të vendit, e përgatitur nga ana e Ministrisë ruse të drejtësisë. Ligji është prej vitit 2012 dhe atëherë u referohej organizatave joqeveritare që i merrnin mjetet nga jashtë. Mbulimi i tij u zgjerua në vitin 2019 edhe për individë dhe organizata që merrin çfarëdo lloj shume të mjeteve të huaja dhe publikojnë raporte dhe materiale „të shtypura, audio, audio vizuale e të tjera”.

Edhe në vitin 2014 u miratua një Ligj me të cilin kufizohet edhe liria e mediave online. „[Ligji Llugovoj](#)” – i emërtuar pas njërit nga autorët, deputetit të Duma-s shtetërore, **Andrej Llugovoj** – lejon bllokim të faqeve të lajmeve pa urdhër gjyqate, nëse këtë e kërkon prokuroria.

Para fillimit dhe me fillimin e invazionit mbi Ukrainën, më shumë media të huaja, që kishin redaksitë e tyre në Rusi dhe emitonin program në gjuhën ruse, u detyruan të tërhiqen dhe t’i kufizojnë publikimet e tyre.

Shpallja e fundit e serisë së shpalljeve për ndërprerje të punës është ajo e „Radio Europa e lirë”, (REL), e financuar nga Kongresi Amerikan, e cila [njoftoi](#) se e ndërpret punën e saj në Rusi, pasi autoritetet lokale tatimore filluan procedurë falimentimi kundër degës ruse në 4 mars. Kjo vijoi pasi Duma ruse miratoi Ligj me të cilin, çdo gazetar që është në kundërshtim me qëndrimin e Kremlinit për luftën në Ukrainë mund të përballet me dënim më 15 vjet burg.

Shpallja e REL-së është pjesë e serisë për mbyllje ose reduktim të punës së mediave të pavarura. Për vetëm pak ditë shumë media të vendit u mbyllën ose





njoftuan që do të veprojnë në internet, ndërsa disa nga gazetarët vendosën që ta braktisin vendin. Midis tyre edhe redaktori i TV „Dozhd”, **Tihon Xhjadko**, i cili pasi u mbyll televizioni, u largua nga Rusia së bashku me kolegët e tij.

**Pas bllokimit të ueb-faqes së „Dozhd”, publikimeve të „Dozhd” nëpër rrjetet sociale dhe kërcënimeve ndaj disa të punësuarve, u bë evidente se siguria personale e disave prej nesh është e cënuar, shkroi në *Telegram*, redaktori Xhjadko.**

Mbyllja e TV „Dozhd” u bë menjëherë pas hyrjes së fuqi të Ligjit me dënimet e parapara drakonike.

Televizioni gjatë trasmetimit të [edicionit të fundit](#) të lajmeve lëshoi një inçizim të baletit „Liçeni i mjellmave”, të Çajkovskit, si një përkujtim të tentativës për grusht shteti në vitin 1991 kundër qeverisë së liderit të atëhershëm sovjetik **Mihail Gorbaçov**. Gjatë kohës që në terren po realizohej puçi, në televizionin shtetëror vazhdimisht transmetohej baleti, që ishte indikacion për shikuesit se diçka nuk është në rregull. TV „Dozhd” nga gushti i vitit 2021 u vendos në listën e „agjentëve të huaj” së bashku me kanalin e pavarur „Meduza“, me seli në Letoni, shumë i njohur edhe në Rusi. Në regjistrin e agjentëve të huaj ka media, gazetarë dhe aktivistë. Përkrah „Meduza-s” dhe TV „Dozhd”-it, në këtë listë janë edhe publikimet investigative të „iStories” dhe „Insider”, „Radio Europa e Lirë”/„Radio Sloboda” (RSE/RL), veterani aktivist për të drejtat e njeriut **Lev Ponomarev**, bashkëthemelues i organizatës për të drejtat e njeriut „[Memorijal](#)”.

Radio „[Jehona e Moskës](#)” njoftoi se e ka mbyllur radio kanalin dhe ueb faqen, ndërsa gazeta e pavarur ruse „Novaja gazeta”, e njohur për gazetari investigative në krye me nobelistin për paqe redaktorin Dmitrij Muratov, shpalli se do t'i tërheqë artikujt për luftën në Ukrainë, me arsyetim se cenzorët rusë kanë dhënë urdhër që të hiqen ato materiale. Raskomnadzor lëshoi njoftim me të cilin i informon mediat ruse se:

**Janë të detyruar t'i përdorin vetëm informatat dhe të dhënat që i kanë marrë nga burimet zyrtare ruse.**

Në njoftim gjithashtu paralajmërohet se media të paemëtuara shpërndajnë „*informata të pakontrolluara dhe jo të besueshme*“.

„BBC“ servisi i të cilit gjithashtu është i kufizuar nga ana e qeverisë ruse, lajmëroi se pa marrë parasysh gjithçka, do të qëndrojë në terren dhe do të informojë për ngjarjet.

**Qasja deri te informatat e sakta, të pavarura është e drejtë themelore e njeriut nga e cila nuk duhet të privohet populli në Rusi, prej të cilëve miliona mbështeten tek lajmet e „BBC“-së çdo javë, shënoi shërbimi press i „BBC“-së, pak kohë pasi autoritetet ruse e kufizuan qasjen deri te ueb faqja e tyre.**

Kufizimi, siç thotë shërbimi britanik, është kontraproduktiv. Vizitat javore të ueb faqes së BBC-së në gjuhën ruse, siç njofton kompania, janë rritur për më shumë se tre fish në 10,7 milionë. Trafiku nga Rusia deri te faqja e BBC-së në gjuhën angleze është rritur për 252 përqind.

**Për atë se a ka regjimi i Putinit mbështetje mes qytetarëve të thjeshtë, duke e pasur parasysh faktin se ma kontrolluara dhe në doza, Andrej Zaharov, nga servisi rus i BBC-së, një intervistë për “Vërtetëmatës”- in thotë:**

**Shumë njerëz me të vërtetë e mbështesin luftën, dhe nuk është vetëm propaganda ajo që e përgatiti popullin për këtë luftë për 8 vjet, nga aksioni në Krime. Edhe pse propaganda e përgatiti vërtet popullin, duke thënë se lufta është e mirë dhe se Ukraina është një vend i rremë, në të njëjtën kohë në vendet postimperialiste si Rusia, nëse propaganda juaj thotë se lufta është e mirë, ju shkaktoni ndjenja negative tek njerëzit. Nuk mund të themi se kjo është vetëm lufta e Putinit. Edhe pse jam i sigurt se po të kishim një**





president tjetër që nuk do të vepronte për të përgatitur popullin për këtë luftë, nuk do të kishim kaq shumë mbështetje. Njerëzit e mbështesin atë.

Ka situata kur të afërmit nga Ukraina u dërgojnë video dhe foto të afërmeve të tyre në Rusi dhe të afërmit thonë: “është e rreme”. Në një moment ata injorojnë realitetin dhe nëse ju e injoroni realitetin, është sikur ai të mos ekzistonte. Disa njerëz po përpiqen të protestojnë, por siç thashë më parë, është shumë e rrezikshme në Rusi, kështu që shumë njerëz janë larguar nga Rusia dhe disa janë arrestuar. Disa burime thonë se 300,000 njerëz kanë ikur nga Rusia që nga fillimi i luftës, edhe atë jo vetëm gazetarë. Nuk e di nëse këto shifra janë reale, por e di që shumë njerëz janë shpërngulur. Ata thjesht nuk duan të jetojnë në një vend që ka filluar një luftë me fqinjën e tij.

Por njerëzit më vonë do të ndjejnë efektet e luftës. Për gjysmë viti apo një vit. Unë mendoj se njerëzit do të ndryshojnë mendje për këtë luftë, hap pas hapi, kur të jemi dëshmitarë të krizave ekonomike. Por ky proces nuk mund të ndodhë shpejt. Nëse njerëzit e kuptojnë dhe pranojnë se kjo luftë është një krim, do të shkatërrojë të gjithë pamjen në mendjen e tyre, nga pikëpamja psikologjike. Është një proces i gjatë dhe nuk mund të presim që të ndodhë nesër.

## Prezenca mediatike ruse në Maqedoni

Në Maqedoninë e Veriut nuk ka media të regjistruara ruse dhe shërbime të tyre, që emitojnë programin e tyre në gjuhën maqedonase. Ndikimi mediatik rus vjen nga edicioni serb i „[Sputnik-ut](#)“, e cila është platformë multimediale shtetërore për bashkëpunim ndërkombëtar me shërbim në më shumë gjuhë, përfshirë këtu edhe gjuhën serbe. Një pjesë e mediave



maqedonase, e posaçërisht disa nga shfrytëzuesit e rrjeteve sociale herë pas here transmetojnë përmbajtje nga „Sputniku” serb. Prezente është edhe ueb platforma „Russia Beyond”, e cila është një edicion i ribrenduar i „Ruska Reç”, i cili publikohet në 14 gjuhë, ndër të cilat edhe në gjuhën maqedonase. Sipas sqarimit, kjo platformë është krijuar për shpërndarjen e kulturës ruse. Gjatë shfletimit të përmbajtjeve, thuajse çdo i dyti apo i treti artikull ka të bëjë me presidentin rus **Vlladimir Putin**, personazhin dhe veprën e tij, dhe ka përmbajtje edhe të qyteteve ruse dhe arritjeve ruse.


Vite me rradhë në tregun e Maqedonisë nëpërmjet shtëpisë së botimit „[Color Media press](#)“ botohen dy rrjete revistash, që kanë prejardhje nga Serbia. Botimet më të njohura janë „Ruski Doktor” dhe „Ruski Travar” të shtëpisë së botimeve „Novosti”, që shpërndahen edhe nëpërmjet eksportit direkt në Bosnje dhe Mal të zi dhe/ose nëpërmjet të botimeve të lokalizuara në Maqedoninë e Veriut, Kroaci dhe Slloveni në gjuhët lokale.

Agjencia e lajmeve „Meta” para dy vitesh publikoi një [analizë](#) në të cilën vlerësoi se „*këto revista vazhdojnë t’i eksploatojnë komercialisht perceptimet pozitive për Rusinë dhe kulturën e saj, të cilët prej më parë ishin prezente tek një pjesë e popullatës së ballkanit, me çka në mënyrë plotësuese kontribuojnë që të forcohen pozitat propaganduese të regjimit të Putinit.*”

Për shembull, në numrin e fundit të janarit të botimit maqedonas së „Ruski Doktor”, përmbajtje goditëse në kopertinë është shkrimi „ekskluziv” për „10 sekretet e Putinit për shëndet” me të cilin si „sekrete” paraqiten ushqimi i rregullt, gjimnastika e mëngjesit, por edhe marrja me sporte si skijimi, hokeji, kalërimi dhe peshkimi, të cilat kryesisht janë jashtë mundësive financiare të publikut (pensionist) që targetohet, shkruan në [tekstin](#) e „Meta-s” të publikuar në janar të vitit 2020.

Në [listën e gazetave dhe revistave të regjistruara](#) të ASHAV-it (të azhurnuar më 21.02.2022), „Kolor Media plus” është e regjistruar si botues i „Dobra hrana” dhe „Ruski doktor”.





# ROLI I PARTIVE SHQIPTARE NË RMV NË KONTEKSTIN E LUFTIMIT TË NDIKIMIT RUS

Në vitin 2001 në Maqedoninë e Veriut u nënshkruan dy marrëveshje shumë të rëndësishme për ecurinë e vendit. Marrëveshja e parë (Marrëveshja e Ohrit) e shpëtoi vendin nga një katastrofë e mundshme dhe garantoi një shtet multietnik dhe demokratik sipas parimeve të BE-së. Marrëveshja e dytë (Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim), i dha shtetit kahjen Euro-Atlantike, kështu duke minimizuar mundësitë e ndikimit anti-demokratik në vend. Partitë politike shqiptare në RMV kanë qenë drejtpërdrejtë të kyçura në procesin e nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve dhe janë shprehur qartë për anëtarësimin e vendit në BE dhe NATO. Kështu, këta të fundit përkrahën edhe “revolucionin shumëngjyrësh” që rrëzoi një qeveri të afërt me Rusinë dhe Putin, shkruan [Portalb.mk](#).

Shkruan: Ardit Ramadani

(Portalb, 07.04.2022)

[Marrëveshja e Ohrit](#) dhe [Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim](#), shteti mori kahjen euro-atlantike

Formësimi i rrugës euro-atlantike të Maqedonisë së Veriut ndodhi kryesisht pas [konfliktit të armatosur të vitit 2001](#) ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK-së) dhe Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë (ARM-së) e cila zgjati rreth 8 muaj dhe u ndalua me Marrëveshjen e Ohrit. Në atë kohë, qeveria e Ukrainës e cila ishte me orientim pro-rus vendosi që t'i ndihmojë ushtrisë maqedonase duke i shitur armatim. Megjithatë, populli i Ukrainës në vitin 2014 mori pushtetin në duart e veta, kështu duke rrëzuar qeverinë





e [Viktor Janukoviçit](#), për shkak se ky i fundit u mohoi atyre të drejtën për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian.

Duke ditur këtë fakt, partia politike shqiptare e cila doli nga lufta e vitit 2001, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) sot nuk fajëson Ukrainën për avionët dhe helikopterët që i kishin shitur kundërluftëtarëve të tyre, gjegjësisht, ARM-së, por përkundrazi kjo parti ka [dënuar](#) agresionin rus dhe ka shprehur mbështetje të plotë për Republikën e Ukrainës dhe popullin ukrainez.

“Të gjithë jemi të interesuar që të gjendet zgjidhje sa më e shpejtë dhe të mbyllet ky rast kaq i dhimbshëm në Ukrainë, të gjendet zgjidhje deri tek armëpushimi dhe t’i hapet rrugë dialogut, vendosjes së paqes dhe të lihen të lirë ukrainasit, të vetëvendosin për fatet e veta, do të thoja që presidenti Putin dhe Rusia duhet të ndejnë përgjegjësinë se si superfuqi kanë invaduar një komb, po shkelin mbi vullnetin e një populli dhe kjo duhet ti turpërojë dhe sa më parë që të tërhiqen, aq më mirë do të jetë si për Rusinë ashtu edhe për Evropën. Mendoj që populli rus ka përgjegjësi kolektive që mos të lejojë këtë luftë të pamëshirshme që zhvillohet në Ukrainë”, ka deklaruar [Ali Ahmeti, kryetar i Bashkimit Demokratik për Integrim dhe përfaqësues politik i UÇK-së gjatë luftës në vitin 2001.](#)

“Në këto kohë të vështira ne jemi me Ukrainën”, ka deklaruar [shefi i diplomacisë së Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, i cili vjen nga Bashkimi Demokratik për Integrim.](#)

Një ndër dokumentet më të rëndësishme me anë të së cilës u arrit ndërprerja e konfliktit të vitit 2001 ishte [Marrëveshja e Ohrit](#). Me këtë marrëveshje, përveç ndërprerjes së konfliktit, vendosi Kushtetutën e RMV-së në një bazë të re, në të cilën sigurohej një përfaqësim më i barabartë në fusha të caktuara politike dhe institucionale mes dy etnive më të mëdha në vend, gjegjësisht, asaj maqedone dhe shqiptare.

Ky [dokument](#), që afroi Maqedoninë e Veriut disa hapa më afër **Bashkimit Evropian** dhe anëtarësimit në **NATO**, duke minimizuar mundësinë e ndikimit të forcave jo-progresive në vend u nënshkrua nga presidenti i atëhershëm i shtetit, Boris Trajkovski, kryeministri i atëhershëm dhe kryetar i VMRO-DPMNE-së, Lubço Georgievski, kryetari i LSDM-së, Branko Cërvenkovski, kryetari i PDSH-së, Arben Xhaferi dhe kryetari i PPD-së, Imer Imeri. Si dhe në cilësinë e garantuesve, dokumentin e nënshkruan edhe përfaqësuesi i posaçëm i BE-së, Fransoa Leotar dhe përfaqësuesi i posaçëm i ShBA-së, Xhejms Perdju.

Në zgjidhjen e krizës u involvua edhe Piter Feit, përfaqësues special i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, i cili i koordinonte të gjitha aktivitetet mes forcave të sigurisë së Republikës të Maqedonisë dhe UÇK-së, edhe atë drejtpërdrejt me ndërmjetësim.

Pra, marrë parasysh se garantues të marrëveshjes ishin palet **BE** dhe **ShBA**, si dhe në këtë marrëveshje janë përfshirë shumë parime të Bashkimit Evropian, kjo marrëveshje paraqet hapin më të rëndësishëm drejt avancimit të rrugës së Maqedonisë së Veriut drejt integritimit Evropian dhe anëtarësimit të vendit në NATO.

Prej partive politike shqiptare, nënshkruese të Marrëveshjes së Ohrit kanë qenë Arben Xhaferi, si kryetar i PDSH-së së atëhershme dhe Imer Imeri, si kryetar i PPD-së. Megjithatë, **të gjitha partitë politike shqiptare, përfshirë edhe partitë aktuale në skenën politike, mbështesin këtë marrëveshje por kanë ide të ndryshme sa i përket realizueshmërsë së saj.**

**Tendencat jo-progresive u minimizuan me nënshkrimin dhe fillimin e implementimit të [Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim](#)**

Edhe pse negociohej më herët, [Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim \(MSA\)](#), mes RMV-së dhe Bashkimit Evropian u nënshkrua në të njëjtin vit me atë të Marrëveshjes së Ohrit. Kjo marrëveshje rradhiti Republikën e Maqedonisë në rendin e shteteve me perspektivë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ndërsa në planin ekonomik, me nënshkrimin e marrëveshjes u





hapën dyert e njërit ndër tregjet më të mëdha dhe më të fuqishme financiare të botës.

Plotësimi i pikave të kësaj marrëveshje afronte vendin çdo ditë më afër Bashkimit Evropian dhe NATO, disa prej tyre janë si vijon:

- Afrimit të rajonit drejt integritimit më të afërt dhe të plotë në strukturat e Bashkimit Evropian,
- Mbështetjes së konsolidimit të shpejtë demokratik, sundimit të së drejtës, zhvillimit ekonomik dhe reformatstrukturore, strukturat adekuate administrative dhe bashkëpunimit rajonal,
- Krijimit të kornizës së formalizuar të dialogut politik, në nivel bilateral dhe rajonal.
- Promovimit të marrëdhënieve ekonomike, tregtisë, investimeve, politikës së sipërmarrjeve, transportit dhe zhvillimit, bashkëpunimit në sferën e doganës, me perspektiva për integrim më të afërt në sistemin tregtar botëror, përfshirë edhe mundësinë për krijim të zonës së lirë tregtare, pasi të arrihet progres në reformat ekonomike.

Ndërkaq, të gjitha partitë politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut **kanë shprehur përkrahjen e tyre** për këtë marrëveshje si dhe për të gjitha marrëveshjet tjera që afrojnë vendin me Bashkimin Evropian.

Sot që flasim, për shkak të marrëveshjes së lartpërmendur që rezultoi në rritjen e bashkëpunimit ekonomik të Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Evropian, në anketën e fundit të [Institutit Internacional Republikan \(IRI\)](#) pjesa më e madhe e qytetarëve (35%) besojnë se donatori më i madh në RMV është Bashkimi Evropian ndërkaq vetëm (3%) besojnë se është Rusia.

Ndryshe, 47% e të [anketuarve](#) i shohin **Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA)** si partnerët më të rëndësishëm ekonomik të RMV-së kurse 32% vlerësojnë se **Rusia** është pareteti më i rëndësishëm ekonomik.


Për të lexuar studimin e plotë, klikoni [KËTU](#).

Të gjitha partitë politike shqiptare janë shprehur pro kësaj marrëveshje dhe janë të përcaktuara për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian. Ky përcaktim shihet qartë në [statutin e partisë Aleanca për Shqiptarët](#), këtu mund të shihni [qëndrimin e Partisë Demokratike](#)

[Shqiptare](#), qartë është përcaktuar edhe në [statutin e Bashkimit Demokratik për Integrim](#) dhe të [Partisë Alternativa](#), gjithashtu edhe [Lëvizja BESA](#) është [shprehur](#) pro anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe përqafimit të vlerave evropiane.

Revolucioni [shumëngjyrësh](#), qeverisë pro-ruse i afrohej fundi, viti 2015

Protesta që filloi pas [vrasjes së Martin Neskovskit](#) në natën e zgjedhjeve në vitin 2011, më vonë u shndërrua në një lëvizje me emrin [#Protestoj](#), nga mesi i prillit 2016, u zhvillua në të ashtuquajturën “Revolucioni Shumëngjyrësh” në Maqedoni. Protestuesit kërkonin që të ik qeveria Gruevski-Ahmeti.



*Protestat paqësore të Revolucionit Laraman, prill 2016 Shkup Foto: Vanço Xhambasski CC BY-SA*

Kërkesat për drejtësi ishin vetëm një pjesë e protestave që u bënë masive më 12 prill 2016 pasi presidenti i atëhershëm i Maqedonisë [Gjorge Ivanov](#) [shpalli abolicion për 56 persona](#) të dyshuar se ishin të përfshirë në skandalin e përgjimeve.

Disa mijëra njerëz dolën në rrugët e Shkupit po atë natë, duke e shpërthyer kordonin policor dhe duke i vënë zjarrin zyrës së Ivanovit në qendër të qytetit.





Protestat vazhduan edhe në muajt në vijim me ritëm dhe masë të shtuar. Më 15 prill, për herë të parë u hodh ngjyrë në fasadën e Porta Maqedonia- që më vonë u bë simbol i njohur dallues i protestave.

## Rusisë i konvenonte që të vazhdojë qeverisja Gruevski-Ahmeti

“[Rusia e Bashkuar](#)”, partia e presidentit rus, Vladimir Putin, kishte reaguar atëherë kundër revolucionit shumëngjyrësh në RMV dhe të tjerave në balkan. Sipas informacioneve nga mediet rajonale, „Rusia e Bashkuar” kishte bërë [thirrje](#) partnerëve politik në balkan që të luftojnë kundër revolucionit shumëngjyrësh në Maqedoninë e Veriut si dhe revolucioneve tjera laramane në territorin e ish-jugosllavisë.

## Sa afrohej fundi i qeverisë Gruevski-Ahmeti, aq më shumë i shtohej sikleti Rusisë

“Si pjesë e rajonit të Ballkanit, Maqedonia e Veriut është në fushën e interesit të Rusisë, sepse rajoni kufizohet me BE-në, diçka që Moskë dëshiron ta mbajë nën kontroll ose të paktën të ketë ndikim”, thuhet në raportin e [Fondacionit „Rusia e Lirë”](#) me seli në ShBA.

Në këtë [raport](#) thuhet se Rusia përdori dhe përdor mjete të ndryshme për të ndikuar në punët e brendshme të Maqedonisë së Veriut.

“Megjithatë, jo të gjitha përpjekjet për të ndikuar në politikën dhe ekonominë maqedonase kanë dhënë rezultatet e dëshiruara. “Në njërin anë, Rusia arriti të krijojë marrëdhënie të ngushta me elitën politike maqedonase në kohën e Gruevskit, por nga ana tjetër, nuk arriti të kundërshtojë opozitën, gjë që solli ndryshime rrënjësore në qeveri dhe humbje të lidhjeve politike me politikanët në pushtet. “ në [raport](#).”

Rusia ka bërë përpjekje të konsiderueshme për ta mbajtur Maqedoninë e Veriut jashtë NATO-s, duke arritur të zvogëlojë pjesëmarrjen në referendumin për ndryshimin e emrit.



Ministria e Jashtme e Rusisë kishte pasur [reagim të ashpër](#) pas zgjedhjeve të dhjetorit në vitin 2016, ku partia e Gruevskit edhe pse fitoi zgjedhjet, nuk arriti të krijojë shumicën në parlament. Në reagimin e MPJ të Rusisë, ata kishin shprehur përkrahje jo vetëm për Gruevskin, por edhe për kryetarin e Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmetin.

**“Duket se në forcat politike në Maqedoni po ushtrohet një ndikim i madh i jashtëm me slogane pseudodemokratike. “Qëllimi është i qartë – të merremi me politikanët maqedonas të cilët janë të padëshirueshëm nga perëndimi dhe të rikompozojmë autoritetet atyre, pavarësisht mbështetjes së qartë të votuesve për koalicionin “Për një Maqedoni më të mirë”, të udhëhequr nga Nikola Gruevski dhe Bashkimi Demokratik për Integrim. të udhëhequr nga Ali Ahmeti.” Kishte deklaruar [Ministria e Jashtme ruse më 11 shkurt të vitit 2017.](#)”**

**Përkundër kësaj, të gjitha partitë politike shqiptare mbështeten revolucionin shumëngjyrësh**

[Aleanca për Shqiptarët \(atëherë LR-PDSh\), RDK-ja dhe Lëvizja BESA](#) kishin shprehur përkrahjen e tyre për revolucionin shumëngjyrësh, ata ju bënë thirrje aktivistëve të tyre që të dalin dhe të protestojnë.

**“Për këto arsye, si dhe duke pasur parasysh se ky regjim është dëshmuar edhe si regjimi më antishqiptar, anti-NATO dhe anti-BE dhe i cili e ka kapur keq edhe vullnetin politik të shqiptarëve – duke i kapur partitë shqiptare në pushtet, Lëvizja BESA i mbështet këto protesta, sepse ato janë mënyra e fundit e shpëtimit të këtij vendi dhe e kthimit të demokracisë.” [kishte deklaruar Lëvizja BESA.](#)”**





**“Ftojme publikisht të gjithë shqiptarët që vetes nuk i thonë robër, por i thonë të lirë, organizata joqeveritare të shqiptarëve, intelektualë të pavarur, parti politike dhe të gjithë qytetarët që duan liri, drejtësi, dinjitet, progres, që synojnë perspektivën dhe lumturinë, t’i bashkangjiten kësaj proteste gjithëpopullore për ti thënë ndal këtij sistemi” kishin deklaruar nga [LR-PDSH, RDK dhe disa organizata joqeveritare](#).**

Edhe pse pjesë e një qeverie që i konvenonte rorisë, BDI-ja [deklarativisht](#) kërkonte nga LSDM-ja dhe VMRO-ja të gjejnë një zgjidhje për dalje nga kriza, në përputhje me “kërkesat e Brukselit dhe Uashingtonit”.

Ndryshe, përveç partive politike shqiptare, edhe ata maqedonase të cilat ishin në opozitë mbështesnin revolucionin shumëngjyrësh dhe ishin pjesë aktive në organizimin e protestave. Në atë kohë, njerëz të afërm mer ruginë tentonin në mënyra të ndryshme që të ruhet status-quo-ja dhe të mos ketë ndryshime të pushtetit në Maqedoni.

## **Tentativa „e fundit” e Rorisë për të mbajtur Gruevskin në pushtet, 27 prilli, 2017**

Një ndër ditët më të zeza për demokracinë e Maqedonisë së Veriut ka qenë më [27 prill të vitit 2017](#), ku një grup i madh i protestuesve të orkestruar nga kryetari i partisë VMRO-DPMNE, Nikola Gruevski dhe forca të jashtme (kryesisht ruse), arritën të futen në shtëpinë ligjvënese ku përgjakën shumë deputet dhe punonjës të mediave.

Më vonë, u zbulua se [Rusia ka pasur gisht në orkestrimin e kësaj ngjarje](#) përmes diplomatëve serb, gjegjësisht, bëhet fjalë për Goran Zivaljeviq, agent i agjencisë serbe të intelligence, i cili në atë kohë ishte në Shkup si diplomat dhe këshilltar i Ambasadës Serbe që nga viti 2015. Zhivaleviq ishte ndjekur një kohë të gjatë nga UVK-ja, e cila kishte konstatuar se ky i fundit kishte komunikim të rregullt me deputetin e kuvendit të RMV-së, Ivan

Stoilkoviq i cili ishte serb si dhe me gazetarin serb, Miroslav Lazanski. Këta tre, ishin bashkuar që të përhapin propagandë në mediat me qëllim që të provokohet destabiliteti politik në Maqedoni.

Sipas gazetës britanike “The Guardian”, këta tre vepronin nën udhëzimet e shërbimeve sekrete ruse dhe kishin vetëm një detyrë – **të pengonin Maqedoninë nga anëtarësimi në NATO.**

Pas ngjarjeve të përgjakshme në kuvend, Ministria e Punëve të Jashtme ruse kishte shprehur **mbështetje** për Gruevskin dhe protestuesit që mësynë në Kuvend, duke thënë se LSDM, duke shkelur rëndë procedurat, ka dashur të zgjedh kryetar të Kuvendit. Sipas Ministrisë së Jashtme ruse, protestuesit me të drejtë kundërshtuan këtë.

Megjithatë, me shumicë votash dhe me përkrahjen e **të gjitha partive politike shqiptare në vend** si dhe në gjendje jo të zakonshme, **Talat Xhaferi atë ditë arriti që të zgjedhet kryeparlamentari** i parë shqiptar në historinë e Maqedonisë së Veriut ndërsa sulmin në kuvend e dënuan të gjitha partitë politike, madje edhe VMRO-DPMNE, edhe pse ishte nxitëse e saj.

## **Marrëveshja e Prespës dhe anëtarësimi i RMV-së në NATO**

Një ndër arsyet që mbante “peng” Maqedoninë e Veriut nga anëtarësimi në NATO ishte kontesti në lidhje me emrin, që kishte vendi ynë me shtetin fqinj, Republikën e Greqisë. Më 17 qershor të vitit 2018, Maqedonia e Veriut dhe Greqia **nënshkruan marrëveshje** për zgjidhjen e këtij kontesti.

**Dokumenti** parashihte emrin aktual të vendit, gjegjësisht, “Maqedonia e Veriut” dhe u nënshkrua në Prespë, në pjesën e Greqisë nga Ministrat e Punëve të Jashtme, Nikola Dimitrov dhe Nikos Kotzias, në prani të kryeministrave të atëhershëm, Zoran Zaev dhe Aleksis Tsipras.

### **ShBA-të përshëndetën këtë marrëveshje**

Shtetet e Bashkuara **përshëndetën** vendimin e Kuvendit të Maqedonisë për të inicuar ndryshimet kushtetuese të nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës me Greqinë, kishte deklaruar zëdhënësja e Departamentit të Shtetit, Heather Nuert.





Në deklaratë thuhet se Shtetet e Bashkuara besojnë se kjo marrëveshje është një mundësi historike për të promovuar stabilitetin, sigurinë dhe përparimin në rajon.

## **Për shkak se kjo marrëveshje afronte RMV-në me NATO-n, Ruisë nuk i pëlqeu**

Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes reagan nga Ministria e Jashtme Ruse, nga kjo ministri [theksuan](#) se marrëveshja e lartpërmendur është miratuar kundër vullnetit të dy popujve, maqedonasve dhe grekëve, dhe se e njëjta është imponuar nga ana e Bashkimit Evropian dhe ShBA-ve.

Ministri i jashtëm i RMV-së së bashku me homologun e tij nga Greqia i [bënë thirrje](#) federatës Ruse që të mos përzihet në punët e brendshme të dy shteteve.

**“Ministria e Punëve të Jashtme me keqardhje konstaton se Departamenti për informim në Ministrinë e Jashtme të Federatës Ruse, përsëri, në kontest negativ, apostrofon procese autentike politike mes dy shteteve, të cilat shkojnë drejt zgjidhjes së problemeve, përforcimin e besimit dhe ndërtimin e miqësisë”, - thuhet në [njoftimin e Ministrisë së Jashtme të Maqedonisë](#).**

**“Ne shprehim bindjen se Rusia, e cila për vite me radhë e ka njohur IRJM-në si “Republika e Maqedonisë”, do të respektojë sensibilitetin e popullit grek në përdorimin e emrit Maqedoni dhe do t’i referohet tani këtij vendi me emrin e ri kushtetues, Maqedonia e Veriut, dhe më e rëndësishmja është që të përmbahen nga qëndrimet e tilla, sepse një gjë e tillë përbën ndërhyrje në punët e brendshme të Greqisë”, - thuhet në [njoftimin e Ministrisë së Jashtme të Greqisë](#).**

Megjithatë, kishim parti politike në vendin tonë që ishin **në një vijë me qëndrimin e Rusisë**, edhe atë:

- **VMRO-DPMNE**

**Gjorge Ivanov**, ish-presidenti i Maqedonisë së Veriut ishte një kundërshtarët më të fortë të marrëveshjes së Prespës. Ai shprehej se zbatimi i saj do te sjellë pasoja negative. Sipas tij ndryshimi i emrit është vetëm në interes të Greqisë. Ivanov e bojkotoi referendumin e 30 shtatorit, si dhe mbante peng ligjin për gjuhën shqipe.

**Hristijan Mickoski**, kreu i këtij subjekti politik, disa herë është shprehur, sidomos gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e fundit parlamentare se me ardhjen e tyre në pushtet do ta shfuqizojë **Marrëveshjen e Prespës**.

**“Me shumicë prej dy të tretave në Kuvend, do ta shfuqizojmë marrëveshjen e Prespës”, tha Mickoski gjatë një paraqitjeje televizive në dhjetor të vitit 2019. Deklarata të ngjashme ai ka dhënë disa herë, të cilat shpesh çonin në përplasje të vazhdueshme me partinë në pushtet, LSDM-në. Vlen të theksohet se retorika e Mickovskit në lidhje me këtë temë tanimë është zbutur.**

- **E Majta (Levica)**

Nëse VMRO-DPMNE-ja mund të jetë më fleksibël në këtë çështje, E Majta e cila përfaqësohet me dy deputetë në Parlament, është decide se Marrëveshja e Prespës dhe ajo e Ohrit duhen zhbërë. Kjo parti, në krye me **Dimitar Apasievin** madje në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, në programin e saj sa i përket fushës së politikës së jashtme, përpos synimeve për anulim të Marrëveshjes së Prespës, asaj të Ohrit dhe rishqyrtim të Marrëveshjes me Bullgarinë një nga qëllimet kryesore në fushën e raporteve bilaterale, ishte edhe tërheqja e njohjes së Kosovës, Izraelit dhe Koresë së Jugut. Në planin e raporteve multilaterale, kjo parti synonte për dalje urgjente të vendit nga NATO dhe tërheqje të pakushtëzuar të të gjitha forcave të sigurisë nga mis-





ionet e huaja ushtarake të cilat nuk kanë mandat nga OKB.

Ndryshe, kishte edhe parti më të vogla maqedonase të cilat ishin zëshëm kundër Marrëveshjes së Prespës, por shumica e tyre nuk kishin forcë politike apo ndikim në mënyrë që të ndryshonin realitetin.

Rikujtojmë se presidenti amerikan Joe Biden pati **urdhër ekzekutiv** për ngrirjen e pasurive dhe ndalimin e hyrjes në ShBA ku përfshiu edhe ata që punojnë kundër Marrëveshjes së Prespës dhe asaj Kornizë të Ohrit, është mesazh i qartë, se marrëveshjet ndërkombëtare do të vazhdojnë të mbeten pikat ku administrata amerikane nuk do të bëjë kompromis dhe do t'i luftojë të gjitha aktorët që i kundërshtojnë. Pa to, vendi do të ishte zhytur drejt katastrofës, vlerësuan ekspertët në Maqedoninë e Veriut .

## **Partitë shqiptare të gjitha përkrahën marrëveshjen**

Të gjitha partitë politike shqiptare të cilat kishin përfaqësues në shtëpinë ligjvënëse, gjegjësisht, Aleanca për Shqiptarët (ASh), Lëvizja BESA, Alternativa, Bashkimi Demokratik për Integrim dhe Partia Demokratike Shqiptare, përkrahën deklarativisht dhe me votë këtë marrëveshje.

Pa përjashtim, partitë e lartpërmendura shqiptare janë shprehur se një ndër arsyet pse kanë votuar Marrëveshjen e Prespës ka qenë hapja e rrugës së vendit për anëtarësim në NATO dhe Bashkimin Evropian.

- Marrëveshjen e plotë mund ta lexoni: **KËTU**
- Për arritjen e Marrëveshjes kryeministrat **Zaevdhe Cipras u nominuan për Çmim Nobel për paqe.**

## **Asnjë skenar rus nuk rezultoi i suksesshëm, Maqedonia e Veriut u anëtarësua në NATO**

Në Selinë e NATO-s në Bruksel më 6 shkurt të vitit 2019 është **nënshkruar Protokollin për anëtarësim të Maqedonisë në NATO** me të cilin filloi faza e fundit e procesit të anëtarësimit të plotfuqishëm. Në prani të ministrit të Punëve të Jashtme të Maqedonisë, Nikolla Dimitrov dhe sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, përfaqësuesit e vendeve anëtare një nga një e nënshkruan protokollin.

Ministri Nikolla Dimitrov mbajti fjalim para përfaqësuesve të vendeve anëtare dhe sekretarit Jens Stoltenberg, ku theksoi se vendi është i përgatitur të ndërmerë përgjegjësitë që vijnë me anëtarësimin e plotë në Aleancë.

**“Ky ishte rrugëtim i gjatë. Maqedonia së shpejti do të jetë Republika e Maqedonisë së Veriut, kjo është çështje ditësh. Kemi dëshmuar se mund t’i zgjidhim problemet me të cilat jemi përballë. Kjo do të jep porosi në rajon ku ende ka pasiguri. Ne jemi të përgatitur, ne jemi këtu, do t’i ndërmarrim përgjegjësitë që vijnë nga anëtarësimi në NATO. Shpresoj për zbatim efikas të ratifikimit”, tha Dimitrov.**

**Putin nuk ishte i lumtur për këtë, tha se është hap i kryer në trysni**

**“Kur bëhet fjalë për Ballkanin, atëherë mund të thuhet se faktori kryesor serioz për destabilizim është politika e SHBA-së dhe disa vendeve perëndimore, qëllimi të cilëve është që ta përforcojnë dominimin e tyre në rajon”, kishte deklaruar presidenti i Rusisë, Vladimir Putin në një intervistë për “Politka” dhe “Veçerni Novosti”**

Putin kishte **shtuar** se një vit më herët, sipas tij, për shkak të përsheptimit të procesit të anëtarësimin të Maqedonisë në NATO, është bërë që t’i ndërrohet emri Maqedonisë dhe t’i bëhet revizion Kushtetutës së Maqedonisë, duke e injoruar popullin maqedonas, i cili në referendumin për ndryshimin e emrit, sipas tij, është deklaruar kundër, që nuk është e vërtetë.

Kryetari i VMRO DPMNE-së me **deklarata kontroverse**, vazhdoi të kundërshtojë marrëveshjen që solli deri në anëtarësimin e vendit në NATO, por thotë se mbështet anëtarësimin në aleancë

I pyetur nëse e përkrah anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, Mickoski **tha** “absolutisht po” dhe se nuk mund të jetë kundër, sepse reformat më





të mëdha për anëtarësim në NATO i kanë bërë qeveritë e VMRO-DPMNE-së. Megjithatë, tha se është kundër Marrëveshjes me Greqinë, të cilën e nënshkroi qeveria e Zoran Zaev dhe e cila ndryshoi emrin e vendit, shtoi se kishte vërejtje të mëdha për miratimin e asaj marrëveshjeje dhe nuk e mbështeti atë.

## “E majta” ishte kundër hyrjes në NATO

**“Qëllimi i NATO-s është një dhe i vetëm: shtrirja e dominimit ekonomic dhe shtrirja e doktrinës neoliberale, përkritazi me ruajtjen e statusit të SHBA-ve dhe aleatëve të saj si hegjemoni imperialiste në botë” deklaruan nga kjo parti.**

Rikujtojmë se “E Majta” [vazhdon](#) të kërkojë që Maqedonia e Veriut të dalë nga NATO dhe të ndryshojë partnerët e saj strategjik. Përveç partisë “E Majta”, edhe partia pro-ruse jashtëparlamentare e Janko Bançev me emrin “Maqedonia e Bashkuar” ishte kundër anëtarësimit të vendit në NATO.

Të gjitha partitë politike shqiptare **ishin për anëtarësimin e vendit në NATO** dhe përshëndetën këtë vendim, klikoni [KËTU](#) për të parë deklaratën e Aleancës për Shqiptarët në lidhje me këtë, klikoni [KËTU](#) për të parë deklaratën e Bashkimit Demokratik për Integrim, [KËTU](#) për të parë deklaratën e Lëvizjes BESA, [KËTU](#) për të parë deklaratë e Alternativës dhe [KËTU](#) për të parë deklaratën e Partisë Demokratike Shqiptare.

Ndryshe, edhe pas anëtarësimit të vendit në NATO, duke shfrytëzuar deklaratat publike të ish-presidentit të shtetit, Gjorgje Ivanov, Rusia kishte tentuar në mënyra të ndryshme që të prish këtë marrëveshje por pa sukses. Sipas “[Euractiv](#)”, deri shpejt, shpresat e fundit të Rusisë kanë qenë rikthimi në pushtet i një partie nacionaliste e cila nuk do të lejonte anëtarësimin e vendit në NATO dhe ndryshimin e emrit të vendit.



# VERIFIKIME TË FAKTEVE





# NË UKRAINË NUK SHKATËRROHEN “FASHISTËT GLOBAL”, POR VRITET POPULLATA CIVILE DHE FËMIJË

Ndryshe nga pohimi absurd në postimin se “*ushtria ruse po shkatërron fashistët global dhe dëgjuesit e tyre*”, në luftën në Ukrainë që Rusia e nisi më 24 shkurt, pësojnë ushtarët, por edhe civilët e pafajshëm, mes tyre edhe shumë fëmijë. Sipas autoriteteve ukrainase deri më tani (02.03.2022) janë vrarë më shumë se 2000 civilë. Vrasja e civilëve është konfirmuar nga Kombet e Bashkuara. Komisioneri i lartë i OKB-së për të drejtat e njeriut thotë se në Ukrainë janë raportuar më shumë se 500 viktima civile, duke përfshirë të paktën 136 të vrarë dhe 400 të plagosur, por pritet që numri aktual të jetë shumë më i lartë.

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit

(Vertetmates, 05.03.2022)

Recensojmë një [postim](#) në rrjetin social [Facebook](#), në të cilin pretendohet se në Ukrainë nuk ka luftë mes kombeve vëllazërore ortodokse, por Rusia vret “fashistët globalë”. Ky është **dezinformim** i plotë.

Në postim thuhet:

**Nuk ka luftë në Ukrainë midis dy kombeve ortodokse vëllazërore. Ushtria ruse po shkatërron fashistët globalë dhe dëgjuesit e tyre.**

Ndryshe nga pretendimi absurd në postim, në luftën në Ukrainë, që [e nisi](#) Rusia më 24 shkurt, po pësojnë ushtarët, por edhe një popullatë e pafajshme civile, mes tyre edhe numër i madh i fëmijëve.





## NË UKRAINË VUAJNË CIVILËT DHE FËMIJËT, JO FASHISTËT GLOBALË

Sipas një prej [njoftimeve](#) të fundit nga autoritetet ukrainase, deri më tani (2 mars 2022) janë vrarë më shumë se 2000 civilë.

**Ukraina njofton se nga fillimi i pushtimit, kanë vdekur 21 fëmijë, ndërsa 55 të tjerë janë plagosur. Ky informacion u publikua nga Avokati i Popullit në Ukrainë.**

Në shtatë ditët e luftës, Rusia shkatërroi qindra ndërtesa, spitale dhe kopshte, thanë zyrtarët ukrainas, [transmetuan mediumet](#).

Raportohet se janë vrarë dhjetra punonjës të ambulancës se [zjar-rfikësit](#) shuan më shumë se 400 zjarre që shpërthyen pas sulmeve ruse në të gjithë vendin, ndërsa ushtria dhe policia çaktivizuan 416 pajisje shpërthyes.

Numri i të vdekurve në Ukrainë është rritur që nga dita e parë e pushtimit rus, kur u [regjistruan](#) 57 persona të vrarë dhe 169 të plagosur. Këto shifra përfshijnë ushtarë dhe civilë. Këta nuk janë “fashistë globalë”, por banorë të Ukrainës.

## VRASJEN E CIVILËVE E KA KONFIRMUAR EDHE OKB

Komisioneri i lartë i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, ka thënë se janë raportuar më shumë se 500 viktima civile në Ukrainë – duke përfshirë të paktën 136 të vrarë dhe 400 të plagosur, por pret që numri aktual të jetë shumë më i lartë, raportoi [CNN](#).

**Shumica e viktimave ishin nga përdorimi i armëve shpërthyes me një gamë të gjerë ndikimi, duke përfshirë granatimet e artilerisë së rëndë dhe sistemet e shumta raketore dhe sulmet ajrore. Këto janë vetëm viktimat që ne kemi qenë në gjendje të verifikojmë dhe bilanci real ka të ngjarë të jetë shumë më i lartë, thuhet në njoftimin e zyrës së OKB-së, që e transmetoi [CNN](#).**

Sekretari amerikan i Shtetit, **Anthony Blinken**, gjatë fjalimit të tij para Këshillit të OKB-së, dënoi Rusinë për vrasjen e civilëve në Ukrainë, duke ngritur idenë se Rusia duhet të përjashtohet nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut.

**Ata po shkatërrojnë infrastrukturën kritike që u siguron miliona njerëzve në të gjithë Ukrainën ujë të pijshëm dhe gaz për t'i mbajtur ata nga ngrirja deri në vdekje dhe energji elektrike. Janë granatuar autobusë civilë, makina dhe madje edhe autoambulanca. Rusia e bën këtë çdo ditë në të gjithë Ukrainën, *tha Blinken.***

Ditët e fundit, sulmet ruse kanë goditur [civilë](#), që tregon zhvendosje drejt bombardimeve shumë më agresive. Sulmet e mëparshme ruse janë fokusuar më shumë në caqet ushtarake.

Dy ditë më parë, [BBC](#) raportoi se dhjetëra civilë ishin vranë në Harkov, ndërsa granatimet vazhduan deri në mëngjes, kurse banorët të frikësuar fshihen në strehimore nëntokësore.

## **USHTRIA RUSE GJUAN OBJEKTE CIVILE, SPITALE, MUZE, SHKOLLA**

Sulmet e artilerisë dhe raketave ruse, pas Kievit goditën Harkovin, qytetin e dytë më të populluar të Ukrainës. Videot e postuara në rrjetet sociale dhe të konfirmuara nga [CNN](#) treguan shkatërrime të konsiderueshme në pjesën verilindore të qytetit. Një sulm goditi një kompleks rezidencial pranë një spitali, ndërsa gjithashtu u goditën policia rajonale dhe Universiteti Kombëtar i Harkovit.

Forcat ruse kanë shtuar sulmet ndaj vendbanimeve në Ukrainë, duke bombarduar një shesh në Harkov dhe një kullë televizive në Kiev.

[Sipas autoriteteve ukrainase](#), pesë persona u vranë në sulmin e pasdites në kullën televizive, disa kilometra larg qendrës së Kievit dhe pranë ndërtesave të shumta të banimit. Në sulmin rus me raketë në një ndërtesë admin-





istrative në Harkov, u vran të paktën gjashtë persona. Gjatë ditës, ekipet e shpëtimit nxorrën viktimat dhe të mbijetuarit nga nën rrënojat e ndërtesës.

Granatat ranë pranë një qendre tregtare në Harkov ndërsa luftimet vazhduan në rrugë.

Në Harkov, trupat ruse sulmuan një qendër mjekësore ushtarake, njoftoi agjencia ukrainase e lajmeve Unian. Luftimet shpërthyen me forcat ukrainase. Nga pala ukrainase thonë se granatat ruse ranë në qendër të qytetit, duke përfshirë ndërtesa banimi, si dhe ndërtesën e administratës rajonale, raporton "[Deutsche Welle](#)".

Në sulmin e ushtrisë ruse në Harkov, rëndë është dëmtuar edhe ndërtesa e konsullatës sllovene, [njoftoi](#) Ministria e Punëve të Jashtme sllovene në Twitter.

Në ditën e gjashtë të pushtimit rus të Ukrainës, ushtria vazhdon të gjuajë me raketa dhe raketahedhës të shumtë në qytetet ukrainase Harkov, Çernihiv, Sumi, Mariupol dhe të tjerë me dijeninë e plotë se ata po vrasin civilë, e jo ushtarë, [shkruan analisti ukrainas Roman Rukomeda](#) në tregimin e tij të pestë për pushtimin rus të Ukrainës, të cilin ai arriti ta dërgonte në EURACTIV, edhe përkundër qasjes së kufizuar në internet.

Sipas [raportit](#) të tij, janë shkatërruar 80 kopshte, shkolla, fakultete, spitale dhe objekte social-arsimore. Ata synojnë qëllimisht spitalet, si në Harkov, të shkaktojnë sa më shumë vdekje të civilëve.

Forcat ushtarake ruse hodhën me raketa gjithashtu një nga monumentet më tragjike në Kiev – Babi Jar, ku mijëra hebrenj, romë, ukrainas dhe kombësi të tjera u vranë nga nazistët gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

## MBI 800 000 REFUGJATË E KANË LËSHUAR UKRAINËN

[BBC](#) raporton se më shumë se 830,000 civilë janë larguar nga Ukraina.

Bashkimi Evropian (BE) vlerëson se deri në katër milionë njerëz mund të përpiqen të largohen nga vendi për shkak të pushtimit rus. Blloku ka lehtësuar rregullat e refugjatëve dhe thotë se shtetet e tij anëtare do t'i mirëpresin refugjatët me “krahë të hapur”.

Në raportin që e publikuan shërbimet e Komisionerit të Lartë të OKB-së për refugjatët, thuhet se 453,000 janë vetëm në Poloni, kur në ditë mbërrijnë nga 50,000 njerëz.

Sipas raportit të OKB-së, në:

- Hungari ka 116.348
- Moldavi 79.315
- Sllovaki 67.000
- Rumani 44.450
- Rusi 42.900
- Bjellorusi 341
- 600 njerëz janë vendosur nga këto vende në të tjera në Evropë

Në [BBC](#) janë publikuar shumë video-dëshmi prekëse të ukrainasve që kanë ikur në vende të tjera evropiane për shkak të agresionit ushtarak.

Këngëtarja e njohur e operës dhe xhazit **Suzana Alimovna Xhamaladinova** nga Ukraina, e njohur si Xhamala, e cila fitoi në vitin 2016 fitoi në Eurovizion me këngën “1944”, është një nga ata që u bënë refugjatë në ditët e para të pushtimit rus të Ukrainës. Ajo [tregoi](#) golgotën e saj, duke u strehuar me dy fëmijët e saj në Turqi, pasi dëgjoi shpërthime pranë shtëpisë së saj në Kiev.

Duke pasur parasysh gjithçka që po ndodh në Ukrainë pas pushtimit të Ruisë, është e pakuptimtë dhe e turpshme që autori i postimit t'i quajë popullsinë e pafajshme civile dhe fëmijët që janë viktimat e luftës në Ukrainë “fashistë globalë dhe dëgjuesit e tyre”. Vetë postimin, e vlerësojmë si **dezinformatë** e plotë.





Në lidhje me dezinformatat që lidhen me luftën në Ukrainë, Xhovani Kesler, prokuror italian që ka punuar në zyrën e prokurorit të njohur sicilian Paolo Borsalino në vitin 1995, në një intervistë për “Vërtetëmatës”- in thotë se lajmet e rrejshme dhe propaganda shpërndahen që moti.

Rusët janë të shkëlqyer në këtë, më të mirët në botë. Ata kanë struktura të dedikuara, kanë mjete të fuqishme dhe mjete financiare, për të krijuar dhe përcjellë pikëpamjet e tyre. Kjo është propagandë, sepse përmban informacion të rremë. Rusia e ka bërë këtë prej vitesh. Diçka interesante dhe e re është mënyra se si ata përdorin ushtrinë dhe propagandën e tyre të luftës. Lufta nuk filloi një javë më parë. Lufta filloi disa muaj më parë, kur 150,000 trupa ruse u vendosën në kufirin me Ukrainën. Ishte interesante që portali i tyre i lajmeve të rreme transmetonte ushtarët (sipas ligjit rus është e ndaluar rreptësisht). Ishte mënyrë për të ushtruar presion të jashtëzakonshëm mbi Ukrainën nga propaganda ruse. Fillimisht ata synojnë t’i portretizojnë institucionet e Ukrainës si shumë të dobëta, në fund doli që nuk janë të dobëta, qëllimi i tyre ishte të lëshonin Ukrainën të dështonte, vetëm duke shfaqur dhe transmetuar propagandë. Lufta në Ukrainë filloi në momentin kur ata filluan të transmetonin propagandën e tyre. Ata donin ta shkatërronin Ukrainën vetëm me propagandë pa u shkrepuar asnjë plumb. Kështu bëjnë mediat moderne propagandistike.



# NUK ËSHTË E VËRTETË QË RUSIA NUK BOMBARDON NDËRTESA CIVILE DHE SE PAMJET E MARIUPOLIT JANË TË RREME

Deklarata e ambasadorit rus në vend, Sergei Bazdnikin, se forcat e armatosura ruse nuk bombardojnë ndërtesa civile dhe se pamjet nga Mariupol janë false, duket e çuditshme dhe të paktën tingëllon e paarsyeshme në një situatë ku media të shumta botërore dhe vendase publikojnë vazhdimisht pamjet e ndërtesave të shkatërruara civile. Nuk është e mundur që të gjitha ato regjistrime që dalin në media dhe në rrjetet sociale të jenë false. Konfirmimi se forcat ruse po sulmojnë ndërtesat civile ka ardhur edhe nga autoritetet ukrainase

Shkruan: Ana Anastasovska

(Vertetmates, 15.03.2022)

Duke folur për situatën me konfliktin ruso-ukrainas dhe bombardimin e ndërtesave civile në qytetin ukrainas të Mariupolit nga ushtria ruse, ambasadori i Federatës Ruse në Maqedoni, **Sergei Bazdnikin** bëri deklaratën e mëposhtme:

Ne bëjmë gjithçka që mundemi për të parandaluar viktimat civile. Në fillim të operacionit special ushtarak, udhëheqja ushtarake ruse dha urdhër të qartë dhe të vendosur për të mos sulmuar vendbanimet dhe infrastrukturën civile. Forcat tona të armatosura, së bashku me trupat e republikave Donetsk dhe Luhansk, përdorin armë me precizitet të lartë dhe shkatërrojnë ekskluzivisht, theksoj, infrastrukturën ushtarake të autoriteteve ukrainase





në kuadër të detyrës së çmilitarizimit. Ky urdhër është duke u përmbushur. Megjithatë, të gjitha operacionet luftarake për fat të keq shoqërohen me viktima. Një nga problemet kryesore është përdorimi i popullatës civile nga formacionet naziste të Ukrainës si mburojë edhe atë jo figurativisht, por them fjalë për fjale. Ne nuk bombardojmë as spital për fëmijë e as objekte civile.

I pyetur nga gazetari nëse regjistrimet e postuara nga Mariupol ishin false, Bazdnikin tha: E saktë.

[Burimi – TV Sitel (prej 15:15 deri 17:54 në video ); Data: 10.03.2022]

### ARSYETIMI:

Pretendimi i ambasadorit rus në vend, **Sergei Bazdnikin**, se ushtria ruse nuk sulmon apo granaton objektet civile në Ukrainë, është i pavërtetë. Regjistrimet nga Mariupoli, por edhe nga qytete të tjera ku shihen ndërtesa të shkatërruara civile, nuk janë false, siç dëshiron të tregojë Bazdnikin.

Më 11 mars, siç raportoi [TV 21](#), duke transmetuar video materiale, objektivi i sulmeve ruse ishte qyteti i **Dnipros**. Tre sulme ajrore goditën qytetin në orët e para të mëngjesit. Një kopsht fëmijësh, një pallat dhe një fabrikë këpucësh u goditën. Gjithashtu ka pasur raportime për bomba në qytetin **Lutsk**, në veriperëndim të Ukrainës. Në ditën e 16-të të agresionit rus, u godit edhe një spital psikiatrik në qytetin lindor të **Izum**, informuan autoritetet rajonale. Në spital ndodheshin 330 persona, ndërsa numri i viktimave nuk dihej.

Sa i përket qytetit të **Mariupolit**, ai ishte nën granatimet 14 orëshe nga ushtria ruse më 2 mars, gjë që u konfirmua nga autoritetet lokale ukrainase.

Siç raporton [SDK.mk](#), civilë të shumtë kanë humbur jetën si pasojë e granatimeve intensive 14 orëshe të qytetit, i cili prej ditësh është nën rrethim nga forcat ruse. Ky qytet në brigjet e detit Azov është strategjikisht i rëndësishëm për Rusinë, pasi siguron lidhje tokësore me gadishullin e aneksuar të Krimesë me trupat separatiste në Ukrainën lindore.

**Nuk e dimë numrin e saktë të viktimave, por besojmë se ka qindra të vdekur. Nuk mund t'i mbledhim trupat. Ushtria ruse po përdor të gjitha armët e mundshme dhe po përpiqet të shkatërrojë plotësisht qytetin, *tha zv.kryetari i komunës, Sergij Orlov.***

Kryetari i komunës **Vadim Bojçenko**, tha se trupat ruse kishin ndaluar evakuimin e civilëve.

**Ka shkatërtime të mëdha në infrastrukturën e banesave. Ka shumë të plagosur dhe, për fat të keq, të vdekur, mes tyre gra, fëmijë dhe pleq. Ndodh gjenocidi i popullit ukrainas. Forcat pushtuese të Federatës Ruse bënë gjithçka që ishte e mundur për të parandaluar evakuimin e civilëve nga qyteti. Trafiku hekurudhor është ndërprerë dhe lokomotivat janë granatuar. Qëllimi i tyre është të na shkatërrojnë, *tha Bojçenko.***

Më 10 mars u [bombardua edhe spitali i fëmijëve në Mariupol](#), siç u konfirmua nga presidenti ukrainas **Volodymyr Zelenski** dhe [kreu i administratës ushtarake rajonale, Pavlo Kirilenko](#).

Presidenti **Zelenski** postoi një video të incidentit në Twitter – të cilën ai e përshkroi si “goditje të drejtpërdrejtë”, dhe pamjet treguan dhoma të shkatërruara përgjatë korridorit të ndërtesës.

**Sulmi ushtarak në një maternitet është prova përfundimtare që po kryhet gjenocid ndaj ukrainasve. Evropianë, nuk mund të thuash se nuk e dinit se çfarë po ndodhte me ukrainasit në Mariupol. Kjo është arsyeja pse ju duhet të rritni sanksionet ndaj Rusisë në mënyrë që ajo të mos mund të vazhdojë kurrë këtë gjenocid. Duhet të bëni presion mbi Rusinë që të ulet në tryezën e bisedimeve dhe t'i japë fund kësaj lufte barbare, *tha Zelenski në video-fjalim.***





Kreu i administratës ushtarake rajonale, Kirilenko, [postoi](#) gjithashtu video të sulmeve në Facebook.

Në këtë sulm u vranë disa fëmijë dhe u plagos një grua shtatzënë që priste të lindte. Sipas autoriteteve ukrainase, ky ishte vetëm një nga tre sulmet e ushtrisë ruse mbi spitalet. U bombarduan gjithashtu dy spitale në qytetin Zhitomir, rreth 150 km në perëndim të Kievit.

Pamjet e sulmit mbi spitalin për fëmijë në Mariupol, ku u vranë gratë shtatzëna, publikuan edhe [New York Times](#) dhe [ABC News](#).

Ministria e Jashtme e Ukrainës më 12 mars [njoftoi](#) se forcat ruse kishin bombarduar një xhami në qytetin jugor të Ukrainës, Mariupol, ku ishin strehuar më shumë se 80 fëmijë dhe të rritur. Ministria ukrainase njoftoi në Twitter se xhamia e Sulltan Sulejmanit të Madhërishëm në Mariupol ishte granatuar nga “sulumuesit” rusë.

Më 14 mars, [u publikuan pamjet](#) nga granatimet në Mariupol, të bëra nga ajri.

Videoja nga droni kapi momentin kur raketat ruse e kthyen qytetin e rrethuar jugor të Ukrainës, Mariupol, në një peizazh djallëzor, ndërsa forcat e Moskës vazhduan të bombardojnë ndërtesat, duke lënë civilët pa ushqim dhe ujë.

Për atë se si është gjendja pas granatimit në Mariupol, raportoi edhe [Radio Evropa e Lirë](#).

Pretendimi i ambasadorit rus në vend, Sergei Bazdnikin, se forcat e armatosura ruse nuk bombardojnë ndërtesa civile dhe se pamjet nga Mariupol janë false, duket e çuditshme dhe të paktën tingëllon e paarsyeshme në një situatë ku media të shumta botërore dhe vendase publikojnë vazhdimisht, pamjet e ndërtesave të shkatërruara civile. Nuk është e mundur që të gjitha ato regjistrime që dalin në media dhe në rrjetet sociale të jenë false. Konfirmimi i një informacioni të tillë vjen edhe nga autoritetet ukrainase

Nisur nga të gjitha këto, deklaratën e Bazdnikin e vlerësojmë si **të pavërtetë**.

## BURIME:

- Youtube – TV Sitel (10.03.2022) – [Тема на денот со амбасадорот на Руската Федерација Сергеј Баздникин](#) [Нарур më 15.03.2022]
- TV 21 (11.03.2022) – [Русија гранатира болници и детски градинки – Зеленски: Светот треба да знае дека имаме работа со терористичка држава!](#) [Нарур më 15.03.2022]
- Sdk.mk(02.03.2022)–[ВО МАРИУПОЛИМА СТОТИЦИ МРТВИ, ГРАДОТ СЕ ГРАНАТИРА 14 ЧАСА, ВЕЛАТ ЛОКАЛНИТЕ ВЛАСТИ](#) [Нарур më 15.03.2022]
- Radio MOF (10.03.2022) – [Гранатирана детска болница во Украина, Зеленски ја обвини Русија за воени злосторства](#) [Нарур më 15.03.2022]
- Sloboden pečat (09.03.2022) – [ВИДЕО: Украинците тврдат дека Русија нападнала детска болница во Мариупол, Зеленски објави снимки на Твитер](#) [Нарур më 15.03.2022]
- [Profili në Facebook i Pavlo Kirilenko](#) (09.03.2022) [Нарур më 15.03.2022]
- New York Times (09.03.2022) – [Видео покажуваат разорен напад врз породилиштето во болницата во Мариупол](#) [Нарур më 15.03.2022]
- ABC News (09.03.2022) – [Руските напади ја уништија детската болница во Мариупол](#) [Нарур më 15.03.2022]
- 360shkallë.mk (12.03.2022) – [МНР на Украина: Русија гранатираше цамија во јужниот дел на Мариупол](#) [Нарур më 15.03.2022]
- Nezavisen.mk (14.03.2022) – [Видео снимки од воздух на пеколот на земјата – Мариупол](#) [Нарур më 15.03.2022]
- [Фаџја në Facebook e Radio Evropa e Lirë](#) (10.03.2022) – [Нарур më 15.03.2022]





# RMV, ME FAKTE TË NJËANSHME QYTETARËVE JU SUGJEROHET TË JENË PRO AGRESIONIT RUS NË UKRAINË

Me apo pa vetëdije, nga persona dhe faqe të caktuara, në rrjetet sociale në mënyrë indirekte përhapet propagandë pro-ruse rreth konfliktit aktual Rusi-Ukrainë. Duke mos i paraqitur të gjitha faktet, gjuha e urrejtjes ndaj Ukrainës, përhapet në pretendimet se Ukraina ka dërguar mercenar për të vrarë popullin shqiptar në Kosovë, gjatë viteve 1998/99, ka mbështetur bombardimet e shqiptarëve në Maqedoni gjatë vitit 2001 dhe kundërshton pavarësinë e Kosovës, shkruan [Portalb.mk](#). Transmetimi i informacioneve të tilla është i njëanshëm dhe nuk e paraqet realitetin faktik me qëllim që opinioni publik të ketë hapësirë vetë të vlerësojë se çfarë mendimi të ketë rreth situatës në Ukrainë.

Shkruan: Shefkije Alasani

(Portalb, 07.03.2022)

Në rrjetet sociale, kryesisht në “Facebook” është shpërndarë një fotografi ku shikohet një avion ushtarak i cili bombardon një territor të banuar. Fotografia shoqërohet me përshkrimin si më poshtë:

*“Kështu Ukraina i bombardonte shqiptarët e Maqedonisë në vitin 2001, ku mbetën të vrarë shumë gra shtatzëna, nëna, fëmijë, të moshuar dhe mbetën shumë invalid tjerë.”*

Vetëm pak orë pas publikimit, [postimi është shpërndarë](#) nga dhjetëra profile tjera dhe është komentuar nga qindra të tjerë. **Shqetësues është niveli i urrejtjes që nxit një postim me informacion të cunguar i bërë nga persona të panjohur dhe nxjerrja nga konteksti e fotografisë së përdorur.**





Nga kërkimi për burimin e fotografisë në [Google Images](#) figuron se fotografia e përdorur në postin e lartpërmendur është publikuar nga mediat ruse për të raportuar mbi konfliktin në Maqedoninë e Veriut gjatë vitit 2001, **megjithatë askund nuk theksohet fakti se avioni që duket në fotografinë në fjalë është një avion ukrainas**. Të dhënat nga verifikimi i fakteve tregojnë se [fotografia është shkrepur mbi fshatin Vaksincë](#) të Kumanovës, gjatë konfliktit të armatosur në Maqedoninë e Veriut në vitin 2001.

Që nga fillimi i agresionit rus në Ukrainë, më 24 shkurt, në rrjetet sociale dhe ueb-portalet shqipfolëse me fakte të njëanshme në masë të madhe shpërndahet propagandë pro ruse. Në **“Facebook” dhe “Instagram” qindra herë janë shpërndarë fotografi ku radhiten disa “fakte” të cilat në opinion kanë tendencë të nxisin urrejtje ndaj shtetit dhe popullit ukrainas**.

## **Marrëveshja ishte mes qeverisë së Ukrainës dhe Maqedonisë**

**Është e vërtetë se gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001 Ukraina, bashkë me Rusinë, ishte ishte një ndër mbështetësit kryesor të ushtrisë maqedonase. Gjatë konfliktit të vitit 2001, Ukraina mori përsipër trajnimin e piloteve maqedonas në akademitë e saj, mbështeti fuqinë ajrore dhe ofroi ndihmë për stërvitje të policisë dhe forcave speciale maqedonase.**

Ukraina madje ofroi ndihmë për servisimin e pajisjeve ushtarake të Maqedonisë dhe ka dorëzuar në atë kohë më shumë helikopterë, transportues Mi-8 dhe Mi-17 dhe luftarak Mi-24, katër avionë SU-25 dhe pajisje tjera për ushtrinë tokësore, pasi që në atë kohë Republika e Maqedonisë i ka paguar me paratë nga shitja e Telekomit dhe me eksport të mallrave tjera. Nën tryzni të SHBA-së dhe NATO-s, Ukraina ra dakord të “pezullonte” dërgesat e saj të armëve ushtarake në Maqedoni gjatë kohës së operacionit paqësor të NATO-s për çarmatosje pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit.

Në pranverën e vitit 2001, policia dhe parlamenti e qeveria e Maqedonisë, në të cilat participonin partitë politike maqedonase (VMRO-DPMNE dhe PLD) dhe ajo shqiptare (PDSH), ndërmorën masa të armatosura duke



përfshirë dhe marrëveshjet me Ukrainën e cila në atë kohë ishte pro-ruse.

Populli ukrainas i cili tani është duke u bombarduar dhe me [pasojë viktimash](#), nuk është përgjegjës për marrëveshjet e atëhershme para më shumë se 20 vite të bëra nga krerët e këtij vendi. Nuk duhet të mbahet mëri mbi civilët që janë duke u [shpërngulur në masë të madhe](#) duke ikur nga agresioni rus.

Mos-solidarizimi me to, e vendos secilin në anën e agresorit, Vladimir Putin.

**Për kryetarin e Kuvendit, Talat Xhaferi**, zërat mbi animin që duhet të mbajnë shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në luftën mes Rusisë dhe Ukrainë dalin nga qarqe pro ruse, dhe se kjo nuk mund të jetë parametër për të vlerësuar përcaktimin e një shteti.

“Qarqe pro ruse që duan ta arsyetojnë mbështetjen që e kanë , gjithsesi që në situata krize shtete furnizohen pre ngado dhe nuk mund të jetë ajo parametër mbi të cilin duhet ta bëjmë vlerësimin. Vlerësimi ynë është, deshët gjatë rilindjes, deshët para rilindjes dhe mbas, orientimi ynë është perëndimor. Prej nga të duash merre kontestin historik të raporteve Rusi-shqiptarë, s’ka mbështetje. Përpos interesit dhe shfrytëzimit”, tha mes tjerash [Xhaferi në ClickPlus në TV21](#).

## **Udhëheqësit shqiptar në RMV, Kosovë dhe Shqipëri dënojnë agresionin rus**

Maqedonia e Veriut, zyrtarisht e ka dënuar agresionin rus në Ukrainë dhe është bërë pjesë e [sanksioneve të BE-së kundër Rusisë](#). Madje, edhe Kuvendi i Kosovës e [miratoi Rezolutën që dënon agresionin rus në Ukrainë](#). Sa u përket zërave se Ukraina refuzon ta njohë pavarësinë e Kosovës, autoritet ukrainase i arsyetojnë e mosnjohja e Kosovës vjen vetëm për shkak të paralelizmave që Rusia heq mes saj dhe Krimesë.

“Arsyeja se pse Ukraina nuk e ka njohur Kosovën, padyshim ka të bëjë me Rusinë, e cila qartësisht manipulon pa asnjë bazë politike apo ligjore, duke gjetur ngjashmëritë mes aneksimit të paligjshëm të Krimesë dhe përpjekjen e kosovarëve drejt të ardhmes së tyre. Por në qëndrimin tonë, në asnjëherë nuk kemi bllokuar asnjë përpjekje të Kosovës për t’ju bashkuar organizatave ndërkombëtare. Madje ne luajmë futboll me Kosovën, kështu që është një





lloj shenje nga ana jonë që nuk është mënyra e qëndrimit tonë të posaçëm politik, është thjesht mënyra për të mos lejuar Rusinë për të manipuluar më tej këtë çështje”, pati deklaruar ish ministri i Jashtëm i Ukrainës, **Pavlo Klimkin**, **gjatë një vizite zyrtare në Tiranë**.

Ndërkohë pak ditë më parë deputetja Iryna Friz ka thënë se është momenti që Ukraina ta njeh shtetësinë e Kosovës. **Në një shkrim në Facebook**, Friz thekson se në këto kohë të vështira të vendit të saj, Kosova është rreshtuar karshi miqve të Ukrainë.

## **Në çfarë rrethanash politike vepronte Ukraina gjatë vitit 2001?**

Ka fakte shumë të rëndësishme të cilat nuk paraqiten për lexuesit gjatë trumbetimit se Ukraina ka mbështetur “vrasjen e shqiptarëve”. Një ndër faktet primare është politika pro-ruse në krye me lider ukrainas të zgjedhur dhe mbështetur fuqishëm nga pushteti rus gjatë asaj periudhe. Në këto raporte nuk përmendet aspak elementi esencial se ka një **ndryshim drastik të politikës ukrainase në vitin 2001 dhe asaj aktuale**.

Gjatë konfliktit të vitit 2001 në Maqedoni, president i Ukrainës ishte **Leonid Danylovyh Kuchma**, udhëheqja e të cilit njihet për një **sërë aferash korruptive, censurim të fjalës së lirë dhe bashkëpunëtor i Rusisë**. **Kuchma nënshkroi “Traktatin e Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Partneritetit” me Rusinë** dhe rusishtes i referohej si “gjuhë zyrtare” në Ukrainë. Publikimi i disa përgjimeve nga opozitari ukrainas Oleksandr Moroz, të bëra nga viti 1998 deri në vitin 2000, zbuloi krimet e shumta të ish presidentit Leonid Kuchma. Në veçanti, miratimi i tij për shitjen e sistemeve të radarëve Sadam Huseinit (bashkë me shitje tjera të paligjshme të armëve).

Pas Leonid Kuchmas në krye të Ukrainës erdhi politikani **Viktor Jushçenko**. **“Banditët do të shkojnë në burg!”** ishte motoja kryesore e fushatës presidenciale nga Jushçenko, megjithatë me të marrë në dorë pushtetin ai dështoi ti përmbush pritshmëritë e popullit ukrainas, të cilët e shikonin atë si shpëtimtarë të Ukrainës. Zgjedhjet presidenciale në Ukrainë në vitin 2004 ishin mjaftë të bujshme, bashkë me Jushçenkon në garën për të parin e vendit ishte edhe **Viktor Janukoviç**.

Në fakt, Janukoviç ishte trashëgimtari i zgjedhur nga vet Leonid Kuchma, i cili në vitin 2002 e kishte emëruar Janukoviçin kryeministër të Ukrainës, duke i dhënë në dispozicion aparatit shtetëror dhe buxhetin për të luajtur gjatë fushatës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli fitues Viktor Janukoviçin, kjo situatë ngjalli revoltë të madhe tek populli ukrainas të cilët nuk e pranonin një rezultat të manipuluar nga pushteti.

Në fund të nëntorit të vitit 2004 në Kiev filluan protesta masive në mbështetje të Jushçenkos, e cila më pas do të njihet si “**Revolucioni Portokalli**“. Jushçenko fitoi dhe u inaugurua si presidenti i tretë i Ukrainës më 23 janar 2005. Viktor Jushçenko mbajti postin e presidentit deri në vitin 2010 dhe në histori ai mbahet mend si një udhëheqës i cili jo vetëm dështoi në përmbushjen e premtimeve të tij por vazhdoi traditën e paraardhësit të tij duke ndihmuar pasurimin e oligarkëve aktual si dhe shfaqjen e oligarkëve të rinj të cilët ishin njerëzit e tij më të afërt.

Në vitin 2010 president i Ukrainës u bë Viktor Janukoviç i cili në opinion njihet si mbështetës i madh i politikave të presidentit rus Vladimir Putin. Gjatë mandatit të Janukoviçit Rusia dhe Ukraina arrijnë një marrëveshje për çmimin e gazit në këmbim të zgjatjes së qirasë për marinën ruse në një port ukrainas të Detit të Zi. Transparency International emëroi Presidentin Janukoviçin si shembullin më të lartë të korrupsionit në botë. Në vitin 2013 Qeveria e Janukoviçit pezulloi bisedimet e tregtisë dhe asociimit me BE-në dhe vendosi të ringjallë lidhjet ekonomike me Moskën, duke shkaktuar tubime masive në Kiev për muaj të tërë. Protestat që kishin për qëllim rrëzimin e presidentit Viktor Janukoviçit, u bënë të dhunshme ku si pasojë vriten dhjetëra protestues.

## **Nga viti 2014 vullneti i popullit dhe orientimi politik i Ukrainës ndryshoi kahje**

Vala e demonstratave të dhunshme në Ukrainë mori emrin “**Euromadian**” dhe çuan në revolucionin ukrainas të vitit 2014, i njohur si “**Revolucioni i Dinjitetit**”. Në shkurt të vitit 2014, parlamenti ukrainas votoi për largimin e Janukoviçit, i cili arratiset drejt Moskës. Sipas politikanit rus Oleg Mit-





**vol, Janukoviç bleu një shtëpi në Barvikha për 52 milionë dollarë më 26 shkurt 2014.** Ndërkohë në Ukrainë brenda pak ditësh, njerëz të armatosur kapin parlamentin e rajonit ukrainas të Krimesë dhe ngrenë flamurin rus. Moska e anekson territorin e Krimesë pas një referendumi të mbajtur më 16 mars. Në prill, separatistët pro-rusë në rajonin lindor të Donbasit shpallin pavarësinë. Luftimet shpërthejnë dhe kanë vazhduar në mënyrë sporadike, pavarësisht armëpushimeve të shpeshta, deri në vitin 2022.

**Ukraina në javët dhe muajt pas Euromaidanit ishte një komb në prag të katastrofës. Rusia, e alarmuar se Euromaidan do ta largonte Ukrainën nga Kremli dhe do ta afronte drejt Bashkimit Evropian, aneksoi shpejt Krimenë dhe ndezi një konflikt separatist në rajonin e Donbasit.** Dekada korrupsioni e kishin lënë ushtrinë ukrainase të papajisur mirë për të mbrojtur sovranitetin e vendit. Ndërkohë, presidenti i rrëzuar nga lëvizja Euro-maidan, Viktor Janukoviç, iku në Rusi dhe la pas një thesar bosh.

Presidenti i ardhshëm i Ukrainës ishte **biznesmeni Petro Proshenko**, i cili u inaugurua më 5 qershor të vitit 2014. Gjatë fushatës zgjedhore, Poroshenko premtoi se gjërat do të ndryshonin. **Përderisa ndërtonte perandorinë e tij të biznesit, Proshenko kishte pozicione politike gjatë udhëheqjes së tre nga katër paraardhësit e tij presidencialë.** Poroshenko u përball me akuzat për përfitim nga të qenit në pushtet, qoftë duke marrë kontrata fitimprurëse furnizimi, duke lobuar për firmat e tij, ose duke përdorur sistemin e drejtësisë në dobi të tij dhe të partnerëve të tij.

Më 20 maj të vitit 2019, **Volodymyr Zelensky u inaugurua si presidenti i gjashtë i Ukrainës, një emër i ri në politikën ukrainase i cili kishte ndërtuar imazhin dhe pasurinë e tij si humorist, aktor dhe personazh televiziv.** Zelensky i fitoi zgjedhjet presidenciale me premtimet se do i jap fund korrupsionit në vendin e tij dhe se do të zgjidh **konfliktin e tensionuar në Ukrainën lindore.** Liderhipi i ri në Ukrainë kishte presidentin më të ri në historinë e saj (41-vjeç), parlamentin më të ri (mosha mesatare 41), kryeministrin më të ri (35) dhe kabinetin më të ri në Evropë (mosha mesatare 39). Kabineti i ri u quajt gjithashtu shpejt “më liberali” në historinë e Ukrainës

dhe udhëheqësit e qeverisë u zotuan një rritje prej 40 për qind të PBB-së gjatë pesë viteve. **Presidenti aktual i Ukrainës njihet si mbështetës i politikave pro-perëndimore dhe anti-ruse.**

Krizat gjithmonë kanë qenë burim i fuqisë së makinerive propaganduese. **Thelbi i gazetarisë** është i shumëanshëm, por bërthama përbëhet nga dy gjëra: faktet dhe e vërteta. Nëse një informacion nuk i përmban këto dy elemente atëherë kemi të bëjmë me fenomenin që quhet propagandë dhe qëllimi i propagandës është që të luhet me ndjenjat e opinionit publik dhe ti imponohet mendim pozitiv apo negativ kundrejt një pale të caktuar. Zgjedhja e burimeve të besueshme të informimit është shumë e rëndësishme për opinionin publik ndërsa për ata që transmetojnë lajme është e rëndësishme mbi të gjitha ti respektojnë parimet e **Kodit Etik** dhe të jenë të ndërgjegjshëm për pasojat negative në shoqëri nga dezinformimi apo keqinformimi.

**Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe Këshilli për Etikë në Mediat në Maqedoni (KEMM)**, pas fillimit të luftimeve në Ukrainë, u bëjnë thirrje mediave që të informojnë me përgjegjësi dhe profesionalizëm maksimal, duke mos kontribuar në përhapjen e spekulimeve dhe të pavërtetave në opinion.

**Marina Tuneva, drejtoreshë e KEMM, thotë se mediat profesionale dhe kredibile kanë rol më të madh dhe mund të ndihmojnë të prezantohet e vërteta për luftën në Ukrainë. Në një intervistë për “Vërtetëmatës”- in, Tuneva shprehet:**

**Nuk është gjithmonë e lehtë të arrihet deri te e vërteta, sidomos në kushte të këtilla, gazetarët dhe punonjësit e medias e kanë të vështirë ta bëjnë punën e tyre, kur nga të gjitha anët ka një vërshim të vazhdueshëm të dezinformatave, por secili që punon profesionalisht gjen forcën për të ardhur deri tek e vërteta dhe të gjejë burimet e duhura të informacionit. Një nga mënyrat për ta dalluar informacionin spekulativ dhe propagandistik është burimi**





**i dyshimtë i informacionit. Mjafton të bëhet një kërkim i vogël për të parë se nga janë marrë informacionet, nëse ai burim**

**është kredibil, relevant. A është i kualifikuar për të folur për një temë të caktuar dhe në këtë mënyrë dalëngadalë të arrihet deri tek e vërteta. Ekzistojnë dhe një sërë mjeteve që gazetarët tashmë i përdorin në punën e tyre për të zbuluar nëse një pjesë e përmbajtjes është montuar, fabrikuar, redaktuar apo keqpërdorur. Gazetarët profesionistë duhet të ndihmojnë në ekspozimin e dezinformatave dhe përmbajtjeve të fabrikuara.**

**Ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani thekson se dezinformatat dhe propaganda janë një nga veglat e luftës dhe janë aktive në regionin tonë, në disa vende më shumë dhe në disa më pak. Në një intervistë për Portalb.mk, ai shprehet:**

**Ato janë absolutisht aktive këtu në rajon, më pak ose më shumë në vende të ndryshme të rajonit. Ato janë prezente dhe kanë qenë prezente gjatë gjithë kohës dhe në të kaluarën në forma të ndryshme, tani janë intensifikuar dhe më tej. Qeveria ka ndërmarrë disa masa në këtë drejtim, ju e dini që ka ndërprerë emetimin e televizionit shtetëror rus në vend, mirëpo sigurisht se nëpërmjet të platformave të ndryshme rajonale ato vazhdojnë të veprojnë këtu, por edhe përmes platformave vendore. Kishte një analizë të një organizate joqeveritare e cila krahasonte numrin e publikimeve për Ukrainën dhe për Rusinë dhe në të mund të shihni se ka pothuajse një baraspeshë në këtë drejtim, që do të thotë se ashtu siç publikohen fakte dhe të vërteta me aq intensitet publikohet e pavërteta dhe dezinformata. Ky është një intensitet i rrezikshëm që ndikon në krijimin e opinionit publik dhe në keqpërdorimin e emocioneve të njerëzve. E gjithë kjo ndodh në**

një terren të papërshtatshëm për shkak të frustrimeve që kanë njerëzit në rrugën e bllokuar evropiane, kompromiset e shumta të cilat vendi ishte i detyruar t'i bënte në këto vite, dhe e gjitha kjo energji e pakënaqësisë, e frustrimit të njerëzve tani në mënyrë precize kanalizohet për të arritur qëllime konkrete. Këto qëllime janë për të thyer besimin e njerëzve në institucione, kjo mendoj që ka qenë një prej çaqeve kryesore sepse në moment kur njerëzit i thyeni në besim ndaj institucioneve pastaj ato bëhen lehtë të manipulueshëm. Më pas, institucionet bëhen të parëndësishme në marrjen e vendimeve dhe kjo e vështirëson qeverisjen dhe menaxhimin në përgjithësi.







# ËSHTË PROPAGANDË RUSE SE SHTETET E BALKANIT PERËNDIMOR KANË DËRGUAR “MERCENARË” PËR TË LUFTUAR NË UKRAINË

Përmes një titulli tendencioz dhe sensacionalist, një portal në „Fejsbuk” dezinformon masën se shumë shtetas kosovarë janë mobilizuar për ti dalë në mbrojtje Ukrainës në lidhje me ngjarjet e fundit në raport me Rusinë. Kjo përveç që nuk është e vërtetë, kosovarët e kanë të ndaluar me ligj që të marrin pjesë në luftëra jashtë Kosovës si dhe nga Ministria për Punë të Jashtme në Kosovë kanë konfirmuar se asnjë kosovar nuk ka shkuar të luftojë për Ukrainën, shkruan Portalb.mk.

Shkruan: Ardit Ramadani

(Portalb 24.02.2022)

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, asnjëherë nuk është deklaruar në lidhje me mbështetjen që Kosova i ka dhënë Ukrainës për ngjarjet e fundit, aq më pak, ai nuk ka shprehur shqetësim për këtë.

“Putin-It I Hyn “Frika Në Palcë” / Qytetarë Të Kosovës Mobilizohen “Ta Mbrojnë” Ukrainën!” është titulli i [lajmit që e recensojmë](#).

Titulli i këtij [lajmi](#) është tendencioz dhe manipulues, mbi të gjitha, pohon diçka që nuk është e vërtetë sepse jo, as Putin-it nuk i ka hyrë frika në palcë ndërsa qytetarët e Kosovës nuk janë mobilizuar të mbrojnë Ukrainën.

Është i saktë lajmi se ambasadori i Ukrainës në Republikën e Shqipërisë kishte [deklaruar](#) se ka pasur kosovarë të interesuar për ta mbrojtur Ukrainën nga Rusia, por përveç kësaj deklarate, nuk ka asnjë dëshmi tjetër që mbështet këtë pohim.

Kjo dezinformatë e ka [gjenezën](#) te agjencia e lajmeve ruse TASS dhe te ministri i jashtëm rus, Sergei Lavrov





Disa ditë më herët, ministri i jashtëm rus ishte shprehur se Ukraina po “**rekreuton**” **mercenarë** nga Kosova, Shqipëria dhe Bosnje e Hercegovina për ti dalë në mbrojtje asaj.

“Ka informacione se mercenarë janë duke u rekrutuar në Kosovë, Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë për të nxjerrë jashtë ekuilibrit Rusinë dhe për t’i dërguar ato në vende përfshirë edhe Donbass”, ishte shprehur **Lavrov**.

Më pas, informacione të tilla të pasakta ka pasur edhe agjencia e lajmeve ruse TASS.

Menjëherë pas kësaj, ministria për Punë të Jashtme në Kosovë ka **deman-tuar** ministrin rus dhe agjencinë e lajmeve ruse TASS, duke deklaruar se nuk ka kosovarë që kanë shkuar të luftojnë në Ukrainë, pasi kjo është e ndaluar edhe me ligj.

“Bëjmë me dije ministrit rus Lavrov dhe agjencisë e lajmeve ruse TASS, se Republika e Kosovës e ka të ndaluar me ligj pjesëmarrjen e qytetarëve të saj në luftëra jashtë vendit dhe ky ligj parasheh dënime të rrepta për secilin qytetar të saj që mund të jetë pjesë e veprimeve të tilla”, thuhet në **reagimin e MPJD-së**.

Kjo ministri vlerëson se deklaratat e agjencisë së lajmeve TASS dhe ministrit Lavrov janë pjesë e një fushate të egër të propagandës ruse që sipas tyre kanë për qëllim tërheqjen e vëmendjes së gjithë botës demokratike

“Kjo fushatë e egër ruse kundër Kosovës dhe vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor, ndër të tjera, ka për qëllim edhe tensionimin e situatës në Kosovë dhe më gjerë në rajon përmes satelitit rus në Ballkan, Serbisë. MPJD shpreh solidaritetin e plotë të popullit të Kosovës me popullin e Ukrainës për të drejtën për jetë të lirë e sovranë në shtetin e tyre. Republika e Kosovës bën thirrje për ulje të tensionit dhe shmangie të konfliktit, i cili mund të marrë përmasa të paparashikueshme”, thuhet në **njoftimin e MPJD-së**.

Ndryshe, në njoftimin e kësaj ministrie, thuhet se Kosova i bashkohet botës demokratike në dënimin e politikës hegjemoniste dhe ekspansioniste ruse në dëm të shtetit sovran e të pavarur të Ukrainës. Megjithatë, është dezinformatë se ka mobilizim zyrtar për të dërguar kosovarë që të luftojnë në Ukrainë dhe se Putin-it i ka hyrë “frika në palcë”.

# NUK KA ASNJË PROGRAM TË FINANCUAR NGA SHBA PËR ZHVILLIMIN E ARMËVE BIOLOGJIKE NË UKRAINË

Nuk ka asnjë provë që qeveria ukrainase urdhëroi çrrënjosjen e antraksit, kolerës dhe sëmundjeve të tjera infektive në ditën kur Putin pushtoi Ukrainën. Nuk është gjithashtu e vërtetë se ka laboratorë të armëve biologjike të financuara nga SHBA në Ukrainë. Përkundrazi, laboratorët atje janë për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive dhe janë pjesë e Programit Zhvillimor për uljen e rreziqeve nga sëmundjet.

Shkruan: Ekipi i Vërtetmatësit

(Vërtetmtes, 11.03.2022)

Po shqyrtojmë një [postim](#) të shpërndarë në rrjetin social [Facebook](#) ku pretendohet se “Ukraina po shkatërron provat e një programi të zhvillimit të armëve biologjike të financuar nga SHBA.” Në këtë përmbajtje të shpërndarë nga ueb-sajti [Kolovert](#) thuhet që me 24 shkurt të këtij viti, qeveria ukrainase urdhëroi çrrënjosjen e menjëhershme të patogjenëve të murtajës dhe antraksit në laboratorë të financuar nga SHBA. Programi i armëve biologjike i financuar nga SHBA thuhet se përfshinte gjithashtu prodhimin e komponentëve të armëve biologjike në laboratorë në qytetet Poltava dhe Kharkov.

Akuzat i janë atribuar Ministrisë ruse të Mbrotjtjes dhe janë paraqitur dokumente të supozuara që përmbanin një listë të patogjenëve që do të asgjësoheshin, dhe thuhet se informacioni i parë është publikuar nga media ruse “Russia Today”, e cila përndryshe është e kontrolluar nga shteti. Në tekst shtohet gjithashtu se “Russia Today” nuk mund të konfirmojë se dokumentet janë të besueshme.





Cilat ngjarje i paraprinë këtij njoftimi bombastik?

Në një përpjekje për të justifikuar pushtimin e saj në Ukrainë, propaganda ruse promovon edhe një herë narrativën e rreme se Ukraina po zhvillon armë biologjike me ndihmën e SHBA-ve. Më 6 mars, Ministria e Mbrojtjes e Rusisë pretendoi se kishte gjetur prova se Ukraina dhe Shtetet e Bashkuara kishin bashkëpunuar në zhvillimin e armëve biologjike. Në shumë media ruse ky informacion bëri jehonë me shpejtësinë e dritës dhe u [transmetua](#) edhe te ne. Sipas gjeneral majorit Igor Konashenkov, patogjenët për sëmundjet vdekjeprurëse, duke përfshirë murtajën, antraksin dhe kolerën, u krijuan në këta laboratorë për t'u përdorur në luftën biologjike dhe se këta laboratorë ishin “themeluar nga Shtetet e Bashkuara dhe Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-ve”.

Pretendimi i rremë se ka laboratorë të financuar nga SHBA në Ukrainë që prodhojnë patogjenë [është shtyrë nga Rusia](#) që nga viti 2020.

Në maj 2020, në kulmin e pandemisë Covid, [shërbimi sekret i Ukrainës](#) lëshoi një deklaratë duke u kërkuar politikanëve të ndalonin përhapjen e dezinformatave në lidhje me ekzistencën e “laboratorëve biologjikë ushtarakë amerikanë në Ukrainë”.

**Nuk ka laboratorë të huaj biologjike që operojnë në Ukrainë. Pretendimet e politikanëve individual për ekzistencën e pretenduar të laboratorëve të tillë janë të pavërteta dhe janë një shtrembërim i qëllimshëm i fakteve, [thuhet në deklaratë](#).**

Në prill 2020, Ambasada e SHBA-së në Ukrainë lëshoi gjithashtu një deklaratë duke thënë se donte të ishte e qartë në lidhje me dezinformatat në lidhje me programin.

Në [deklaratë](#) thuhej:

**Shtetet e Bashkuara dhe Ukraina kanë një partneritet që nga viti 2005 për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve**

**infektive dhe për të lehtësuar zhvillimin të vaksinave. Ky partneritet midis Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë të Ukrainës është pjesë e Programit Bashkëpunues për Reduktimin e Kërcënimeve, i cili filloi në vitin 1991 për të reduktuar kërcënimin e armëve të shkatërrimit në masë pas rënies së Bashkimit Sovjetik.**

Ky partneritet nuk do të thotë se ka [laboratorë të udhëhequr nga SHBA-të në Ukrainë](#); në fakt, Departamenti Amerikan i Mbrojtjes nuk ka pasur kurrë një laborator biologjik në Ukrainë.

**Ky Program i Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-së për Reduktimin e Kërcënimeve i ka ofruar asistencë teknike Ministrisë së Shëndetësisë së Ukrainës që nga viti 2005 për të përmirësuar laboratorët e shëndetit publik, misioni i të cilëve është analog me atë të Qendrave të SHBA-së për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, një anëtar bordi i Shoqata e Kontrollit të Armëve, tha [Andy Weber për Politifact](#).**

Studiuesja dhe profesoresha e armëve biologjike në King's College në Londër, [Philippa Lenzo](#)s, tha për “Franspres” se nuk kishte indikacione se këta laboratorë në Ukrainë po përdorshin për të zhvilluar armë biologjike, por se qëllimi i tyre ishte të parandalonin përhapjen e sëmundjeve infektive.

Siç shkruan [“Atlantik Kaunsel”](#), Kremli në të kaluarën ka përdorur dokumente të falsifikuara, nënshkrime të falsifikuara si pjesë e [operacioneve të mëparshme](#) për ndikim.

Në vitin 2020, [media pranë Kremlinit](#) u përpoq të fajësonte Amerikën për pandeminë Kovid, duke sugjeruar se virusi ishte krijuar në laboratorë.

Duke pasur parasysh faktet e mësipërme, ne konsiderojmë se nuk ka





asnjë provë që qeveria ukrainase urdhëroi shkatërrimin e patogjenëve të antraksit, kolerës dhe sëmundjeve të tjera infektive në ditën kur Putin pushoi Ukrainën. Gjithashtu vlerësojmë se nuk është e vërtetë që në Ukrainë ka laboratorë për prodhimin e armëve biologjike të financuara nga Shtetet e Bashkuara. Përkundrazi, laboratorët atje janë për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive dhe janë pjesë e Programit Zhvillimor për uljen e rreziqeve.

# ARTIKUJ INFORMUES



THE  
OPIO  
DIAR

Photographs by  
JAMES NACH

ANTI  
SUPER  
EX

A  
HER  
RISE

THE SUP  
OF BLA



# AMBASADA RUSE NË SHKUP KËRCËNON SE I „EVIDENTOJNË” ATO QË MENDOJNË NDRYSHE, TË ETIKETUAR SI „RUSOFOBË”

Shkruan: Filip Stojanovski

(Meta, 06.03.2022)

Ambasada ruse në Shkup është e vetmja në rajonin e Ballkanit e cila nëpërmjet Twitter e ka transmetuar dhe përkthyer „paralajmërimin” nga Ministria e punëve të jashtme e Federatës Ruse për një nivel të rritur të „rusofobisë” me vërejtje se „të gjithë këto incidente evidentoohen me kujdes”, shkruan [Meta.mk](#).

Përkundër faktit që institucionet e Federatës Ruse qytetarëve të tyre ua kanë [kufizuar ose ndaluar qasjen](#) në rrjetet sociale Facebook dhe Twitter, MPJ-ja ruse vazhdon t’i përdorë të dyja në mënyrë aktive.

Më 5 mars në orën 17:55 në profilin zyrtar në Twitter të MPJ-së së Rusisë u [postoi](#) ky njoftim, i cili pas disa orësh u përkthye edhe në gjuhën maqedonase dhe u [transmetua](#) nga profili zyrtar në Twitter i Ambasadës në Shkup në orën 23:03 po të njëjtën ditë.

„TËRHEQIM VËMENDJEN PËR NIVELIN E PAPARË TË RUSOFOBISË TË VËNË RE NË NJË NUMËR TË MADH SHTETESH TË HUAJA NË PRAPAVIJË TË OPERACIONIT SPECIAL USHTARAK NË UKRAINË.

PARALAJMËROJMË SE TË GJITHË INCIDENTET E KËTILLA JANË EVIDENTUAR ME KUJDES.”



Një ditë më parë, më 4 mart, [Duma](#) Ruse miratoi një ligj në të ligjin janë të parapara dënime drakonike për veprën „përhapje me vetëdije e lajmeve të rrejshme” për operacionet e ushtrisë ruse, me të cilat për gjitha vepra parashihet edhe dënim me burgim prej 15 vitësh, [njoftoi](#) „Vërtetëmatësi”.





Duma shtetërore ka paraparë edhe pergjigjësi kundërvajtëse për „diskretim të forcave të armatosura të Federatës Ruse”. Ligji parasheh pergjigjësi për thirrjet publike për ndalimin e përdorimit të forcave të armatosura të FR-së. Me këtë [ligj të ri për censurimin](#) e aktiviteteteve të forcave të armatosura ruse kundër Ukrainës është e ndaluar të përdoren termet si „invazion” dhe „luftë”, por mund të përdoret vetëm terminologjia zyrtare „operacion special ushtarak”.

Postimi i Ambasadës ruse në Shkup shkaktoi qindra reagime kundërshtuese nga qytetarë të fyer të Maqedonisë, që nga shprehjet e mosbesimit deri në fyerje dhe shprehje të mbështetjes për Ukrainën e sulmuar, së bashku me mbështetje për popullin rus i cili gjithashtu po vuan nën diktaturë.



*(Foto: Kolazh nga postimi në Twitter i Ambasadës Ruse dhe faqja e parë e botimit)*

Nga ana tjetër, përveç reagimeve të shumta, mund të vihen re edhe disa Twitt-e nga profile që identifikohen si pjesë e partisë Levica me shprehje mbështetëse për regjimin e Kremlinit, përpjekje për [diskreditim gazetarësh](#) dhe [ngazëllim](#) për formulimin e listave për pushkatim.

## Kërcënime dhe akuza për „rusofobi” si armë propaganduese

Akuzat për „rusofobi” janë pjesë e arsenalit propagandues të Kremlinit për të cilën vite me rradhë paralajmërojnë analistë nga Evropa. Kështu për shembull, në studimin „Rusofobia në strategjinë e Kremlinit. Armë për shkatërrim në masë” ([Russophobia in the Kremlin's strategy. A weapon of mass destruction](#)) të publikuar në qendrën Think-Tank të Polonisë për studime lindore në nëntor të vitit 2015, thuhet:

„NDËRTIMI I IMAZHIT TË VENDEVE RUSOFOBE PËR MOMENTIN PËRDORET PËR FORMIMIN E IDENTITETIT NEO-IMPERIALIST POLITIK MIDIS QYTETARËVE TË FEDERATËS RUSE, ME QËLLIM QË TË MOBILIZOHEN PËR BALLAFAQIM ME KËRCËNIME REALE OSE TË SUPOZUARA, E GJITHASHTU SHËRBEN EDHE SI MËNYRË PËR KTHIMIN E KOMODITETIT PSIKOLOGJIK TE TYRE KUNDREJT DËSHTIMIT TË AKSIONEVE TË KREMLINIT (SI PËR SHEMBULL NË UKRAINË). STEREOTIPI I MITOLOGJIZUAR I VENDEVE RUSOFOBE GJITHASHTU MBETET NJË ARGUMENT KYÇ DHE NJË SQARIM I THJESHTË PËR TENSIONET E VAZHDUESHME NË MARRËDHËNIET MIDIS RUSISË DHE PERËNDIMIT”.

Ambasada ruse në Shkup edhe në të kaluarën ka drejtuar kërcënime direkte drejt qytetarëve të Republikës së Maqedonisë të Veriut. Në mars të vitit 2018 kur u dëbua një punonjës i ambasadës për shkak të aktiviteteve që janë jashtë kornizave të statusit diplomatik, ambasadori rus Oleg Shçerbak [deklaroi](#) se Maqedonia nuk duhet t'i bashkangjitet NATO-s dhe se „në një ndeshje eventuale midis Rusisë dhe NATO-s, Maqedonia do të jetë shenjestër legjitime”.

Atëkohë në një konferencë speciale për mediat Shçerbak tha:

„REPUBLIKA E MAQEDONISË ME INKUADRIM NË NATO DO TË BËHET PJESË E KËSAJ MAKINERIE LUFTARAKE DHE PJESË E AGRESIONIT NDAJ RUSISË. ME KËTË JU DO TË BËHENI SHENJESTËR E NJË SULMI NGA RUSIA. A KENI NEVOJË JU DHE FËMIJËT TUAJ PËR KËTË GJË? PËRVEÇ KËSAJ, ANËTARËSIMI NË NATO DO TË SJELLË KUFIZIM TË SOVRANITETIT DHE KUFIZIM TË POLITIKËS SË JASHTME...”





Muajt në vijim Shçerbak vazhdoi të postojë [paralajmërim](#) kundër inkuadrimit të vendit në sistemet e solidaritetit evropian. Në gusht të vitit 2018 ai u [shkarkua](#) nga funksioni i ambasadorit, e në vendin e tij u vendos ambasadori aktual Sergej Bazdnikin.

Në momentin e përmbylljes së këtij lajmi, ueb-faqja e Ambasadës së Federatës Ruse në Shkup [macedonia.mid.ru është e paarritshme](#). Megjithatë, Faqja e tyre në Facebook është e hapur. Ngjashëm me kërcënimin në Twitter, edhe në Facebook është publikuar një postim me paralajmërim se të gjithë këto incidente do të „evidentohen me kujdes”, ndërsa materialet relevante do të transmetohen deri te organet kompetente për vlerësim juridik, ndërsa fajtorët do të përgjigjen konform ligjeve pozitive.

# KOMUNA QENDËR NUK E DI SE KUSH E HOQI TABELËN ME QYTETIN UKRAINAS TË SEVASTOPOLIT NGA KËNDI “RUS” I LOJËRAVE



*(Tabela me emrin e qytetit Sevastopol që ishte vendosur në sheshin e lojërave në Sallën Universale; Foto: [Meta.mk](http://Meta.mk))*

*Shkruan: Ekipi i Meta  
(Meta, 18.02.2022)*





Komuna Qendër nuk e hoqi tabelën me emrin e qytetit ukrainas të Sevastopolit nga këndi i lojërave me tematikë ruse pas Sallës Universale. Nga Komuna nuk kanë asnjë përgjigje në pyetjen se kush dhe pse e hoqi tabelën me emrin e qytetit ukrainas që ndodhej mes emrave të qyteteve ruse.

“Deri më tani nuk kemi marrë informacion se kush e ka hequr tabelën nga këndi i lojërave”, kanë thënë për Meta.mk nga Komuna Qendër.

*(Ndër tabelat me qytetet ruse Veliki Novgorod dhe Soçi ishte edhe ajo me emrin e qytetit ukrainas Sevastopol. Ajo u hoq plotësisht nga sheshi i lojërave në fund të dhjetorit të vitit 2021; Foto: “Meta.mk”)*

Lidhur me atë se kush e ka financuar ndërtimin e këndit të lojërave për fëmijë me tematikë ruse, nga komuna thonë se shumica e mjeteve (mbi 40 mijë euro ose më shumë se 90 për qind e shumës së përgjithshme) kanë ardhur nga autoritetet komunale, gjegjësisht nga buxheti i qytetarëve të kësaj komune. Ambasada ruse në Shkup ka dhënë vetëm 150.000 denarë ose rreth 2.500 euro.

“Komuna Qendër e ka financuar rikonstruksionin e këndit të lojërave me 2.481.928 denarë, ndërsa Ambasada e Federatës Ruse ka marrë pjesë me 150.000 denarë shtesë”, **thonë nga Komuna Qendër** për Meta.mk.

Autoritetet lokale shtojnë se Vendimi për rikonstrumimin e këndit të lojërave e kishin në Programin vjetor të punës për vitin 2021 të Sektorit për rregullimin e tokës ndërtimore në Komunën Qendër. I njëjti program është dorëzuar në Këshill dhe është miratuar nga përbërja e kaluar e Këshillit të Komunës Qendër.

Nga Komuna Qendër theksojnë se sa i përket statusit juridik të qytetit të Sevastopolit, **i përkrasin plotësisht vendimet e Qeverisë së RMV-së dhe Ministrisë kompetente të Punëve të Jashtme.**

Ministri i Jashtëm i Maqedonisë Bujar Osmani më 31 janar të këtij viti në takim me ambasadorin rus në Shkup Sergej Baznikin përsëriti se Maqedonia e Veriut respekton sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës

brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht, ndërsa mbështetja politike për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës disa ditë më vonë arriti edhe nga kryeministri Dimitar Kovaçevski, i cili më 3 shkurt të këtij viti u takua me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg.

Këndi i lojërave për fëmijë me tematikë ruse shkaktoi një skandal diplomatik në vend, pasi në kuadër të tij ishte futur një tabelë me emrin e qytetit ukrainas të Sevastopolit. Bëhet fjalë për qytetin më të madh në gadishullin e Krimesë në Detin e Zi, i cili u aneksua nga Federata Ruse dhe është në kundërshtim për shkelje të ligjit ndërkombëtar dhe integritetit territorial të Ukrainës.

Ish-kryetari i komunës **Sasha Bogdanoviç** njoftoi në tetor se Ambasada ruse në Shkup kishte konfirmuar se këndi i lojërave me tematikë ruse financohej bashkërisht nga Komuna e Qendrës dhe Ambasada Ruse në Shkup.

Meta.mk para Vitit të Ri ka kontaktuar me Ambasadën e Ukrainës në Shkup, nga ku kanë konfirmuar se për tabelën me emrin e qytetit të Sevastopolit në këndin e lojërave ruse reagues edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe Qyteti i Shkupit.

“Ambasadorja e Ukrainës në vend, zonja Natalia Zadorozhnyuk, mbajti edhe një sërë takimesh përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku shprehu qëndrimin për pjesëmarrjen e papranueshme të zyrtarëve nga Maqedonia e Veriut, veçanërisht të kryesisë së Komunës Qendër, në përpjekjen e palës ruse për legalizimin e statusit të territoreve të pushtuara përkohësisht të Republikës autonome të Krimesë dhe Sevastopolit si subjekt i veçantë i Federatës Ruse”, informuan nga ambasada e Ukrainës.

Nga atje thanë se Ministria e Punëve të Jashtme rikonfirmoi qëndrimin e saj të fortë për mbështetjen e Maqedonisë së Veriut për integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës, por edhe nga MPJ siguruan se kjo çështje do të zgjidhet.





Meta.mk deri më sot nuk ka marrë përgjigje nga Qyteti i Shkupit dhe Ministria e Punëve të Jashtme për pyetjet e bëra në lidhje me këndin rus të lojërave.

Në periudhën e fundit pothuajse çdo ditë ka pasur reagime publike nga ambasadat e Ukrainës dhe Ruisë në Shkup, në të cilat transmetohen deklaratat e zyrtarëve shtetërorë të të dy vendeve për një sulm të ri të mundshëm rus ndaj Ukrainës.





CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.774(497.7):32.019.51(470+571)"2021/2022"(082)

PROPAGANDĚ, narrative të rreme, dezinformata - ndikimet e dëmshme të Kremlinit në Maqedoninë e Veriut : përmbledhje artikujsh mediatik / [autorët e teksteve Despina Kovačevska ... [и др.] ; përkthimi nga maqedonishtja në shqip Valon Abdiu , Marta Ziba Rashidi]. - Shkup :

Metamorfozis, 2022. - 192 стр. : илустр. ; 21 см

Превод на делото: Пропаганда, лажни наративи, дезинформации - штетните влијанија на Кремљ во С. Македонија : зборник на медиумски написи. - Фусоти кон текстот. - Други автори: Gjorgji Mitrevski (Ѓорѓи Митревски), Mirjana Najčevska (Мирјана Најчевска), Zharko Trajanoski (Жарко Трајаноски) Bojan Blazeovski (Бојан Блажевски), Goran Rizaov (Горан Ризаов), Elida Zylbeari (Елида Зилбеари), Filip Stojanovski (Филип Стојановски), Teuta Buçi (Теута Бучи), Shefkije Alasani (Шефкије Аласани), Vesna Kolovska (Весна Коловска), Ardit Ramadani (Ардит Рамадани), Goran Lefkov (Горан Лефков), Simona Atanasova (Симона

Атанасова) Sonja Rilkovska (Соња Рилковска), Ana Anastasovska (Ана Анастасовска)

ISBN 978-608-263-083-0

1. Kovačevska, Despina [автор] 2. Mitrevski, Gjorgji [автор] 3.

Najčevska, Mirjana [автор] 4. Trajanoski, Zharko [автор] 5. Blazeovski, Bojan [автор] 6.  
Rizaov, Goran [автор] 7. Zylbeari, Elida [автор] 8.

Stojanovski, Filip [автор] 9. Buçi, Teuta [автор] 10. Alasani, Shefkije [автор] 11. Kolovska,  
Vesna [автор] 12. Ramadani, Ardit [автор] 13.

Lefkov, Goran [автор] 14. Atanasova, Simona [автор] 15. Rilkovska, Sonja [автор] 16.  
Anastasovska, Ana [автор]

а) Медиумски содржини -- Руска пропаганда -- Влијанија -- Македонија --

2021-2022 -- Зборници

COBISS.MK-ID 57533445



